

SONI VË BAST

D

ikur ka qenë një këmborë, sa një dorë e vockël e me bisht të drunjtë, që përhapte një si kërkëllimë të mbytur përgjatë korridorit të gjatë shkollës, thua se po kollitej një burrë i moshuar me zë të çjerrë e si të humbur...Më vonë u bë zile elektrike, që çërrinte ëmbël e gëzueshëm. Po edhe atëherë kur ishte këmborë, edhe tani që është shndërruar vërtetë në zile, prap se prap të njëjtën punë bën: përcakton fillimin apo mbarimin e një ore mësimi. Ka raste që kjo zile bëhet e “ligë dhe e pamëshirshme”, sepse, pasi ke vrapuar sa ke mundur e je djersitur paq, për shkak të një zgjimi

Mustafa Tukaj

disi të vonuar, pse nuk ke arritur të kapësh në kohë urbanin, apo pse të është shpuar biçikleta, për dreq, derën e oborrit të shkollës e gjen të mbyllur...Portieri, të cilit sigurisht i vjen keq për ty, veç tund supet i pafuqishëm të thyejë urdhërin e drejtorit...Dhe ti pret përjashta me shpresë, se ai do të vërë dorën në zemër nga të luturat e përgjërimit e tua! Po, si e sheh se ato s'bëjnë dobi, largohesh disi ngadalë, duke vrarë mendjen, se nga do të vërdalloses, për të mbytur këto dyzet e pesë minuta të mallkuara dhe me ç'forcë do të përballosh pastaj qortimet e mësueses kujdestare apo të prindërve në shtëpi...

Po në përgjithësi tringëllima e ziles nga të gjithë pritet me gëzim.Ajo të shpëton nga një orë e mërztishme, që mezi zvarritet, t'i çlodh veshët nga moralizimet e tepërta të ndonjë mësuesi, shtriqesh pak, shpin trupin, lëviz nepër klasë, kopjon me shpejtësi drite një detyrë shtëpie që s'e ke bërë, ngacmon dikë apo vrapon në banjë...

Po të them të drejtën, zilja e pushimit të madh s'ka të krahasuar!Ajo zile sikur t'i kthen energjitë e humorin.Vrapon nepër oborr, të ndjekësh dikë që të ka ngacmuar, thërret në kupë të qiellit, sa të ngjiret zëri duke luajtur, apo bashkohesh diku mënjanë me miqtë e tu më të ngushtë. Bashkë çuçurisni, sigurisht, për gjëra serioze në dyshe, apo treshe, por edhe në grup e herë këlthisni me tërë bulçinjtë, thua se e keni

njeri tjetrin pesë kilometra larg...Por nganjëherë rri më vete dhe e vret mendjen për diçka që të shqetëson, mllaçitesh të përfundosh sa më parë kekun, që të ka dhënë mamaja, apo vrapon te bufeja e shkollës e kollufit me të shpejtë dy byrekë apo një cruasson...Diku plas një e qeshur, diku një ngacmim, diku një zënkë, e shoqëruar edhe me të shara e kërcënime për hiçgjë, e cila në të shumtën e rasteve shuhet po aq shpejt, sa ç'u ndez...

Të gjitha këto e plot gjëra të tjera ndodhin përditë në oborrin e shkollës gjatë pushimit të madh.

Atë ditë (nuk kishte shumë që kishte filluar viti ri shkollor), në vendin e tyre të preferuar pranë selvisë në të djathtë, qe mbledhur, si zakonisht grupi i “garipave”, që, sigurisht kryesohej nga Soni. Edhe pse ishin shokë për kokë, asnjëri prej grupit nuk ia dinte emrin e plotë dhe, ashtu të zënë deri në grykë me “probleme të mëdha” asnjëherë nuk u kishte shkuar ndërmendje ta pyesnin në quhej Elson, Willson, Edison, Vilson apo diçka e tillë me prejardhje anglosaksone...Po, tek e fundit, ç'rëndësi kishte kjo, po të shihje gjithë atë deli djalë, që dilte pothuajse një kokë mbi të tjerët, me flokë kafe të hapët, qethur alla *Berkham*, me sy të zgjuar e një zë që kishte nisur të trashet, sa që, herë herë, po të mos ia shihje fytyrën, mund të mendoje se kishte të bëje tamam me një burrë... Po, si për dreq, ngandonjëherë ai zë ende i paformuar

Mustafa Tukaj

plotësisht rrëshqiste nga “binarët” e, nuk e di pse, por të kujtonte palljen e një kërriçi...Dikush pati thënë, se ai, që të trashte zërin, e thithte fshehurazi në banjot e shkollës ndonjë cigare, edhe pse e kishte të ndaluar si sportist që ishte. Që në klasë të pestë, pra, plot katër vjetë e ca më parë, kishte nisur të stërvitej në futboll, kishte patur edhe ndonjë rezultat të mirë në kampionatet e moshave, po, siç i pëlqente të përsëriste shpesh atë që thoshte trajneri i tij, të ardhmen ai e kishte përpara...

Po arsyeja kryesore, pse shokët e tij të grupit e kishin zili, kishte të bënte me vajzat!Të gjithë ata i tregonin njeri tjetrit e mburrshin për “këtë apo atë”, po Soni ishte i parëzistueshëm!I tekej për ndonjërin, sa çel e mbyll sytë e shtinte në dorë!...Po cila mund të ishte ajo, që do t’i kundërshtonte këtij azgani e t’i bënte xhibla?!As që mund të mendohej! Përkundrazi, çdonjëra që futej në shënjestrën e tij, vinte e dorëzohej pa mundin më të vogël e binte vetë në rrjetë...

Soni fliste e diç u tregonte dhe “kori i garipave”qeshte me tërë forcën mushkrive të tyre.

Vetëm dy metra larg Redi, me oreksin e tij tashmë të njohur, po asgjësonte me vetëmohim, një copë byrek shtëpie me barishte të egra, që e bënte aq të mirë gjyshe Sanoja, sa, po të organizohej ndonjë kampionat botëror byrekërie, s’do mënd, që ajo do ta fitonte medaljen e artë...Le

të dilnin pastaj amerikanët, francezët apo grekërit e lashtë e të mateshin me gjyshe Sanon! Do të shqyenin sytë e goja do t'u lëshonte lëng, vetëm duke ndjerë aromën oreksndjellëse të paziave, lëpjetave, mullagave, milzave, ferrbutave, koprës e majdanozit. Jam i sigurtë që gjyshe Sanoja do të falimentonte edhe vetë Mcdonald's - in!

Ditë për ditë ai u stërvidhej shokëve të klasës e vinte në këtë cep të oborrit, jo pse ishte koprrac e nuk donte t'u jepte të tjerëve nga një çapë, po sepse pikërisht në këtë qoshe ai përpiquej të përfitonte fshehurazi diçka nga çfarë thonin më të rriturit, me Sonin e Zarin në krye, në lidhje me atë temë delikate, që po ia përvlonte shpirtin...

I përshëndeste me kokë, u kthente shpinën e bënte sikur nuk e kishte mendjen fare tek ata, po në fakt, veshët i bënte katër, që të mos i rrëshqiste as edhe një fjalë e vetme dhe zemra i copëtohej... Ishte e tmerrshme që edhe Giri, dy pare njeri, një metër e një qebap mbi tokë, dilte ditë për ditë me Irën e të shtatës C dhe bënte be e rrufe, se e kishte puthur, madje... nejtse! Po Edri, një qull, që e kishte edhe kushëri të largët, të tregonte gjithë ato histori, që veç t'i dëgjoje, kurse atij vetëm në ëndrra i binte rasti ndonjëherë të argëtohej me dikë!... E pra, nuk kishte të sharë si djalë! Kokën në vend e kishte, mbi shpatulla, si gjithë të tjerët dhe madje goxha kokë!...Flokët kish filluar t'i krihte model iriq...Ditë për ditë në mëngjes

Mustafa Tukaj

shpenzonte të paktën njëzet minuta sa i llakoste, i ngrinte e u jepte formë me duar e krehër special prej kocke elefanti, që ia kishte sjellë i ati nga Pakistani.

Ishte trupmadh e shpatullgjërë dhe në fytyrë s'kishe ç'ti shaje: normal, me dy sy, dy veshë, një hundë në vendin e vet e një gojë...Vishej me shije e rrobat i blinte firmato. Mësonte mirë, sidomos në biologji, ku ishte absolut. E vetmja e metë e dukshme ishin nja dhjetë kile të tepërta në trup, e sidomos në të ndenjura, që e pengonin të ecte lirshëm, le më, larg qoftë, të vraponte...I kishin thënë të merrej me sport e të mos hante aq shumë. Dy javë më parë, i ati, pavarësisht se e ëma ishte kundër, e kishte regjistruar me ekipin e ngritjes së peshave të qytetit dhe ai kishte filluar stërvitjen me grupmoshat. Ndërsa për të ngrënë, asgjë nuk mund ta ndalonte, a thua se në bark kishte një lubi, që ia përllante të gjitha...Një herë që provoi të hante në darkë vetëm përshesh me bukë misri e kos, u ngrit natën si kokudhi, nga që s'e zinte gjumi dhe hëngri ç'gjeti përpara, përfshi këtu edhe një gjysëm tepsie pastiço, të bërë enkas për të nesërmen në drekë, meqë kishin miq...

I kishin thënë se po të stërvitej shumë, do të binte në peshë e pastaj gjithçka mund të rregullohej. Po koha po ecte. Dhe veten e ndjente si guak, kur të tjerët tregonin...Po ai ç' të tregonte? Në fakt e kishte një të fshehtë, po këtë nuk do t'ia

thoshte askujt hë për hë...Tek e fundit, pak sekret në jetën e njeriut është i mire, aq më tepër që ai ende nuk dinte ç'emër t' i vinte kësaj...Ai vetëm dinte që i pëlqente të rrinte pranë saj, ta vëzhgonte si qeshte e çuçuriste me të tjerët, të mos ia ndante sytë, kur vraponte si gizelë në oborr, apo në këndin sportiv, kur luanin basketboll dhe..kaq. Jo, ka më.. Dje, përshembull, teksa po bënin planin e ekskursionit për në Sarandë, ajo u mbështet pas tij dhe i vuri dorën në sup për dy - tre minuta. I gjori ai, ndenji si i ngrirë nga frika, se mos lëvizte e ajo hiqte dorën! Tërë natën u soll e u pështoll nepër krevat, po meazallah, se e zuri gjumi!

- Ej, Redi! - e thirri Zari, që ia largoi mendimet. Zari ishte më idhnaku i grupit dhe shquhej për sherre. Ai e pa njëherë, fshiu buzët dhe u afrua.

- Ju keni vajza të bukura në klasë! Ke zënë ndonjëren? - e pyeti po ai.

- Pse në klasë? Vajza ka plot, ku të duash!- u pëgjigj duke u përpjekur të mos e tradhëtonte zëri, ndërsa zemra i shtoi të rrahurat, edhe pse nuk dinte ç'të sajonte, po të vazhdonin ta pyesnin, por edhe ngaqë sapo qe përpjekur të gënjente për vajzat e klasës. Në fakt, ajo që ia prishi gjumin mbrëmë, ishte një shoqe klase...

- Na trego për të! - vazhdoi Zari.

- Ç'të duhet ty? - e pyeti Redi edhe për t'i dhënë vetes kohë, të sajonte diçka.

Mustafa Tukaj

- Ti ia këput kot!- ndërhyri Soni, - se po të kesh na e thua!

- Po, kam një në Pogradec! E njoha në verë...

- Sa larg paske shkuar!- u tall Edri.

- Kam edhe një në lagje, po ti nuk e njeh!...

- Vë bast që ia këpute kot!

- E vëmë!Ja toke dorën!- qëndroi në të tijën Redi, për të vazhduar, meqë tashmë kishte hyrë në valle.

Tjetri u lëkund.

- Ke ndonjë fotografi të saj?

- Si nuk e kam! Po jo këtu, se nuk e mbaj me vete!

- E mirë pra, na e sill nesër, të të besojmë! - nguli këmbë Zari.

- Mirë!- tha ai për inerci, pa menduar fare, se ku do ta gjente fotografinë.

Të nesërmen në pushimin e madh ai nuk doli fare nga klasa, se “nuk ndihej mirë”, ndërsa një ditë më pas, me të rënë zilja nxitoi të mbërrinte i pari tek qoshja pranë selvisë. Përlau me të shpejtë një copë picë me këpurdha dhe u bë gati të priste “grupin e garipave” që nuk vonoi të mblidhej pranë tij.

- Ku ishte dje? - e pyeti Edri.

- Në Pogradec! - u tall Soni.

- Pse, mos duhej të të merrja leje? - ia ktheu Redi me një ton, ku ndjehej dëshira, për të mos i lëshuar pe Sonit, edhe pse ishte ishte një vit më i

vogël në moshë se Soni dhe pak më i shkurtër në trup. Nuk ishte nga ata që i pëlqenin sherret, po as nuk donte të dukej frikacak e ta nepërkëmbnin.

- Na dhe fjalën, se do të na sillje fotografinë e saj! - ndërhyri disi me të shpejtë Edri, që u drojt, se mos lindte ndonjë sherr mes tyre.

- Po të dua, edhe nuk ua tregoj, se nuk jam i detyruar, po, meqë ua dhashë fjalën... - futi dorën e xhepin e këmishës dhe nxori që aty një fotografi të mbështjellë me një letër të bardhë.

I pari e mori Edri që, si e pa për vete, ua dhe të tjerëve.

- Qenka alamet goce!- tha Soni.

- S'qenka e keqe! - tha Giri.

- Po, por i gjori, duhet të presë deri në verën tjetër, që ta takojë!.. - tha Zari.

- Mos ma qaj hallin!- iu përgjegj Redi, që mori fotografinë, e mbështolli dhe e futi po në xhepin e këmishës i lehtësuar.

E kishte kaluar situatën për bukuri!Ua kishte mbyllur gojën garipave një herë e përgjithmonë. Sa mirë i shkoi ndërmend mbrëmë, se do të ishte turpëruar.Vajza në fotografi ishte një kushërira tij nga Durrësi! Kishte patur frikë, se mos rastësisht, Edri i kishte parë ndonjëherë bashkë e pastaj fëlliqej krejt, po, për fat, ai nuk dha asnjë shenjë, se e njihte.

Edhe pse e kishte shkarkuar këtë barrë nga supet dhe e kishte fituar një betejë me Garipat, nuk

Mustafa Tukaj

ndjehej fare i lehtësuar dhe nuk i hiqej ankthi që e përvëlonte prej kohësh: në të vërtetë ai nuk kishte asnjë vajzë! Nuk arrinte ta kuptonte shkakun, ç' i mungonte atij dhe përse ata nuk shfaqnin interes për të!

- Ou, Soni, shiko kush po vjen! - e shkëputi nga mendimet Zari.

- Kush? - pyeti Soni.

- Kulla binjake!

Të gjithë kthyen kokat si me komandë. Edhe Redi, që ishte në mishmashin e mendimeve të tij u kthye dhe... pa...vetë atë, Shejlën! Iu kujtua dora e saj pardje mbi shpinën e tij...U skuq, u turbullua, e humbi toruan, sepse ajo vërtetë ishte drejtuar andej nga ata, me trupin e saj lastar dhe krifën e flokëve që i hidhej nën ritmin e hapit të saj të drejtë e të shpejtë... Këtë verë ajo kishte lëshuar shtat dhe qe zbukuruar aq shumë, thua se i kishin ndërruar kokën dhe një nur vashëror plot hire moshe ndjehej në tërë qenien e saj. Ajo me plot gojë i ngjasonte një gonxheje në shpërthim... Po ç'donte ajo këtu?

- Kur u bë kaq e mirë, kjo dreq?! Vjet ishte si mickë! - tha Soni i befasuar.

Redi shtrëngoi grushtet prapa shpine.

- E kanë tërhequr për flokësh! - bëri shaka

Giri.

Redi e pa vëngër.

- Me ty e ka, më duket, Soni! Po të bën shenjë! - tha Zari.

Redit i ngriu gjaku.

Soni u shkëput një hap prej tyre dhe i doli para.

- Sa mirë, që erdhe! Më ke sjellë adresën e e-mail-it?

- Prapa kthehu! - ia ktheu ajo në çast me mospërfillje, pa i lëvizur asnjë muskul në fytyrë.

- Redi, eja pak!

Redi si me sustë u shkëput prej grupit dhe u përpoq me aq sa mundi të shpejtonte hapat.

- Po ti, ç'pret? Të ka humbur çoku?- iu drejtua Sonit, që kishte mbetur pa lëvizur, si për ta dërrmuar fare. Ai nuk e mori vesh ç'i gjeti fjalët që iu ngrinë në grykë e s'qe në gjendje t'i jepte një përgjigje për të qenë, veçse nënqeshi, tundi kokën dhe i ktheu shpinën.

Grupi e priti me ngacmime, teksa Shejla e Redi, që kurrë s'do ta kishte besuar një kthesë të tillë e zemra gati po i dilte prej vendit, u drejtuan nga hyrja e shkollës, ku, siç i tha Shejla, po i priste mësuesja e biologjisë për konkursin në mes klasave.

Nga pas mbeti e qeshura e grupit të garipave, që talleshin me Sonin dhe fjalët e tij:

- Tokeni këtu me nga një të qerasur te "Katër Stinët", po nuk ia ula hundën brenda dy javësh!

Mustafa Tukaj

**ÇOKOLLATAT JANË TË
MIRA!**

P

a dalë mirë mësuesja e gjeografisë, klasa gumëzhiu nga llafet. Të ndryshme, të shumëllojshme, thënë me zë të ulët a të lartë, drejtuar dikujt, apo askujt, serioze apo për të qeshur, fjalët përziheshin me njëra tjetrën për të formuar atë rrëmujë gjuhësore dhe atë përzierje zërash, që rrinte pezull mbi kokat e fëmijëve si shtresë smogu.

Aty pranë dritares plasi një e qeshur. Shejla kishte mbetur e habitur nga shpejtësia e duarve të Erit, që porsa kishte bërë një lojë shpejtësie. Ai djall të mahniste me aftësitë e gjithanshme të tij!

- Aman, na thuaj si e bëre! - iu përgjërua Tida me faqe si pjeshkë.

- Më qafsh, po s'e bëre edhe një herë! - iu lut Shejla, edhe sepse donte të kapte trillin e të mos mbetej si guak.

- Njëherë tjetër, zonjushë! Për sot mjafton! - tha ai dhe u u shkëput prej tyre e kaloi në anën tjetër të klasës, për t'i thënë diçka në vesh Bombones, domethënë Dritit, të cilin e thërrisnin kështu, sepse për të gjithë ai ishte një djalosh i urtë e i ëmbël, që nuk bënte sherr me askënd.

Kushdo që do ta shihte Erin për herë të parë, në çast do t'i bënin përshtypje veçanërisht sytë e tij të vegjël ngjyrë kafe shumë të çelur, që, kur të vështronin, sikur të përpinin të tërin e të thithnin në çast mendimet. Me trup vinte pak mbi mesataren, flokët të qethur shkurt e të krehur thjeshtë, se, siç thoshte vetë, nuk kishte kohë të merrej me to. Ishte i hajthëm, po nuk mund të quhej i dobët, i zhdërvjelltë si shqarth dhe i pëlqente të merrej me gjithçka. Nuk shkëlqente, po gjithsesi, i luante mirë të gjitha sportet. I pëlqente teatri, muzika, madje edhe luante pak në kitarrë. Ndoshta në shah mund edhe të kishte bërë prokopi, mbasi kishte aftësi të rralla kombinateve të lëvizjeve, por nuk kishte shumë durim të mendonte gjatë dhe, kur duhej të ngulej mirë për të dhënë goditjet finale, ngutej dhe e prishte gjithë punën. Për të veshur pëlqente jeans dhe bluza pambuku, që jo rrallë ishin të zhubrosura.. Në mësim ishte shumë i mirë, veçanërisht në matematikë, ku shkëlqente, falë kujtesës së fortë e logjikës për t'u patur zili, se, për të mësuar, thuajse nuk i prekte librat aspak me dorë... Mjaftohej me shpjegimin e mësuesit në klasë, të cilin e dëgjonte me shumë vëmendje dhe e kishte për borxh që rradhën tjetër, ta përsëriste fjalë për fjalë, me pikë e me presje, siç e kishte dëgjuar, a thua se po përgjigjej një magnetofon...Sa për vullnetin, aha!...Siç e ngacmonte Shejla, kur

prindërit e tij, para se ai të lindte, kishin shkuar në supermarketin e “Vetive Njerëzore” e kishin mbushur plot karrocën e dorës me gjithçka, kurse departamenti i vullnetit kishte qenë i mbyllur në remont...

Historia ishte lënda, ku i ngecte sharra në gozhdë e kujtesa nuk i pinte ujë, madje kishte edhe një notë pakaluese. E pëlqente si lëndë, po nuk e donte fare mësuesen, se, si e paaftë që ishte, thoshte ai, pothuajse nuk shpjegonte fare mësimin e ri, ndërsa për të pyetur nxënësit e mbante librin të hapur para vetes e kërkonte edhe imtësitë.

- Ej, dëgjoni! - thirri Nimfa, - Erdhi fundi i muajit! Ende nuk i kanë sjellë lekët të gjithë.

- Pret puna! - iu përgjigj Visari.

- Nuk pret, se duhet të dimë sa vetë bëhen, për të zënë autobusin.

- E mirë, mirë, se do t'i sjellim - thanë disa prej tyre.

- Unë propozoj, meqë do të biem nga Gjirokastra, drekën ta hamë tek “Syri i Kaltër”- tha Redi, që deri atë çast vetëm kishte dëgjuar të tjerët e kishte vështruar si me marifet Shejllën.

- Mirë e ka Redi! Është vend fantastik! Dhe çfarë pylli që ka përreth, me zogj përrallorë që cicërijnë...

- Unë vdes, kur shkoj ndokund e zgjohem në mëngjes nga kënga e zogjve...

Mustafa Tukaj

- S'ke faj, se në shtëpinë tënde zgjohesh nga shamata e komshinje...

- Arlind, mos harro të marrësh bojrat e penelin!

- Kurrë nuk kam qënë, po kam dëgjuar. Është bukur, vërtetë? - pyeti Arlindi me zë të ulët e të butë, siç fliste zakonisht. Kishte talent në pikturë dhe sapo kishte çelur një ekspozitë personale.

- Mrekulli!

- Po, pse i ka mbetur emri ashtu?

- Se uji i ftohtë e i pastër kristal në pjesën e brendshme të burimit, kur del në sipërfaqe, shfaqet si bebe syri, ndërsa uji përreth është më i çelët dhe të jep përshtypjen e një syri të kaltër...

- E nga buron ai?

- Kush e di?! Është mbi pesëdhjetë metra i thellë.

- Unë e di ! - ndërhyri Eri - Në fund ka një shkëmb, nga i cili buron!

- Ti ia këput kot! - e kundështoi Shejla. - Ku e ke lexuar këtë?

- Po ti a ke lexuar gjëkund, se nuk ka një shkëmb në fund?

- Jo nuk e kam lexuar! - u përgjigj ajo pa e ditur, se ku do të dalë.

- E po, atëherë, meqë nuk e ke lexuar që s'ka, domethënë, që mund të ketë!...

Plasi e qeshura. Edhe Shejla qeshi e i ra lehtë në sup.

- Ngjyra e kaltër e burimit, mund të jetë edhe reflektimi i qiellit - shtoi Redi dhe e pa Shejlën, si për t'i kërkuar aleancë.

- A është e vertetë, se italianët e kanë kërkuar ta blejnë ujin e burimit, për ta përdorur si ujë të pishëm? - pyeti një tjetër.

- Kështu thonë, - foli përsëri Redi i nxitur nga vështrimi dashamirës i Shejlës.

- Bile thonë, - prap ndërhyri Eri gjoja me seriozitet, - Se uji ka veti të mëdha kurative, gati të magjishme...

- Vërtetë?! Po përse?! - pyeti Nimfa e interesuar.

- Thonë, se po të lahesh me ujin e burimit, ta bën të lëmuar lëkurën e fytyrës e të pastron piklat!

- Tallesh! E, di unë, e di, e ke fjalën për mua, po të gjithë më thonë, se piklat më shkojnë shumë! Kështu që nuk do t'i heq!

Ra zilja. Ata u shpërndanë nepër bankat e tyre dhe u bënë gati. Këtë orë kishin matematikë me mësuesen kujdestare.

Po, për habinë e të gjithëve, kur dera u hap, hyri brenda një grua e gjatë si gallofe, gjysmë bjonde, me flokë ngjyrë të shpërlarë të prerë shumë shkurt, si burrë. Ajo i përshëndeti lehtë me kokë, a thua se i njihte prej kohësh e u përpoq t'u

Mustafa Tukaj

buzëqeshte, por nuk arriti plotësisht, vetëm sa nxori në pah dy dhëmbë të përparmë të mëdhenj...

Fëmijët u shtangën. Mos kishte hyrë gabim? Kurrë nuk e kishin parë ndonjëherë në shkollë këtë grua. Mos ishte infermiere e kishte ardhur t'u bënte vaksinat? Kushedi sa të rëndë do ta kishte dorën! Pa le zërin! Me pamjen që krijonte fare mirë mund të prisje ndonjë zë basi në vend të një zëri femëror!

Po, për habinë e tyre, ajo në vend të shiringave, mbante nën sqetull regjistrin dhe u drejtua tek tavolina e mësuesit. Fëmijët kryqëzuan shikimet.

Ajo ngriti kokën dhe si e përshkoi me një shikim të gjithë klasën, foli:

- Të dashur, fëmijë!

Të gjithë u habitën. Si është e mundur! Ç'ishte ky zë kaq i ëmbël, që mbushi klasën fund e krye? Nga e kishte huazuar?! Po të mbyllje sytë e të mos e shihje tek fliste, meqë ata sapo kishin përmendur "Syrin e Kaltër", me siguri, që do të përfytyroje një gurgullimë të lehtë, që dilte i pastër nga shpirti i burimit...

- Unë jam mësuesja e re e matematikës!
Më quajnë Vjollca.

Ja edhe një çudi tjetër! Po si mund të krahasohej me lule vjollcën një portret i tillë? Po mësuese Dita ku kishte shkuar?

- Mësuesja juaj është e sëmure dhe nuk do të jetë në shkollë për një farë kohe... - foli ajo si t'u kishte lexuar mendimet. - Bashkë do të bëjmë matematikën dhe unë do të jem njëkohësisht mësuesja e juaj kujdestare. Dëshiroj ta kalojmë mirë. Mësuese Afërdita më ka folur për ju!

Në klasë ra heshtja.

- U dogj Saranda!- tha lehtë Visari, po në qetësinë e klasës ato fjalë arritën fare mirë deri tek veshët e mësueses së re të matematikës.

- Jo, nuk u dogj! - tha ajo si me të qeshur, duke nxjerrë prap në pah dy dhëmbët e parmë, që çuditërisht këtë rradhë, nuk u dukën aq të mëdhenj.

- Më, ka treguar Afërdita. Do të bisedojmë një ditë tjetër për këtë. Ju bëhuni gati!

Pastaj çdo gjë erdhi normalisht deri në fund të mësimit. Çka! Nuk qe edhe aq keq! Mësuese Vjollca fliste qartë e shpjegonte mirë.

Kur po dilnin në pushim të madh Redi përfitoi nga rasti që Shejla mbeti për një çast prapa dhe i tha:

- Do një çokollatë?

- Dua!

Redi e nxori me të shpejtë dhe ia dha. Ajo e mori pa ceremoni dhe e futi në gojë.

- Rrofsh! Unë ngordh për çokollata!

Redit iu duk, se kishte prekur qiellin me dorë.

AH, KJO SHEJLA!

M

e të rënë zilja e orës së fundit, nxënësit me shpejtësi marramendëse mbyllën çantat dhe u turrën përjashta. Enxhi nuk priti të dilnin të gjithë, por me të shpejtë nxori nga çanta një pasqyrë të vogël e një labelo, po me të shpejtë i dha një të shkuar buzëve dhe nxitoi të arrinte shokët, që po zbrisnin shkallët. Në katin e dytë gati sa nuk u përplas me Redin, që po bisedonte diçka me mësuesen e biologjisë, i futi krahun Nimfës dhe

ashtu në grup, duke lënë pas vetëm Redin, që mezi priste të shkëputej, dolën në oborr.

- Unë vdes për patllixhana imam - baj - oldi!- po thoshte Shejla.

- Unë i dua me djathë e me majdanoz!- tha Tida.

- Mua s'më hyjnë në sy zarzavatet, po s'pata mish!- tha Visari..

- Unë nuk e honeps dot mishin, ma shpif! - tha Nimfa.

- Po ju, ku e gjeni gjithmonë, që, tamam, kur kemi sharruar për të ngrënë, na zini në gojë gjellë të shijshme? Kush duron edhe një gjysëm ore?! - u qa Arlindi.

- Duro, bukurosh! - e ngacmoi Eri, kur e pa, se si kapërdui lëngun që i kishte mbushur gojën.

- Një tavë kosi me mish qingji, po edhe një tavë Elbasani s'do të ishte keq!...Ja, pyete Redin, po deshe!

- Përse e keni fjalën?! - u interesua Redi, që u afrua, pasi që ndarë nga mësuesja e biologjisë dhe pasi kishte vrapuar me tërë kapacitetin e tij të mundshëm duke ndezur të gjithë motorrët...

- Po ja, - vijoi Eri - Nimfa po thoshte, se qoftet e sgarës me lëng janë më të mira se kukureci!

- Gënjen, për kokën e mamit! Unë as që i zura në gojë, se janë të shpifura!

Mustafa Tukaj

- Të shpifura për ty, që je vegjetariane! -
tha Redi dhe u kapërdi.

- Më kanë thënë, Redi, - ndërhyri Enxhi, -
se ty më shumë të pëlqen korani i Pogradecit!...

Redi ktheu kokën me të shpejtë.

- Ku e di ti?!

- E di unë...Mos e kam gjë gabim?

- Jo, nuk e ke gabim, se edhe korani peshk
i mirë është... - miratoi ai për të mos e zgjatur, nga
frika, se mos Enxhi, nxirrte diçka më shumë në sy
të shokëve e sidomos të Shejlës... Atij i dogji
miza, se mos Enxhi dinte diçka për gënjeshtren e
tij në lidhje me fotografinë e vajzës nga Pogradeci,
që, me sa dukej ia kishte thënë ndonjeri nga
garipët...Edhe kjo i duhej!

Hodhi sytë për të dalluar makinën e të atit
në ishte gjëkund...Për fat, sot nuk kishte ardhur,
kështu që do t'i binte gjatë e gjatë e të bënte rrugë
sa të ishte e mundur në këmbë me atë...Po tek e
fundit ecja i bënte mirë, edhe pse gjëndrrat e
stomakut kishin filluar funksionin e tyre të
përhershëm...

Nja njëzet metra larg portës së madhe te
shkollës, hipur mbi biçikletë, po me këmbët tij të
gjata për tokë, po priste Soni. Nga mënyra, se si ai
e ktheu kokën nga ana e kundërt, kur ata u afruan,
mund të mendoje, se ai as që e kishte mendjen fare
tek ata, por se kë po priste të vinte nga krahu
tjetër, megjithëse, nga krahu tjetër ishte veç një

dyqan rrobash të gatshme dhe një floktore grash...
Po kush e di, mbase e ëma po këshillohej me parukierën!..

- Ej, kalamaja, mbas ca ditësh do t'u bëj një surprizë! - ngriti zërin Enxhi, kur i kaluan fare pranë..

- Nuk ka surprizë, kur paralajmërohet! - e kundërshtoi Visari.

- Ka, se ju nuk dini përse bëhet fjalë!

- Drekën! - tha Tida, që mori majtas drejt një blloku pallatesh të reja.

- Drekën!Drekën! - thanë edhe të tjerët pak më vonë tek kryqëzimi.

Mbetën ata të tre: Shejla, Redi dhe Eri. Për Redin ky ishte një ndër rastet e rralla, që e bënëin rrugën bashkë, se pothuajse çdo ditë vinte i ati dhe e merrte me Benzin e tij luksoz.

Kur iu afruan një ëmbëltozeje hodhi një propozim të çuditshëm:

- Hamë nga një trileçe? I bëjnë shumë të mira këtu!

- Jo, se nuk dua të vonohem shumë sot. Kam një rast në familje! - kundërshtoi Shejla.

- Mos t'ia prishim djalit, se s'bën! - tha Eri.

- Jo, Eri, nuk mundem!

- Në qofsh vërtetë vajzë e mbarë, duhet të më bindesh, se je më e vogël se unë!

- Katër ditë!

Mustafa Tukaj

- Për katër ditë bëhen mrekullira. Kur nënën tënde po e çonin në maternitet, unë isha një qytetar i lirë, që posa më kishin regjistruar në gjendjen civile...

- Mirë, marrim nga një akullore në dorë! - nguli këmbë Redi.

- Akullore po, - pranoi Shejla.

- Trileçën nesër! - tha Eri që hyri i pari në ëmbëltore.

Pas pak ata dolën nga lokali dhe vazhduan rrugën duke u shkrirë në muhabet. Redi gati sa s'fluturonte nga shendi...Por, se si ktheu kokën prapa ashtu kot, kur në distancë, për dreq, dalloi...Sonin!...U skuq pak, po nuk e dha veten...Domethënë ai po i ndiqte! Redi vetëm vjet qe transferuar në atë klasë nga një shkollë tjetër dhe nuk e dinte tamam, se ku e kishte shtëpinë Eri. I kishin thënë, se rrinte diku pranë me Shejlën, se ata të dy ishin shokë të ngushtë që nga kopshti, por ai e ndau mendjen! Do të shkonte me ta, edhe pse shtëpinë e kishte në krah të kundërt dhe do t'i duhej të kapte autobusin e unazës...Po, duhej sakrifikuar pak, se gjërat e mira, siç kishte thënë njëri, bëheshin me sakrifica! Me një gur do të vriste dy zogj: edhe mësonte tamam, se ku e kishte shtëpinë njëri e tjetri, edhe nuk i jepte shkas Sonit për të ngacmuar Shejlën...Të lumtë Redi, kështu bëjnë njerëzit që kanë dy gram mend! I dha kurajo vetes dhe lëpiu tërë qejf atë akullore treshe me

lajthi, çokolatë e fruta pylli. Ja, sa të ndahej edhe Eri nga ata dhe pastaj...Çfarë pastaj!...Asgjë pastaj...Veç do të të bënte disa hapa vetëm për vetëm me Shejlën duke fërgëlluar nga qejfi dhe... kaq! Le të pëlciste Soni, që, me siguri, po i ndiqte prapa si bisht, kur t'i shihte vetëm!

I humbur në ëndërrimet e tij në dritë të diellit, që ende digjte në atë ditë tetori, Redi nuk e ndjeu celularin, që po çirrej së rëni.

- Ej, Redi, me ty e ka! - i thirri Shejla.

E hapi me të shpejtë dhe u nxi, kur pa numrin e babait...Diç parandjeu. Po sikur të mos ia hapte? Jo, nuk do të guxonte!

- Urdhëro, babi! Ja, këtu jam, afër teatrit. Po pse të vish ti? Kthehem me autobus! Mirë, mirë, si të duash! - mbylli bisedën hundë e buzë, a thua se, sapo i kishte ngordhur kali në mes të pyllit e po binte nata!...Po kush dreqin e kishte shpikur këtë djall telefoni, që vetëm me një cërr-cërr t'i prish çak-fak planet, qe ke bërë prej kohësh? Bah, çfarë shansi që ka Eri! Ditë për ditë e bën rrugën me të!...As i kërcet celulari, as e marrin me makinë! Po çfarë bisedojnë, xhanëm, ditë për ditë? Që në kopësht bashkë! Kulmi!

- Drekën! - u tha lehtë, duke u përpjekur të fshihte inatin me të atin, apo me celularin. - Do të shkojmë në Durrës! - gënjeu pa pikë zori, që të zbuste sado pak ndjenjën e hallit që kishte, ngaqë prindërit e trajtonin ende si kalama, e jo si një

Mustafa Tukaj

trembëdhjetë - katërbëdhjetëvjeçar, të cilin nuk e nxinin këpucët e të atit...

Ata vazhduan rrugën, ndërsa ai u ngul si statujë në pritje të babait.

- Të mbaroi benzina, apo të dhanë duart? - e pyeti Soni, që ndali biçikletën aty pranë.

- Po ty, mos të paguan kush si detektiv privat? - ia ktheu, pa pyetur se ç'kthesë mund të merrte biseda.

- Më duket se të është shtuar oreksi! Po kujdes, se mos të ngec në grykë!

- Ti shiko punën tënde, se unë e kam shoqe klase! - u përpoq të bishtnonte, ngaqë nuk donte sherr, edhe pse nga çasti në çast mund të mbërrinte babai. Dhe ai vërtetë, si të ishte tërhequr me magnet nga mendimet e tij, frenoi mu pranë këmbëve të Redit. Soni shqeu sytë, kur pa gjithë atë Benz të zi, që flakëronte e ku, në shkëlqimin e tij fare mirë, mund të korrigjoje modelin e flokëve... Vetëm të zotit, domethënë babait të Redit, nuk do t'i hynte në punë, sepse nuk kishte flokë!...I kishte shkuar me brisk zero dhe koka i dukej më e rumbullaktë se ç'ishite në të vërtetë, ndërsa qafa me ca palë rrudhash binte mbi dy shpatulla të gjëra.

Redi hipi në makinë duke i turfulluar diçka të atit, kurse Soni u dha pedaleve të arrinte prenë e tij të ardhshme...

Vetëm pak metra më larg ajo sapo ia kishte lëshuar frenat një të qeshure me kakarisje dhe po gajasej me gjithë shpirt, me sa dukej, nga ndonjë shaka e kripur e Erit, që në shenjë falenderimi për këtë, siç shihej, qe shpërblyer me një grusht jo edhe fort të lehtë në shpinë...I dhembti vërtetë, apo bëri sikur, po ai u ndalua një çast dhe u kërrus pak. Shejla e zuri për krahu dhe i fërkoji shpinën duke i thënë:

- Hajt, hajt, mos bëj kështu, se je goxha çun!
Ku pyet ti për kaq! - dhe, para se ai t'i thoshte diçka, i ra edhe një herë po në shpinë disi më lehtë e ia krisi një vrap, që do t'ia kishte zili çdo atlet. E ndali turrin pas nja tridhjetë hapash para një porte të madhe prej druri të gdhendur, i tundi shpejt disa here dorën e djathtë e i thirri:

- Drekën! Më merr në telefon! - dhe hyri brenda në oborr.

Eri, që me thënë të vërtetën goditjen e dytë as që e kishte pritur fare, ndenji për një çast ashtu me buzë në gaz dhe pastaj ktheu majtas drejt një pallati gjashtëkatësh pesëdhjetë metra më larg, ku në hyrjen e tretë, në katin e katërt gjendej apartamenti dy dhoma e kuzhinë i familjes Shkreli, prej pesë antarësh.

Soni, që nga larg kishte ndjekur gjithçka, u dha më shpejt këmbëzave të biçiletës dhe si rrëshqiti për disa metra përgjatë një avllie jo edhe aq të lartë mbuluar me jargavanë, pa e kuptuar as

Mustafa Tukaj

vetë pse, frenoi para portës prej druri të gdhendur. Me sa duket kjo shkaktoi zhurmë, se, sa çel e mbyll sy, porta u hap me të shpejtë dhe Shejla u shfaq, duke e befasuar Sonin aq shumë, sa, i ngrati, desh u rrëzua nga biçikleta.

- Kë kërkoni?- e pyeti ajo me të shpejtë, si për t'ia hequr edhe atë grimë guximi, që mund t'i kishte mbetur.

Soni u përpoq të mblidhte veten dhe, si kroi zërin, u mat të thoshte diçka, por Shejla që më e shpejtë:

- Teta Leta, - iu drejtua me seriozitet një gruaje në moshë, që po kalonte aty pranë, - Të lutem ndihmoje pak këtë djalin, se nuk e di kë kërkon! - dhe u fut vrikthi brenda, duke mbyllur portën e duke vrapuar përgjatë një rrugëze të shtruar me pllaka mermeri të kuqërremta e ngjyrë kremi, që të çonte drejt një shtëpie dykatëshe. Ajo nuk ishte edhe aq të madhe, po kishte një arkitekturë tepër interesante, ku qenë shkrirë në harmoni të plotë guri dhe druri dhe që të ngjasonte me një shtëpi përrallash, edhe nga pemët e bimësia e shumëllojshme rreth e përqark.

Pas derës, Soni, që kish mbetur si guak, më në fund i gjeti forcat, sa për t'i kthyer përgjigje pyetjes së teta Letës, se kë kërkonte:

- Desha pak Bred Pitin!

Teta Leta, mendoi pak dhe si tundi supet u përgjigj:

- Më vjen keq, mor djalë, po nuk e njoh...
Pyet një herë andej nga pallati!

Soni u kthye pas, dhe, si për të shfryrë inatin,
i grahi biçikletës me sa fuqi kishte.

ERI

N

uk e di pse atë pasdite pata një parandjenjë të çuditshme, se diçka do të ndryshonte në rrjedhën normale të jetës, me të cilën qemë mësuar... Në fakt, në familjen tonë prej pesë vetash ne bënim një jetë modeste, të thjeshtë, me dy rroga , që mezi të çonin deri në fundin e muajit, plot ankesa për një dritë të lënë ndezur kot, për një pjatë gjellë të tepruar nga vakti i mbrëmshëm, të harruar mbi tavolinë e që, tashmë e prishur, duhej hedhur e plot kërkesa të paplotësuar të njërit apo tjetrit...Megjithatë, kjo edhe falë temperamentit të nënës, që ishte tip i butë e kurrë nuk bërtiste, deri para tre ditësh, në përgjithësi ne bënim një jetë të qetë, jo si komshinjtë përballë, që griheshin copë e çikë natë për natë. Thashë deri para tre ditësh, se, si papritur e kujtuar të kishte lëvizur boshti qëndror, apo, thua se shamata ishte një sëmundje ngjitëse si gripi i derrave, u “infektuam” edhe ne.

Nuk e di si më erdhi, po këtë parandjenjë e pata, sapo u ndava nga Shejla e ngjita shkallët...Futa çelësin në bravë të hapja derën, me mendimin se askush s’do të ishte në shtëpi, po e kuptova, se dera ishte e mbyllur nga brenda dhe çelësi ishte në bravë. I rashë ziles, dhe prita ca,

deri sa më në fund dera u hap dhe nëna, që, edhe pse u përpoq të më buzëqeshte, dallohej nga sytë e ënjtur, që kishte dënesur...

- Erdhe, shpirt? - më foli me një zë që, ende nuk qe zhveshur plotësisht nga ngashërimi.

- Ti ke qarë! - i thashë pa e bërë më dysh.

- Jo, e kam nga qepa!...Eja, hyr!..- tha lehtë dhe bëri drejt kuzhinës edhe për t'u shmangur pyetjeve të tjera, që sigurisht do t'i bëja.

Nuk e ngacmova më.Tek e fundit njeriu ka nevojë të qeshë, po edhe të qajë. Madje grave dhe vajzave sikur u shkojnë lotët, edhe kur s'janë nga qepët...Sa për burrat, kurrë s'do të kisha dashur të shoh një burrë që qan!

Hëngrëm pa folur vetëm ne të dy. Ola dhe Elma, dy motrat e mia më të vogla, njëra nëntë e tjetra shtatë, e kishin shkollën pasdreke dhe nuk ktheheshin në shtëpi deri në orën pesë, pak a shumë rreth një orë para babait, i cili punonte si elektrikist e mirëmbante makineritë në një ndërmarrje private, që prodhonte këpucë për eksport . Siç thoshte ai, i binte bretku në punë, po pronari ishte një cingun që ta merrte shpirtin gjithë ditën, po lekë të jepte fare pak... Megjithate, gjithnjë e më shpesh babai kish nisur të vonohej dhe, që nëna të mos bëhej merak, e lajmëronte se kishte një defekt në ndërmarrje, apo po bënte diku një punë ekstra jashtë orarit... Në u shtohej gjë të ardhurave unë nuk e di, veçse asgjë nuk kishte

Mustafa Tukaj

ndryshuar në standardin e jetës, asnjë orendi e re nuk qe shtuar në shtëpi, po ai televizor që kur kisha lindur unë, po ai frigorifer që shpesh kërkëlliste, po ajo makinëlarëse e dhuruar nga gjyshi dhe po ato mobilje, që kur prindërit e mi kishin hyrë në këtë apartament, këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë... Sa për celularin që më kishte premtuar vitin e kaluar për ditëlindje, më ishin ftohur shpresat. Zor se e kishim vaktin ta blinin tani për tani!

Por siç thashë më lart, edhe pse ngushtë, ne qemë mësuar të shtrëngonim rripin, apo, siç thonim shpesh, të shtrinim këmbët sa ç'kishim jorganin, të shkonim mirë me njëri- tjetrin dhe t'i kalonim situatat me shaka e të qeshura...Kjo deri para tri ditësh! Se para tri ditësh plasi një sherr i paparë mes dy prindërve të mi, sa, që të mos të mos bëheshim lajmi e gazi i botës, gjëja e parë që bëra, vrapova të mbyllja dritaret, pastaj u hyra në mes dhe, kur e pashë se asgjë s'bënte dobi, u mbylla derën...Po shpejt e hapa prap, se më erdhi keq për nënën, që zuri të qante nën breshërinë e fjalëve dhe sharjeve të babait. Asnjëherë nuk kisha dëgjuar më parë nga goja e një njeriu, deri atëherë jo agresiv, atë varg aq të gjatë sharjesh, ku lakoheshin gjyshërit e mij nga nëna, dajallarët, kushërinjtë e nënës deri në tre breza, fisi e sorollopi me kuç e me maç; idiotësia, tutkunllëku, ngathtësia, koprracllëku, e ku di unë tjetër se

çfarë...Veçse jam i bindur, që nga kjo pasuri e padiskutueshme sharjesh, që do ta kishte patur zili edhe vetë Kristoforidhi, im atë shpërfaqti një talent për t'u patur zili në këtë fushë dhe pa diskutim atë natë mund të kishte fituar një çmim oskar, kurse nëna ca shtrëngime zemre, që mund të kishin shkaktuar një parainfarkt... Im atë, që shpejt u kuptua, se kutërbonte alkool, u bë menjëherë esëll, e shtriu në divan dhe i lagu ballin me ujë të ftohtë dhe ...me lot... Hera e parë, që unë ndjeva një lloj ngërçi në shpirt, një lloj ftohtësie, a thua se burri para meje ishte një i panjohur dhe jo ati im, biri i së cilit në ato momente nuk do të doja të isha... Nuk qeshë në gjendje, as prap nuk jam, të shpjegoj, se si një njeri që do,(prindërit e mi qenë martuar me dashuri) mund të nxirrte gjithë atë baltë e vrer ndaj një njeriu të dashur si nëna ime, që nuk meritonte, as të shihej vëngër? Nuk e mora vesh as shkakun e kësaj zënke, që, disi e zbutur e me tone më të ulura dhe jo në praninë tonë, kishte tri netë që përsëritej e që, ndoshta, ish bërë shkak i lotëve të nënës para se të vija unë...

Gjithsesi dy-tre herë u përpoqa ta ngacmoja e ta largoja nga mendimet, ku qe zhytur e tëra, po ajo më shmangej e përpiquej të më buzëqeshte, gjë që vetëm mbeti në tentativë. Vetëm një herë më vuri dorën në sup, më pa drejt me sytë e saj të shkruar e me bisht(pa tualet), ndoshta u mat të më hapte zemrën, po vetëm tha:

Mustafa Tukaj

- Të pastë nëna! - dhe doli në ballkon.

Unë u solla e u pështolla me libra në duar, po këndej më hynte e andej më dilte. Nuk po përqëndrohesha fare, megjithëse të nesërmen kishim një test të rëndësishëm në histori, ku unë edhe e kisha pisk...Lënda nuk është se nuk më pëlqen, po ka shumë data e imtësi që duhen mësuar përmendësh dhe mësuesja është e paaftë. Si është e mundur të bëjnë nëndrejtoreshë një të paaftë? Ajo veç të bërtasë di! Apo nuk ka një zë, që të shpon veshët si pigzë e që dëgjohet deri tek stacioni i trenit, sa pasagjerët e ngatërronin për sirenë...

Nuk më zinte vendi. Mora në telefon Shejlën.

- Është heret - m'u përgjigj - po ti eja, eja, thotë babi, se mund të bëni një shah!

Feja vetë! Ku ka si shahu! Shahu është ilaç. Tamam i përshtatshëm për momentin.

- Po shkoj nga Shejla! Do të mësojmë bashkë! - i thashë nënës, që sigurisht nuk kishte dëgjuar ç'më kishin thënë nga ana tjetër e telefonit.

Ishte mëkat t'i gënjeje ata sy të pastër, e di, po s'doja ta zgjasja më shumë.

Në shtëpinë e Shejlës është vërtetë parajsë dhe prindërit e saj ëngjëj. I ati, xhaxhi Bujari, mjek familje në lagjen katër, është babaxhan e shpirt njeriu. Arminda, e ëma, mjeke laborante në poliklinikën qendrore, sikur nuk flet, po veç mjaltë

nxjerr nga goja.Kjo Shejla është djallushkë e nuk u ngjason fare, thua se nuk e kanë linduar ata, po e kanë gjetur mbas ndonjë kaçubeje...Mua më duket, se shpesh nuk është e vërtetë fjala e urtë popullore: “Bëmë, baba, të të ngjaj!”Ja më shihni mua! Ngjasoj unë me tim atë? Askush s’do të mendonte kështu, po të na shihnin bashkë. Ai i ka sytë e zi e të mëdhenj, unë të vegjël e ngjyrë kafe, ai deri pak ditësh i butë e i urtë, unë shpuzë e i lëvizshëm, ai... Prit, mos e thuaj atë fjalë!... Ndoshta ka ndonjë hall, se është tjetërsuar krejt kohët e fundit...Po pse të ulërijë ashtu e të shajë kotnasikoti? E kë, nënën, që nuk trazon as mizën! Po ku i dihet, mbase edhe unë mund të shaj në një rast të tillë, kur të rritem!...

- Ej, bablok! Humbe torrën! - më solli në vehte xhaxhi Bujari.

- Ani!Kam edhe një tjetër! - thashë, si për t’i dhënë zemër vetes dhe u përqëndrova i tëri për të përmirësuar situatën, që e kisha katranosur si një fillestar. Nuk doja të humbisj. Në fakt dy - tri herë, që kishim luajtur bashkë, unë kisha fituar pa ndonjë mund të madh. Xhaxhi Bujari nuk luante edhe aq mirë, po kishte shumë sedër dhe mua më pëlqente, kur e shihja atë njeri në përgjithësi të qetë, që kafshonte buzët nga tensionimi, po ndoshta edhe nga turpi, që po mundej nga një çunak, i cili, po të kishte pritur nëna ime edhe katër ditë e rastësisht të na kishin ngatërruar me

Mustafa Tukaj

Shejlën në maternitet, mund të isha, fare mirë, i biri! Jo, unë kisha tjetër kënd për baba dhe një fëmijë, që lind, nuk mund t'i zgjedhë prindërit...Sigurisht, që unë nuk mund ta fajësoja dhe gjykoja tim atë, pse ai nuk kishte qenë në gjendje të na krijonte një jetë më të mirë...Ai qe përpjekur, me sa kishte mundur ta bënte këtë, po tek e fundit, të gjithë s'mund të jenë të barabartë në këtë jetë...Të paktën, të bënte çmos e t' i jepte dum hallit, që e kishte zënë e të mos na e prishte atë jetë të thjeshtë, por të qetë...

- Ohu, sot qenke byk fare! Mat! Shiko, qerrata, se mos ma le vetë? Hajt, të bëjmë edhe një tjetër!

Nuk më luhej, po edhe nuk më ikej prej aty. Shejla vetëm një herë doli nga dhoma e saj, dritarja e së cilës binte në verandë, kurse teta Arminda më nxiti:

- Për kokën time po s'e munde!

Ia nisëm prap. I shkunda mendimet, që më kishin trazuar nga lotët e mamasë dhe e munda tri lojë rrjesht.

- Dorëzohem! Po dije mirë, se unë jam një kokëderr i madh, do të studioj teori shahu e do të të shqep!

- Po, po, na e mbushe mendjen! - e ngacmoi e shoqja.

Unë u ngrita. Shejla doli e më përcolli deri tek dera.

- Ç'ke?! Sikur nuk qenke në formë sot pasdreke?

- Më dhëmb kurrizi!

- Na shkrive! Mirë, mirë, ik mëso tani, të përmirësosh notën nesër! - dhe e mbylli derën.

Këmbët nuk më çuan majtas drejt shtëpisë, po andej nga qendra. Brodha kuturu si endacak i papunë, pa kurrfarë qëllimi, a thua, se kastile po vrisja kohën, deri në një orë të caktuar, kur do të më prisnin të papritura të tjera aspak të këndshme...

E para ndodhi vetëm pesë minuta, pasi kalova godinën e teatrit dramatik e po i afrohesha memorialit të dëshmorëve të luftës. Po ecja ngadalë në trotuarin e porsashtuar me pllaka të reja, kur, a thua se ishte një dem toreadorësh, erdhi e u përplas me mua një burrë trupmadh si katalla e syshakshi. Jo vetëm që nga përplasja rashë si plënc për tokë, po katallani më ngriti në këmbë e më zuri për veshi aq fort, sa thashë, se ma këputi e më la me një vesh për tërë jetën!

- Mistrec! Pse s'shikon para! - thërriste me një zë basi, a thua se unë isha fajtori e jo ai, që qe hutuar mbas një bjondeje me minifund, e cila posa më kishte parakaluar.

Nuk e di si i shpëtova nga duart dhe krisa me vrap pa i kthyer përgjigje, kur ndesha bash në atë, që s'do të kisha dashur të ndeshja kurrë, mësuesen e historisë.

Mustafa Tukaj

- *A,a,a! Bukur, shumë bukur, Shkreli! Kështu përgatitesh ti për testin e historisë?*

- *Jo, mësuese, vetëm po shkoj në farmacinë qëndrore, se kam motrën sëmurë! - i thashë të parën broçkull që më ra ndërmend.*

- *Shiko, se, mos më gënjen, se të djeg, pastaj!*

- *Jo, mësuese, ç'ne! Ja, tani do të kthehem! Nuk e patë që po vrapoja? - thashë me të shpejtë, duke u lutur me mend të mos më kërkonte recetën, gjë që do t' i vinte kapak dhe duke imagjinuar, se me çfarë do të më digjte...*

U përpoqa edhe t'i buzëqesh, që t'i krijoja sadopak simpati , po as edhe një muskul i vetëm nuk i lëvizi, a thua se po më kalonte me rrezet iks të syve të saj si të një maceje nepër mendimet e mia, për të vërtetuar në gënjeja apo thoja të vërtetën...

Kur më ktheu shpinën, mora frymë i lehtësuar dhe vazhdova më tej. Interesant, kurrë nuk e kisha dashur këtë mësuese inatçore dhe të paaftë, që e kishin bërë edhe nëndrejtoreshë! Është e kuptueshme, se mua ajo nuk më ndërronte as për mish dashi dhe priste, vërtetë, rastin të më digjte të gjallë!... Shkaku zinte fill tre javë më parë, kur në një orë mësimi, ajo po shpjegonte me libër para, unë e kisha korrigjuar, duke e bërë qesharake para klasës...Sigurisht që unë mund edhe t'ia kisha thënë më me takt, por të them të

drejtën nuk u përmbajta, kur në vend që të thoshte Karli i Pestë, numrin romak “V”, domethënë pesë, e lexoi si germën shqipe “V”. Kjo ndodhi dy tre herë deri sa unë e korrigjova. Nuk do ta harroj kurrë se si u skuq fytyra e saj dhe ç’zjarr inati i morën sytë e saj si të maces...

Gjithsesi, rreziku kaloi dhe unë, nga frika se mos peripecitë e padëshirueshme s’do të kishin të sosur këtë të martë pasdreke, vendosa të kthehesha në shtëpi...Hajde e zëri besë pastaj horoskopit, që mua, me shenjën e akrepit, si ditë shansi më kishte përcaktuar pikërisht ditën e martë!...

Në shtëpi, me sa dukej, situata ishte më e qetë. Motrat kishin ardhur nga shkolla dhe nëna prap më vuri dorën në sup, kur më hapi derën.

- Mësuat gjë?

- Po, por do të vazhdoj prap! - thashë dhe putha Elmën, motrën e vogël që m’u hodh në qafë.

- Mos bëni zhurmë! - u thashë të dyjave dhe shkova në dhomën, ku mësoja dhe flija njëkohësisht bashkë me motrat, se aq shtëpi kemi; në njërën dhomë flejnë prindërit, në tjetrën unë dhe motrat, një kuzhinë e vogël dhe korridori, që e shfrytëzonim edhe si vend pritje për miqtë. Kuptohet edhe banjoja!...

Nuk kishin kaluar as njëzet minuta që unë, duke e ditur mirë, se deri ku mund të shkonte inati i mësueses, po bëja të pamundurën të regjistroja

Mustafa Tukaj

në kujtesë gjithë atë mori datash e faktesh të një kapitulli të tërë. Kurrë nuk e kam kuptuar, se pse ata që bëjnë tekstet e programet mësimore, kanë maninë të na i ngarkojnë lëndët e ndryshme me emra e data të panumërta, që vetëm pas një muaji, apo edhe më parë, të zhduken nga kujtesa si gjëra të pavlera, veçse të hanë kohën e të turturojnë kotnasikoti...Lë pastaj, kur përveç mëkatit të teksteve, të bie për hise edhe një mësuese historie si Irini!

Në korridor ra zilja e telefonit. Irrak, ma bëri në shpirt dhe u turra ta kapja i pari dorezën, po mamaja, për sherr, që ndodhur aty pranë, kështu që s'më mbeti gjë tjetër, veç të uroja të mos më më dilte parandjenja që pata.

- Urdhëro! - foli me zë të ulët mamaja, që me sa dukej edhe ajo priste një telefonatë, - Po, familja Shkreli jemi! A ,a, si jeni zonja mësuese?! Mirë keni qenë? Urdhëroni!Po, po këtu është! Doni t'ua thërres?

Unë fillova pantomimën time me duar e këmbë, duke dashur t'i shpjegoja, se ç'duhej të thoshte, po më shumë e hutova me paaftësinë time në këtë fushe, se sa ia fitillova atë që doja.

- Vajza?! - mbeti një çast si e shtangur mamaja, që vetëm, kur ia thashë gati me zë, u fut në temë dhe e ktheu pllakën.

- Po, ja...ashtu... si fëmijët e vegjël!... Po... po...e dërgova unë... Ju faleminderit shumë!... -

dhe uli dorezën, duke më parë drejt e në sy me një shikim që më vrau më shumë se një shuplakë.

- Më fal, nënë, dola vetëm pak për t'u çlodhur dhe e takova rrugës!...

- Të lutem, kurrë mos më gënje! Është e keqe gënjeshtër! - tha dhe humbi në trishtimin e saj...U afrova dhe i mbështeta kokën në gjoks. Ajo vetëm sa më zuri për krahu...

U futa përsëri në dhomë dhe punova me ngulm deri sa erdhi babai.

Ishte tym. Ta kapje për hunde, i dilte shpirti, po nuk kishte pirë. Ashtu m'u duk .Nuk futi gjë në gojë, megjithë përgjërimet e nënës, po drejt e në dhomën e gjumit. Nëna i shkoi pas. Deri vonë nuk u fik drita në dhomën e tyre, po unë nuk arrita të marr vesh asgjë, se flisnin me zë të ulët. Të paktën nuk po bënëin shamatë! Po ç'hall kishin dhe pse nuk më tregonin?!... Unë më kot prita deri vonë, se mos dilte o njeri o tjetri e mund të merrja vesh diçka...Isha ndër të paktit, që nuk kisha paguar ende lekët e ekskursionit, po a kishte kuptim, që në një atmosferë të tillë aspak të paqtë, ku, me sa dukej, më fshihej diçka jo edhe fort e lehtë, unë të kërkoja para?! Duhej pritur për një çast më të përshtatshëm!

KOPJA

A

jo, që mësuese Irini, si një hakmarrëse primitive e shpirtvogël, kishte pritur prej kohësh të vinte, erdhi pikërisht në orën e fundit, kur po bënin testin e historisë. Të gjithë nxënësit, të ndarë në grupe të ndryshme, kishin ulur kokat e shtrydhnin trutë për të kujtuar ngjarjet e datat e shumta e për t'i hedhur në fletët e bardha. Po Nimfën, që rrinte në një bankë me Erin, nuk po e zinte vendi. Ajo priste, sa

mësuese Irini, që ecte nëpër klasë si xhandar, të kthente shpinën dhe jepte e merrte me duar me Enxhin, që ishte në një grup testimi me të, po bankën e kishte në rreshtin tjetër. Më në fund Enxhi e kuptoi, si e kishte hallin shoqja e ngushtë, nxorri një pusullë, shkroi diçka në të dhe ia hodhi Erit, të cilin e kishte në krah. Ai qe përqëndruar i tëri në përgjigjet e tij dhe pusulla e mbledhur shuk i erdhi si predhë krejt e pabef e ai nuk e priti dot...Ajo u përplas në zvergun e tij, ra mbi bankë e prej aty për tokë. Instinktivist u ul ta marrë, po bash në këtë moment mësuese Irini ktheu kokën shpejt, si të kishte qenë në pritë dhe thirri si roje:

- Mos lëviz!

Gjithë klasa ngriti kokat. Eri nuk lëvizi. Mësuese Irini, me sytë e saj si të maces, që i flakëruan nga gëzimi, u afrua me hap të shpejtë dhe zgjati dorën:

- Ma jep mua kopjen, Shkreli!

Ai ia zgjati.

- Ti je hileqar, Shkreli! Nuk ndërtohet jeta mbi hile!

- E keni gabim, mësuese! Ajo letër nuk ishte për mua...

- Për kë ishte? Fol!

- Nuk di...

- Kush e hodhi ?

- Nuk e pashë, po shkruaja...

Mustafa Tukaj

- Mirë, atëherë, dorëzo testin dhe dil jashtë!
Më prit në drejtori!...

- Mësuese, po jua përsëris, nuk kam faj..

- Jashtë dhe mos e zgjat!

Në klasë s'pipëtinte as miza. Askush nuk e kishte e parë Enxhin, kur kishte hedhur letrën dhe të gjithë po mendonin, se Eri ishte fajtor...Po Enxhi dhe Nimfa heshtën...

Eri u ngrit pa thënë asnjë fjalë, i hodhi sytë për një çast Enxhit, la mbi tavolinë fletën e testit dhe doli jashtë.

Mësuesja kujdestare, Vjollca, nxitoi të vinte menjëherë në drejtori. Irini, e cila atë ditë luante edhe rolin e drejtorit, i cili mungonte për arsye shëndetsore, me të hyrë mësuese Vjollca e priti me këmbët e para duke thirrur me zë të lartë:

- Duhet të bëni punë më të madhe edukative me nxënësit tuaj! Nuk mund të lejojmë që ata të na mashtrojnë, të kthehen në rrugaçë, të gënjejnë, të na hipin në qafë! Kurrën e kurrës nuk do ta lejoj në këtë shkollë një gjë të tillë!

Mësuese Vjollca, që ende s'po merrte vesh ç'kishte ngjarë, me sy të habitur pa njëherë nga Eri, si për të mësuar shkakun e këtij rrebeshi, pastaj iu drejtua nëndrejtoreshës:

- Më falni, nuk po kuptoj asgjë! Si është puna?

- Ta thotë ky bandilli këtu! Pyete, pyete!

Mësuese Vjollca e nuhati menjëherë nga mënyra, se si Erit iu përshkënditën sytë, që ai edhe mund t'i kundërpërgjigjej një toni të tillë aspak pedagogjik, ndaj iu kthye më të butë:

- Si është puna, Eri, çfarë ke bërë?

- Unë?! Asgjë s'kam bërë...

- Po gënjen! - u hodh si kaposh mësuese Irini

- Ja ku është fakti! - tha dhe zgjati shukun e letrës, me pamjen e një gjykatësi triumfator, që i tregon armën e krimit një të pandehuri...

- Nuk gënjej! - ngriti tonin Eri dhe e vështroi me inat.

- Nuk gënjen? Po kjo ç'është atëhere?

- Merrni hetuesinë! Ato mund të gjejnë edhe gjurmët e kriminelit!..

- Ke edhe guximin të tallesh! I paedukatë!

- Mësuese... - u mat të thoshte diçka, po u përmbajt.

Mësuese Vjollca e mori letrën dhe e hapi.

- Ç'është kjo? - pyeti Irinin.

- Nuk e sheh, se është kopje e një nxënësi mbetës në lëndën e historisë, që më vjen tapë topi në klasë, pse brendh varavinga tërë pasdreken?

- Mësuese...

- Mbylle gojën po të them! Kaq të të bëhet dhëmbi, në ke për të kaluar në lëndën time!

- Eri, është e vërtetë se ke kopjuar? - desh të zbusë mësuese Vjollca, po Irini u egërsua edhe më shumë.

Mustafa Tukaj

- Ju vini në dyshim fjalët e mia?

- Jo, po edhe djali duhet dëgjuar!

- Ashtu? Domethënë, unë të tregoj ujkun, e ti më pyet se ku janë gjurmët!Kështu?!

Në vend të mësuese Vjollcës u përgjigj Eri:

- Ujku është në pyll, kurse këta janë gjurmë çakalli!

- Do të shohim, ç' bilbil do të jesh, kur të të tregoj rrugët!

- Një minutë, një minutë! - përpiquej mësuese Vjollca të qetësonte, se biseda kishte marrë ters, e s'dihej si do të përfundonte.

- Eri, mund të më shpjegosh të lutem, ç'është kjo copë letër?

Eri e hapi dhe e pa.

- Kopje është!

Irinit i shndritën sytë, nga shendi, se fajtori më në fund po pohonte...

- Por ky nuk është shkrimi im dhe nuk ka qenë për mua, sepse këtu është përgjigja e grupit tjetër...

Mësuese Vjollca pa nga nëndrejtoresha.

- Kush ta hodhi? Për kë ishte?!- Irini lëshoi dy pyetje rrufe si dy të shtëna pushke.

- As nuk pashë, se kush, as nuk di, se kujt!- iu përgjigj Eri gati me po atë ton.

- Dil jashtë, i paedukatë dhe nesër nuk të pranoj në shkollë pa prindin!Ti mësuese prit pak!

Eri doli.

- Ti je e re në shkollën tonë, ndaj mos ua kreh shumë bishtin rrugaçëve si Shkreli! – iu drejtua mësuese Vjollcës. - Ai duhet përjashtuar nga shkolla!...

- Gabuat, zonja nëndrejtoreshë! Ju e shatë dhe fyet disa herë, atë djalosh! Më fal, se, vërtetë jam e re në këtë shkollë, po unë nuk do t'i flisja kurrë kështu një çunaku në moshë të tij, aq më tepër, kur, me sa kuptova, ishte i pafajshëm...

- Ashtu?! Po na i dilke edhe në krah?

- Do t'i dal, kur ka të drejtë dhe sepse kjo është puna jonë!

- Nuk më tregon ti punën, zonja mësuese! Nëqoftëse do të qëndrosh në këtë shkollë, do të zbatosh disiplinën e kësaj shkolle, se kurrën e kurrës nuk do të lejoj ta kthejmë në han!

- Prap gabuat, zonja nëndrejtoreshë! Ju nuk më keni sjellë këtu, dhe nuk e keni në dorë ju të më hiqni prej këtu...Sigurisht, ju e keni në dorë të bëni tuajën, po kjo s'ka pikë rëndësie. E rëndësishme është, se ju e lënduat shumë atë fëmijë dhe ndikuat keq për figurën tuaj në sytë e tij!

- Nesër ai fëmijë të mos lejohet në shkollë pa prindin! - tha ajo prerë dhe i ktheu shpinën mësuese Vjollcës, si për t'i thënë të dilte.

Oborri përjashta ishte boshatisur.Vetëm Shejla e, kuptohet Redi, po prisnin Erin të dilte nga drejtoria..

Mustafa Tukaj

- Sa po vonohet!... - tha më në fund Redi.

- Ik, ti, se mos bëhesh vonë e të pret babai!..

- Jo, ç'ne! Babi vjen, vetëm kur i bie rruga!

Se mos jemi të vegjël tani! - tha ai e lëvizti supin, si për të përforcuar atë që tha. Pastaj, si të kujtohej rastësisht për diçka, hapi çantën dhe nxori që aty një çokollatë në formë zemre.

- Këtë nuk e ke provuar asnjëherë. Provoje!
Është Milka...

- Paska formën e nje zemre...

- Është shumë e shijshme!

- Kush, zemra?

- Jo, çokollata...Nesër do të sjell një Kit-Kat.

Ështe edhe çokollatë edhe vafer...Një herë një shoku i ngushtë i babait hëngri dyqind kallepë kit-kat dhe nuk u sëmur...

- Pse s'thua, se qenke ekspert çokollatash?

- Jo unë, po babi.Ky është biznesi i tij. Bredh në tërë botën...

- Po unë e kam parë shpesh makinën e tij...

- Ka ca kohë që nuk lëviz. E ka shumë mik kryeministrin...Do të bëhet deputet...

- Lum si parlamenti! Do të shqepet me çokollata! Po opozitës do t'i japë?

- Ti tallesh...

- Jo e kam me tërë mend dhe ti paske goxha të ardhme! - tha dhe këputi një kallëp çokollate, që menjëherë iu shkri në gojë.. - Qenka vertetë fantastike!

- Babi është shumë i pasur...

- Dhe ti je djalë i vetëm...

- Gjithçka është për ty, më thotë babi, vetëm të shkëlqej në mësimet..Po unë vetëm biologjinë pëlqej...Dua të studioj biologjinë molekulare...

“ E teprove, Redi! Ja tregove përnjëherësh të gjitha zorrët e barkut...Pak nga pak, se pastaj nuk ka më interes...”

- Po ti, Shejla, vajzë e vetme je?

- Kam një motër më të madhe...Është për master në Paris...Kam edhe një qen...

- Del mbasdrekeve me qenin?

- Edhe dal...

- Sa qejf! Unë i dua shumë qentë! Po mami nuk i duron dot...

- Të lënë të dalësh vetëm?

- Si jo? Babi vjen e më merr me makinë, se e kemi shtëpinë larg në periferi...Unë vetë shkoj në stërvitje...

- Epo, mund të shihemi ndonjëherë...

- Vërtetë?! Unë...

- Erdhi Eri! - tha dhe bëri dy hapa drejt tij.

- Hë, more çun, si shkoi?

- Për dreq! Desh më hëngri!

- Nuk dukesh, se ke gjë mangut, i tëri qenke!

Na, merr një copë çokollatë, se të bën mirë! - dhe pa pritur që ai të hapte gojën mirë, ia rراسi krejt, sa ai desh u mbyl!...

Mustafa Tukaj

- Avash, se më kafshove gishtin! - tha dhe i ra me grusht shpinës. - Hë, të kaloi?Tani fol!

- Ç'të flas? Ma bëri borxh! Të mos ishte mësuese Vjollca, kushedi si do të kishte shkuar...

U dëgjua boria e një Benzi. Redi u drodh.

- Vrapo Redi, se me ty e kanë, më duket! - i tha Shejla dhe u përpoq t'i japë një të shtyrë, po as që e lëvizi nga vendi qoftë dhe një milimetër.

- Bah, sa i shëndoshë që je! - i tha si për t'ia plasur zemrën.

Redi u përpoq të mos e japë veten, po përbrënda ziente i tëri. Nuk u tha as drekën e mirë, po u ktheu shpinën prishaqejf dhe shkoi tek makina, ku po e priste shoferi:

- Ik ti, Gimi, ik, se unë kam një punë!..

- Ani, po të pres pesë minuta...

- S'ke ç'pret, mund të vonohem...Ne të tre jemi organizatorët e ekskursionit në Sarandë dhe po bëjmë planin...

- Luajti këmbët, se më duhet të të çoj ty në shtëpi e pastaj të shkoj me babin në aeroport.

- Po ç'ke ti, shkoj vetë!..

- Kam urdhër. Unë zbatoj urdhrin...Hip! Më vjen keq, po s'kam ç'të bëj, flisni nesër për ekskursionin... - tha dhe i luajti syrin. - Hip, se do të tërbohohet yt atë, po nuk i shkova në kohë!

Redi, që ish bërë spec i kuq në fytyrë nga inati, u kthye nga ata, u bëri me dorë dhe u rras

hundë e buzë në sediljen e rehatshme të asaj makine luksoze, që ai s'e shihte dot me sy...

- Kush e hodhi kopjen? - pyeti Shejla, si kishin dalë nga porta e madhe e shkollës.

- Më duket se Enxhi!

- T'i thoje mesueses...

- Pse ç'jam unë, spiun?

- E mirë, atëherë, haje ti!

- Ajo duhet të flasë vetë...

- Qenke budalla! Pse të flasë ajo, kur hesht ti?!

... Vetëm disa metra më prapa, në atë trafik të dëndur plot makina e kalimtarë, Soni, si një hije e stërgjatur e atyre të dyve mbi trotuar, që po shkriheshin gazit me njeri tjetrin, ecte ngadalë me biçikletën e tij, pa ua ndarë sytë dhe pa qenë në gjendje t'u jepte dum mendimeve te tij të shumta... Ç'e shtynte këtë goxha djalë, të priste si roje pas mësimit ditë për ditë, me shpresë se mund t'i thoshte diçka kësaj çupëline mendjemadhe? Mos donte thjesht të hakmerrej, për atë që ajo i kurdisi një ditë tek porta e shtëpisë së saj? Mos kërkonte t'ia ulte hundën, që e mbante aq lart, apo përpiquej të vinte në vend sedrën e fyer të këtij pesëmbëdhjetëvjeçari, që nuk qe mësuar ta tallnin ashtu? Kishte ditë që përsëritej i njëjti rit, e ndiqte pas, si zagari të zotin, herë vetëm e herë i shoqëruar nga "grupi i garipëve", që po e tërbonin edhe më shumë me ngacmimet e tyre... Ata, sikur

Mustafa Tukaj

e pickonin a e kafshonin në qafë, kur i kujtonin se, meqenëse afati dyjavësh për ta shtënë në dorë kishte kaluar, ai e kishte humbur bastin dhe duhej t'i qeraste te “Katër Stinët”.

Një bori e egërsuar makine e solli në vehte. Pa e kuptuar kishte dalë nga korsia e biçikletave dhe kishte bllokuar një varg makinash... Ktheu kokën dhe i bëri me dorë për t'i kërkuar falje shoferit më të afërt, që hapi xhamin dhe iu hakërrua, mori korsinë e vet dhe hodhi sytë përpara.. Vetëm pasi u përqëndrua, mundi t'i dallojë tamam në çastin e duhur, kur ata po kthenin majtas...

U dha pedaleve me shpejtësi të shkurtonte largësinë dhe të priste çastin e duhur, po Eri, për habinë e tij, e shoqëroi deri tek porta e shtëpisë, madje, si për ta tërbuar fare, kur u hap porta, hyri bashkë me të...Po kjo e zezë?

Ktheu biçikletën dhe u sul si i çmendur...

ERI MËSON TË VËRTETËN

M

e flokë të qullura ende nga dushi, Soni mori çantën e shpinës, futi brënda rrobat e stërvitjes dhe tërë qejf i hipi biçikletës. I kishin mbetur në mendje fjalët e trajnerit të tij atë pasdreke, se stërvitjen e kishte ndjekur edhe profesor Titi, siç e thërrisinin të gjithë, ish futbollisti legjendë i qytetit, që tashmë drejtonte ekipin kombëtar U-17. Ai kishte thënë, se po të vazhdonte kështu, mund ta grumbullonte për eliminatorët e kampionatit europian...

Soni i dha trupit përpjetë, si për t'u shpirë, edhe pse kishte bërë me biçikletë vetëm nja njëzet metra. Ai e ndjente, se në ekipin e tij, ishte i veçantë, jo vetëm për trupin e tij lastar, që bënte figurë nga shkallët e stadiumit, po edhe për lëvizjet e shkathta e plot finesë me apo pa top, driblimet, gjuajtjet, shkëputjen e goditjet me kokë, sa spektatorët që ndiqnin stërvitjen, prindër, miq apo tifozë klasikë, e krahasonin me futbollistë të mëdhenj...Po, po, ai kishte një të ardhme të madhe! Vetëm se duhej përqëndruar më shumë...I vinte çudi, se si profesor Titi nuk i kishte vënë re

Mustafa Tukaj

ca shenja lodhjeje gjatë lojës, madje edhe ndonjë gafë...

Mori kthesën djathtas, rrëshqiti pranë bibliotekës, pastaj pranë një blloku dyqanesh luksozë dhe po bëhej gati të kthente nga hotel “Grand”, kur ndjeu zilen e telefonit. Pa u ndalur nxori celularin nga xhepi i djathtë, ngadalësoi shpejtësinë dhe u përgjigj:

- Hë, Zari! Po po, e mbarova stërviitjen. Ku je?! Ja erdha, erdha! Për dy minuta.

Bëri një gjysmë harku me biçikletë dhe u drejtua nga parku i blirëve, ku siç i kishte thënë Zari, po e priste atje.

E dalloi menjëherë, se ai po i bënte me dorë. Nuk ishte vetëm. Ishte edhe Enxhi me Nimfën. I njihte të dyja dhe e dinte se ato ishin shoqe të ngushta. I kishte njohur Zari, se kohët e fundit ai dilte nganjëherë me Enxhin. Në fakt Enxhi s’kishte të sharë, alamet goce ishte, po sikur mbahej ca me të madh dhe në fytyrë kohët e fundit i kishin dalë ca puçrra të vogla...Sigurisht, të moshës thuhej në të tilla raste, po që ai nuk ia shihte dot...Ajo vishej shik, me rroba të shtrenjta dhe i pëlqente të dukej ca më e madhe, se ç’ishte në të vërtetë. Sa herë që rrinin bashkë, ajo e shprehte hapur, se mezi priste të shkonte në shkollën e mesme, që të ishte ca më e lirë...Nuk jetonte me prindërit e saj, po me një xhaxha shumë të pasur, që nuk kishte patur fëmijë. Sa për

Nimfën, ajo ishte imcake, po mjaft tërheqëse dhe të tillë më shumë e bënë ato vetullat e holla të zeza, harkuar bukur dhe sidomos ca pikla e vogla kafe rreth hundës.

Tetori sapo kishte kapërcyer mesin e tij, po vera ende s'qe dorëzuar plotësisht. Dielli, që po zvarritej ngadalë drejt perëndimit, ruante ende ngrohtësi për t'u falur njerëzve të shumtë në park.

- Unë nuk do të rri shumë!- u tha Soni, si bënë disa hapa. - Nuk kam prekur asgjë me dorë për nesër...

- Ja, sa të pimë një Pepsi a një Red Bull...Ju qeras unë! - tha Zari.

- Nuk është puna aty, por ju thashë..E lëmë njëherë tjetër! - kundërshtoi Soni,

- Jo, mos ma prish, se dua t'ju them diçka. - nguli këmbë Enxhi.

Pa ç'pa i ndoqi pas drejt "Oazit". Mbështeti biçikletën për një pemë, ngjeshi mbi samar çantën sportive dhe i ndoqi drejt një tavoline diku në cep.

Sa erdhi porosia, Enxhi u kthye nga Zari duke e lënë Nimfën në siklet. E shkreta, s'po dinte, ku t'i çonte sytë dhe bënte ç'bënte e shihte majtas - djathtas, a thua se po kërkonte dikë. Soni e kuptoi që atë s'po e zinte vendi nga emocioni dhe për t'u treguar i sjellshëm e pyeti:

- Pret njeri?

- Jo, ç'ne! Ashtu kot...

Mustafa Tukaj

- Gëzuar! - i tha dhe ndeshi gotën me të sajën.

- Gëzuar!

- Hajde, tani vazhdoni se u thye akulli! - u tha Enxhi, që qeshi lehtë, a thua se këtë kishte pritur.

- Sikur deshe të na thojë diçka! - i kujtoi Soni, që as vetë s'e kuptoi, pse po i dhimsej Nimfa, tek e shihte ashtu në hall, me faqet si lulëkuqe nga fjalët e Enxhit.

- Po, dua... Sapo të kthehemi nga Saranda, kemi një festë tjetër. Në fillim në nëntorit kam ditëlindjen. Do të grumbulloj për një *party* vetëm miq të mi. Mund ta bëj edhe në restorant, po një mendje më thotë më mirë në shtëpi...Kemi goxha holl... Do të jetë një pasdreke magjike. Dhe ju jeni të parët që e merrni vesh. Kushti do të jetë që secili të vijë i shoqëruar me partner. Ma do mendja, se Soni nuk do t'ia prishë Nimfës për ta shoqëruar, apo e kam gabim?

- Sigurisht që do të vij, - u përgjigj Soni, duke e parë këtë si një rast të mirë për të vallëzuar me Shejlën e ndoshta për t'u afruar me të. Njëkohësisht nuk donte t'i ushqente, sidomos tani, ndonjë shpresë Nimfës, që thujse qe mekur fare në pritje të përgjigjes. - Ne do të jemi bashkë e do të gëzojmë bashkë të gjithë...

Ai nuk deshi të flasë më shumë, po e la merresitamarrësh, pa e mbyllur një shteg të tillë për të ardhmen...

Zari u kollit dy- tre herë.

- Ç' pate? - e pyeti Enxhi, që i vuri dorën në sup.

- Më shkoi keq! - tha ai, po sapo Enxhi u kthye për t'i thënë diçka Nimfës, i bëri shenjë me kokë Sonit andej nga trotuari. Ai u kthye me marifet dhe...desh u mbyt, kur pa Shejlën me një qen për dore, që po ecte mosprishaqejf me Erin. Ata të dy po gugisnin si një çift pëllumbash me njeri tjetrin.

E çoi me të shpejtë gotën dhe u ngrit.

- Unë po iki! - tha dhe u zgjati dorën.

- Prit, se po vij edhe unë, se kam një punë! - i tha Zari dhe duke e lënë disi të habitur Enxhin, po ai i luajti syrin dhe shkoi në banak të paguante.

Kur u kthye u dha dorën vajzave, duke u thënë buzagaz “ shihemi!” dhe u bashkua me Sonin, që po e priste me biçikletë për dore.

Nuk nxituan t'u shkonin pas, sepse i dalluan, që Shejla dhe Eri kthyen brenda në park dhe iu drejtuan një stoli. Ata të dy kaluan në trotuarin tjetër, për të mos tërhequr kërshërinë e vajzave, sidomos Enxhit dhe ecën ngadalë duke biseduar me njeri - tjetrin.

- Shko, takoje! Ke rast! - e nxiti Zari.

Mustafa Tukaj

- Po është edhe ai mistreci, që po ma bën borxh!

- Merrem unë me të! Sapo ta largoj, ti qepju asaj!

E bënë planin dhe hynë në veprim. Soni priti në gadishmëri diku para bordurave të parkut, kurse Zari, pa e vrarë mendjen fare, u afrua dhe, si i përshëndeti, i tha Shejlës:

- Më fal, goce, po kisha një muhabet me Erin...

Ata të dy shikuan njëri tjetrin. Eri tundi supet, duke mos e kuptuar objektin e bisedës dhe e pyeti:

- Me mua?

- Po, eja pak!

Eri u afrua. Zari i futi krahun dhe filloi të ecë nepër park ngadalë. Në fillim pa folur, tamam si nepër filma me spiunazh, a thua se shefi po bëhej gati t'i besonte agjentit të tij një mision të rrezikshëm. Kuptohet kjo bëhej për t'i dhënë kohë Sonit të hidhej në veprim. Dhe ai nuk ngurroi.

- Mirëdita! Paske dalë të shëtisësh me qenin?

- Jo, edhe me Erin, po se ç'pati me të shoku yt! - i ktheu përgjigje, për t'i dhënë të kuptojë, se kartat u zbuluan.

- Ishte e vetmja mënyrë, për të biseduar...Ai nuk të ndahet. Asnjë ditë..

- Ku e keni zyrën, që të vij t'ju pyes me kë të rri?

- Nuk kam zyrë, kam fushë futbollit...

- Tamam sporti që urrej më shumë!
Përderisa gjithçka varet nga këmbët!..

- Mos u bëj kaq e egër, se nuk je e atij
brumi...

- Nuk e dija, se qenke edhe bukëpjekës!

Sa gati që e kishte përgjigjen! Soni po ndihej
ngusht. Nuk dinte si t'i bënte ballë, kësaj
djallushke. Duhej të ndërronte taktikë.

- Po pse e ke zënë kështu me mua?...Mua
thjesht më pëlqen si shoqe...Nuk ka asgjë të keqe
të kesh një shok më shumë...

- Për t'u bërë shokë, ka mënyra më të
thjeshta, jo kurthe...Këto janë metoda të vjetra. Ke
nevojë për riformatim!...

- Të kërkoj ndjesë, nëse e more për të keq!

- Kam hall se m'u mërzit edhe qeni, pse iku
Eri...Nuk e shikon që i ka varur turinjtë e po të
shikon vëngër?...Hajde tani, se filmi mbaroi!
Thirre shokun tënd dhe drejt e në shtëpi!..Bëhu
çun i mbarë!

Disa metra më tutje, gjakrat kishin nisur të
ndezeshin, sepse, pasi ishte hedhur degë më degë,
më në fund Zari e kishte kërcënuar Erin, se do t'ia
ndrejte samarin, po ta shihte më me Shejlën...Qit
njeri e prit tjetri, punët do të kishin shkuar thellë e
muskujt kishin filluar të tendoseshin, sikur Soni të
mos i kishte çuar një zile Zarit. Ai menjëherë

Mustafa Tukaj

ktheu kokën, ia tundi edhe një herë gishtin tregues
Erit dhe u largua...

Soni u kthye edhe njëherë te Shejla:

- Harrova të të pyes, si e kishte emrin qeni?

Shejla mezi e mbajti gazin.

- Po të jap adresën e E_mailit: Bulldog
@yahoo.com. Hyni ndonjëherë në *chat* bashkë...

- Të faleminderit! - tha ai dhe u largua me të
shpejtë pa e kuptuar, në e kishte shuar apo i kishte
hedhur edhe më benzinë zjarrit, që ai nuk e dinte
ç'emër t'i vinte...

Eri u afrua ngadalë. I lënduar nga fyerjet e
kërcënimet e Zarit, po ziente nga brenda, por nuk
e dha veten. Ai vetem i hodhi një sy Shejlës, si për
të hetuar, se mos edhe ajo kishte gisht në atë
"komplot", por nga vështrimi i saj shfajësues u
bind, se ajo gjithashtu qe një viktimë. I bënë disa
metra pa folur. Me sa duket, gjendja e tij aspak e
mirë shpirtërore, e kishte hedhur hijen e saj të
zymtë mbi Shejlën dhe, si pa kuptuar, ia kishte
tretur fjalët e qepur gojën... Deri edhe Bulldogu
nuk po ndihej me kapriçot e tij, a thua se nuk ishte
fare aty. Nja dy herë deshi të lëpihej pas Erit, po si
e pa, se ai s'ishte në të, nxori gjuhën si për ta
përqeshur e nuk u ndie më...

Jo shumë larg prej aty, më saktë nga sheshi
qendror, erdhi furia e një thirrjeje të fortë që zgjati
për dy-tre minuta. Në atë buçimë kishte klithma
ngazëllimi simpatizantësh, britma partiakësh,

çjerrje autoparlantësh... Mitingu elektoral kishte arritur kulmin!

-Kur po mbarojnë edhe këto drej zgjedhesh, se na i shurdhuan veshët përnatë e përditë! - foli e para Shejla.

- Ç'ju vë veshin! Atë punë kanë, shamatë...

- Mirë e ke ti! More, se desh harrova. Nimfa më tha, se vetëm ti, nuk i ke sjellë paratë e ekskursionit...Pasnesër nisemi..Mos ke lojtur e nuk do të vish?

- Dua, po..

- Çfarë po?!

- Ndoshta nesër...

- S'ka ndoshta! Shiko, për kokën e babit, më vjen keq, po s'erdhe!

Erit iu mblodh një gulç në grykë, po ktheu kokën nga hoteli i ri njëzet katësh, që po ndërtohej përballë Bashkisë dhe bëri me gisht:

- Më kanë thënë, se këtë hotel, po e ndërton një zv/ministër vetëm me rrogën e tij, e beson?

- Sigurisht, i vockël do të jetë, njëzet katësh, aspak më shumë!

...Pa e ndjerë i qenë afruar rrugicës së tyre. Pa ceremoni i uruan “natën e mirë” njeri - tjetrit dhe Shejla hapi portën e hyri brenda.

Erit nuk i bënin këmbët të shkonte në shtëpi. Ende i rëndonin në veshë fjalët dhe kërcënimet e Zarit dhe djallëzia e Sonit. Në një situatë tjetër, do

ta kishte kaluar me të qeshur, siç e kishte zakon në raste të tilla. Po tani qe ndryshe. E dinte, se në shtëpi e priste po ajo atmosferë e rëndë e mbytëse e gjithë këtyre ditëve, me një heshtje të nderë pas zënkave, që ai nuk e merrte vesh, ç'shkak kishin e pse po zgjasnin kaq shumë. Tash e parë, kohët e fundit, njerëz të ndryshëm, të njohur e të panjohur, po e kërkonin të atin gjithnjë e më shumë në shtëpi, madje edhe në orët e vona të natës. Kishte raste që ndonjëri futej edhe brenda dhe ata bisedonin në korridor, po në më të shumtën e rasteve babai dilte përjashta te shkallët dhe atje se ç' bisedonin për minuta të tëra, herë me zë të ulët, që të mos dëgjonin komshinjtë e herë me ton të lartë e me fjalët që gjëmonin nepër shkallë. Nga prapa derës Erit i vinin në veshë fjalë të shkëputura dhe ai përpiquej përmes tyre të ndërtonte shkaku e kësaj gjendje, thua se nga copëzat e shkapërndara të një *puzzle*, po ndërtonte atë figurë që do t'i qaronte gjithçka. E kish pyetur të ëmën për këtë, por ajo i shmangej bisedës dhe e qetësonte me fjalë të buta, edhe pse pas tyre, ai e ndjente dhembjen, që asaj i sëmbonte aq fort në shpirt...E ndjente, se kjo gjendje jo vetëm që nuk po paqtohej, përkundrazi rëndohej gjithnjë e më shumë, deri sa të shpërthente, siç shpërthen një fortunë: në fillim me ca re të zeza, që vrapojnë të shtyra nga një erë e çmendur, e cila diku merr me vehte vorbulla pluhuri e zhubra letrash, diku

shkapet me forcë një derë të lënë hapur, diku me bulçinj të e saj shfryn një tufë zogjsh të lemerisur...Të gjitha këto ai i kishte ndjerë në shtëpinë e tyre. Madje ai kishte dalluar edhe vetëtimat e largëta, që aviteshin gjithnjë e më shumë dhe kishte dëgjuar kërcënimin gjëmues të bubullimës...

I ngjiti shkallët me përtesë. Për një çast ndali para portës e vuri veshin, se mos brenda kishte plasur sherri. I ra ziles. U dëgjua vrapi i Olës, që i hapi portën. Ajo iu hodh në qafë, si një e trembur që kërkon mbrojtje. Eri i preku flokët dhe, si të kërkonte të çlirohej nga një makth torturues, iu drejtua së ëmës, që po e priste në këmbë pranë bufesë:

- Dua të di gjithçka! Mjaft ma mbajte të fshehur!

- Shkoni të bëni detyrat! - u tha ajo Olës dhe Elmës dhe, kur ata, disi të habitura nga toni i pazakontë i nënës, hynë në dhomë, ia zbrazi atij të gjitha me një frymë, thua se sapo kishte lëshuar përdhe nga supet një barrë të rëndë:

- Babai ka hyrë thellë në borxhe...

REDI SHEH NJË ËNDËRR

N

ë periferi të qytetit, në atë lagje të re të krijuar vitet e fundit, që shumica e banorëve e njihte si “lagja e

të kamurve”, veçanërisht njëra prej shtëpive binte në sy. Për të shkuar deri tek porta e madhe prej hekuri të punuar me zbukurime, duhej të përshkoje një rrugicë jo shumë të gjërë, po të drejtë, të shtruar mjeshtërisht me pllaka guri ngjyrë purpuri dhe me palma të shëndetshme në të dy anët. Kur hapje portën, sigurisht, mbasi ishte vëzhguar nga kamerat e sigurisë dhe u ishte përgjigjur pyetjeve në një citofon në të majtë, duhej të mbaje frymën para asaj pamje që të ofronte ai oborr përrallor, që, siç kishte thënë dikush, me atë shumëllojshmëri lulësh, pemësh, shatërvanësh, bisedkash e ambjentesh të tjera, do t’i kishte konkurruar në bukuri edhe vetë Kopshtet e Semiramidës... Një kopshtar i talentuar, që paguhej majm, merrej tërë ditën e ditës ja me njëren lule, ja me tjetren, ja shkripte dheun e një lehe, ja plehëronte një tjetër...Thonë, se njëherë vetë kryeministri i vendit, që kishte ardhur për vizitë, i mahnitur nga bukuria e rrallë, i qe lidhur gjuha për minuta të tëra, pastaj në fund kishte thënë:

- Po ti jetoke si në përrallë, or Bim!

Bimi ishte babai i Redit.

Në atë pragmëngjes të butë mestetori, kur vera ende s’pranonte t’i lëshonte vendin vjeshtës, në dhomën e tij në kat të dytë, Redi vazhdonte të flinte për shtatë palë qejfe... Qe kthyer me shpinë nga dritarja e hapur, nga ku derdhej brenda një përzierje e mahnitshme aromash dehëse dhe bënte

ç'bënte e lëvizte bulçinjtë, thua se mllaçiste diçka... Mbi tavolinën e tij ngjyrë kafe të mbylltë, punuar me gdhendje, kishte mbetur i hapur materiali shtesë për konkursin e biologjisë, që me sa dukej, ai e kishte studiuar deri natën vonë, ndërsa te koka e shtratit, pranë abazhurit, të binte në sy një orë e veçantë, si prej fildishi, me fushë ngjyrë ari e me zogj të ndryshëm në vend të numrave, dhuratë e të atit nga Singapori... Gjëja më e bukur e kësaj ore te veçantë ishte se, sa herë që akrepi i madh kapte dymbëmbëdhjetën, për njëzet sekonda do të dëgjohej cicërima e zogut që shënonte akrepi i vogël... Kaq magjepëse ishin cicërimat e zogjëve të ndryshëm çdo orë, sa, po të mos e dije, do te vrapoje drejt dritares e do të shqyeje sytë, për të dalluar, në cilën prej pemëve përjashta kishte ndaluar ky zog i magjishëm. Sigurisht që në mbrëmje, Redi, bënte kujdes me anën e një butoni t'ua ndërpriste këngën zogjve, dhe siç thoshte ai "i vinte ata në gjumë". Në vend të tyre kurdiste sinjalin e zgjimit për në gjashtë e gjysmë, orë në të cilën ai ngrihej ditë për ditë. Po që të dëgjojmë sinjalin e alarmit, gjithashtu i veçantë, i ëmbël e jo cingrisës, do plot edhe njëzet e dy minuta, kështu që më mirë po shohim, në krahët e ç'ëndrre Redi ynë fluturon...

Në fakt nuk fluturon. Ka hipur majë një fiku të lartë, në kopshtin e gjyshit në fshat dhe rrufit ca fiq të mëdhenj e të ëmbël mjaltë... Pema është e

mbushur plot, po edhe oreksi i Redit është tashmë i njohur e i respektuar... Bah sa të mirë që janë! Përlaj fiq e barku rritu! As që i qëron fare, po ashtu, plluc e në gojë!...Dega tjetër, ku është kacavarur Shejla, paska ca kokrra të pjekura mirë!.. Hudhu Redi, kalo në egën tjetër, po kapu mirë, ama, se je ca i rëndë e mund të thyhet dega...

Një burrë me biçikletë ndalon më poshtë fikut.

- Djalo, ti je Redi?

- Po unë jam!

- Unë jam postjeri.Ulu, ulu poshtë, se të kam sjellë një letër.

- Ja, tani.. Do ca fiq?

- Jo nuk dua, se i kam dhëmbët e vënë...

Redi që e parandjen nga kush mund të jetë letra, rrëshqet teposhtë, pa pyetur për kilot që mban mbi shpinë.

E merr me të shpejtë zarfin dhe zemra i rrah. Nuk e ka mendjen tek postieri që i kthen shpinën dhe i grah biçikletës, po me të shpejtë gris zarfin dhe fillon të lexojë:

“ I dashur Redi, e lexova me vemendje letrën tënde dhe e kuptoj fare mirë gjendjen tënde shpirtërore, po ti nuk duhet të mërzhitesh, se koha pret. Unë mendoj, se ti je në rrugë të mbarë dhe një ditë zemra e brengosur do të të qetësohet! Mos ju ndaj për asnjë çast dhe herë pas here jepi dhurata, se vajzat i pëlqejnë ato...Të jesh i bindur

Mustafa Tukaj

se një ditë do të triumfosh mbi dy rivalët e tjerë dhe endrra do të të realizohet...”

Redi fluturon nga gëzimi. Përgjigja e psikologes e ka lumturuar së tepërmi... Ai e ndjen se koha e tij po vjen... Ai ngre sytë lart, për të parë Shejlën, po ajo nuk është më aty. E dallon diku larg në rrugën që të çon tek pusi i fshatit. Vrapon pas saj dhe tund letrën në dorë... Aty pranë nis një pyll i dendur, nga ku vjen gurgullima e një përroi dhe kënga e një qokthi... Sa bukur është në fshat! Ha fiq e dëgjo qokthin që e shton këngën!.. Edhe zhurma e lumit gjëmon tashmë më shumë...

I hap sytë. Në vend të pyllit është dhoma e tij. Ora mbi komodinë shënon gjashtë e tridhjetë minuta. E marrtë e mira! Paska qenë ëndërr! Letra e psikologes është zhdukur bashkë me ëndrrën... Ani, mesazhi i saj ishte krejt i qartë: Vajzat i pëlqejnë dhuratat!

Ngrihet dhe shkon në banjën e tij vetjake brenda në dhomë.

Poshtë, në katin e parë dëgjohej zëri prej basi i të atit, që i bërtet dikujt në telefon. Televizori jep lajmet. Që në pikë të mëngjesit politikë e fushatë zgjedhjesh. Ku i rreh çekani atij, e ku politikanëve! Po si është ndërtuar kjo botë, xhanëm dhe pse halli hallit nuk i ngjan?!

Para se të zbresë poshtë, i kthehet edhe një herë pasqyrës... O zot, sa i shëndoshë që jam!...

Kishin fluturuar si pa gjë të keq plot pesëmbëdhjetë minuta nga ora e zakonshme, kur ata të dy takoheshin për të shkuar në shkollë dhe Eri s'po dukej gjëkund. Shejlës i humbi durimi dhe, si mbylli portën e jashtme, disi e skuqur nga një inat i pashpjegueshëm, u nis e vetme me hapat e saj të shpejtë, që të mos mbetej mbas dere. Sidomos, tani që mungonte drejtori, mësuese Irini, kishte dhënë urdhra të rreptë, për të “forcuar disiplinën”.

“ Ç’ë gjeti sot? Mos është gjë i sëmurë? Po unë budallaqja, pse nuk e mora në telefon?”

Instinktivisht nxori celularin, po shpejt e futi brenda në xhep, se u kujtua menjëherë, që Eri ende nuk kishte një të tillë...

Por tamam tek kthesa e semaforit, ai i doli para, si të kishte mbirë nga dheu.

- Edhe sa duhet të të pres, zotrote? Nuk munde të më lajmëroje më parë, po më le të pres si hu gardhi?!

Çuditërisht nuk pasoi ndonjë kundrathënie, siç ndodhte rëndomë në raste të tilla, përkundrazi, me një zë disi të pazakontë për të, ai u përgjegj:

- Më fal! Më doli një punë dhe ika heret nga shtëpia...

Mustafa Tukaj

Edhe pse, ai u përpoq të fshihte brengën, asaj nuk i shpëtoi një e dridhur e lehtë e zërit, rrekej të mbyste një ngashërim.

- Ç' ka ndodhur? - e pyeti ajo me shpejtë, këtë herë e shqetësuar.

- Asgjë, vetëm një punë... - u përgjigj ai tashmë më i sigurtë në vetvete.

- Ou?! Po na bëhesh edhe enigmatik, pale!

- Jo, jo, se nuk më shkon... - u rrek të bënte shaka dhe ktheu kokën si për të parë karuselin e madh në të djathtë, që në këtë orë të mëngjesit, kishte mbetur pa vizitorë. Nuk donte që Shejla t'i shihte sytë e përlotur...

- Po çantën, ku e ke?

- Po të prisja, po unë nuk do të vij sot...

- Mos u çmende?

- Jo, ende..

- Po atëherë?

- Mamaja nuk vjen dot në shkollë sot, siç më kërkoi nëndrejtoresha...

- E pastaj?

- Do të më nxjerrë nga klasa e unë nuk dua t'ia jap këtë kënaqësi...

- Qenke budalla! Eja e mos e zgjat!

- Jo, Shejla...Le që as që kam prekur gjë me dorë...

- Të paktën, mos bëj mungesa...

- Jo, jo, nuk... E po, mirë, po vij...- ndërroi mendje, se në një farë largësie iu bë se dalloj Zarin e Sonin...

Dhe nuk kishte gabuar. Pranë ëmbëltores ata të dy po prisnin pa lëvizur si dy shtatore prej bronxi, me biçikleta për dore...Pastaj, kur i dalluan Shejlën e Erin, kërcyen mbi shalë dhe u dhanë pedaleve me sa fuqi kishin...

Shejla pa orën e dorës.

- Nxito, budalla, se ngelëm jashtë! - tha ajo e ia krisi vrapit, a thua se dikush, sapo kishte dhënë befas alarmin, se për pesë sekonda do të pëlçisnin minat në gurore... Ai iu turr pas.

Mbërritën bash në çastin e duhur, kur portieri po i vinte shulin portës.

Me të futur këmbët në oborr, drejt tyre u sulën gjysma e klasës:

- Sa mirë që erdhët! - ia nisi e para Tida.

- Pse, si është puna? - pyeti Shejla.

- Dëshëm përgjigjen e problemës së dytë të matematikës...

- Kaq në hall paskeni qenë? - pyeti prap Shejla.

- Po, pra, po prisnim Erin, se atë kemi më të mirin...- tha si me qesëndi Enxhi.

- Ç'po më lavdëron kështu? Mos kemi hyrë gjë në merkaton e futbollistëve? - e pyeti ai me tallje.

Mustafa Tukaj

- Jo, Eri, po na kanë dalë dy përfundime të ndryshme, - foli me të butë Arlindi.

- E shohim në klasë...

- Po lekët i ke sjellë? - e pyeti Nimfa.

- Jo...

Të gjithë u befasuan. Edhe Shejla.

- Më vjen keq, - vijoi Eri, - po unë nesër nisem për Brazil...

- Çfarë? Pse? - pyetën njëzëri shumë prej tyre.

- Do të shoh karnavalet!.. - u përgjigj ai dhe bëri disa hapa para, duke lënë të habitur shokët, që s'arritën të dallonin, ku mbaronte shakaja e ku fillonte e vërteta.

Nga cepi pranë selvisë, ku grupi i Garipave ngacmonte Sonin e thurte plane, u shkëput Zari dhe bëri nja dy - tre hapa drejt Erit, e pa egër dhe iu hakërrye:

- Do t' i thyej turinjtë!

Eri, tundi kokën, si për t'i thënë edhe ty të kisha mangut dhe u bashkua me shokët.

*** ***

Në orën e parë kishin matematikë me mësuese Vjollcën. E donin pa masë, sepse ajo si pa kuptuar u kishte fituar zemrat të gjithëve. Le që

do të diskutonin edhe për ekskursionin në Sarandë, ku do të niseshin të nesërmen. Disa prej nxënësve qenë grumbulluar rreth bankës së Erit dhe po e ndiqnin atë, sa shpejt e me ç'siguri i bënte veprimet, për të zgjidhur problemën, që duhej ta kishte zgjidhur në shtëpi. Kur e mbaroi, për habinë e të gjithëve, rezultati doli krejt ndryshe me ato të të tjerëve. Plasi debati. Në këto e sipër u hap dera dhe hyri mësuese Vjollca.

Të gjithë u shpërndanë nepër bankat e tyre. Menjëherë u vendos qetësia, po heshtjen e theu Visari:

- Mësuese, kemi tri përgjigje për problemën. Kush ka të drejtë?

- Qetësohuni njëherë, pa t'i shohim pak?

Kaloi nga njëra bankë tek tjetra duke u hedhur fletoreve te detyrave një shikim të shpejtë dhe, kur arriti te Eri e pyeti:

- Pse në fletë? Kur e ke bërë detyrën?

- Tani... Nuk munda dje. Jam edhe pa çantë, se nuk doja të vija në shkollë...

Mësuese Vjollca nuk e ngacmoi më gjatë. Ai po i thoshte të vërtetën dhe ajo gjithmonë nga përvoja e saj e dinte, se një fëmijë që tregon të vërtetën, meriton respekt.

- Dil në dërrasë, Eri dhe zhvillo variantin tënd!

Ai doli me të shpejtë dhe shkumësi filloi të rrëshqiste i sigurtë e pa u ndalur në dërrasë të

Mustafa Tukaj

zezë, thua se ngutej të hidhte detyrat e një misioni sekret, apo donte të hidhte urgjent një formulë të posazbuluar, nga frika se nuk do të arrinte ta përfundonte, përpara se ta arrestonin...Të tjerët, e bashkë me ta edhe mësuesja, kishin mbetur si të hutuar e me sytë të gozhduar në atë tërkuzë ekuacionesh, që në fund dha një rezultat krejt të ndryshëm.

Uli shkumësin. Mësueses i shndrisnin sytë nga lumturia dhe ndoshta, jashtë natyrës së saj të përmbajtur, nuk duroi, po iu afrua, e përqafoi dhe tha:

- Kjo është zgjidhja e vërtetë.Të lumtë! Shko në vend!

Eri u nis tek banka e tij, po dera u hap me vrull dhe po me vrull në klasë hyri nëndrejtoreshë Irini.

- Prit, mos u largo, se për ty kam ardhur! - iu drejtua Erit, pa u kërkuar falje nxënësve për këtë vërshim të frikëshëm dhe pa i marrë leje mësuese Vjollcës, që po i prishte mësimin.

- Pse ke hyrë në klasë pa sjellë prindin?

- Asnjëri nga prindërit nuk pati mundësi të vinte. - u përmbajt e foli me zë të qetë, si për t'i thënë se nuk donte sherr, mbasi i dilnin e i tepronin ato që fshihnte në trurin e tij të njomë.

- Atëherë, dil jashtë dhe mos të të shoh në shkollë, deri sa prindërit e tu, të kenë mundësi të vijjnë këtu.

Eri u kthye dhe u mat të dilte, pa kthyer përgjigje, po para i doli mësuese Vjollca:

- Shko në bankën tënde, djalosh! Kjo është ora e matematikës dhe mësuesja e matematikës jam unë!

Zëri edhe pse i përmbajtur e i qetë në dukje, fshihte një forcë të jashtëzakonshme dhe çdonjëri nga nxënësit e ndjeu këtë. Me sa duket, vetëm nëndrejtoresha nuk e kuptoi, se nisi të bërtasë:

- Jashtë! - ndërsa pastaj iu kthye mësueses.- Ju po thyni një urdhër e për këtë do të përgjigjeni.

- Sigurisht, dikush duhet të përgjigjet... Tani ju lutem, më lejoni të vazhdoj mësimin... - i ktheu shpinën, shkoi tek tavolina dhe hapi regjistrin.

- Eri Shkreli! Për problemën që sapo zgjidhe shkëlqyeshëm, ke notën dhjetë!

Eri kishte mbetur në këmbë pa ditur ç'të bënte. Tek dera qëndronte e skuqur deri në veshë nëndrejtoreshë Irini.

Duke mos dashur të bëhej edhe më shumë një mollë sherri në mes saj dhe mësuese Vjollcës shkoi drejt derës, u ndal për një çast, e pa në sy me mirënjohje mësuesen kujdestare dhe doli jashtë.

Pas tij doli nëndrejtoresha.

Një qetësi e nderë pushtoi klasën dhe për minuta të tëra askush s'pipëtiu.

Sigurisht që ajo orë mësimi që prishur, siç prishet një festë nga një i dehur a sherrxi... Mezi

Mustafa Tukaj

u tërhoq zvarrë, edhe pse u përpoqën ta zhdavarisnin turbullirën me fjalë të hedhura aty këtu për mësimin apo ekskursionin.

Derisa ra zilja.

Mësuesja doli nga klasa duke u rikujtuar që të nesërmen të ishin të përpiktë në orarin e nisjes.

Pa u nxituar e me hap të sigurtë mori nga drejtoria, trokiti dhe hyri brenda.

- Aaa, qenkeni ju!.. - e priti me këmbët e para Irini. - Sapo kisha ndërmend t'ju thërrisja...

- Ja, ku më keni, por ju lutem mos më ndërpreni për disa sekonda dhe pastaj veproni, si të doni...- filloi ajo qetë por prerë.

- Sinqerisht nuk arrij ta kuptoj, se si një, që ma quan veten mësuese, mund të sillet në këtë mënyrë me një fëmijë si ai... Ju e bëtë tuajën, se kaq keni në dorë, por në fakt, u treguat shumë e dobët dhe e ulët veten tepër poshtë në sytë e të gjithëve, përfshi edhe mua... Ju lutem, më lejoni të mbaroj!

- Nuk ju lejoj aspak të hidhni baltë mbi dinjitetin tim, për shkak të një rrugaçi!

- Ai është një djalosh shumë i mirë... E në se ka ndonjë të metë, si çdonjëri nga ne, është detyra jonë ta edukojmë... Ju i mendoni fëmijët si një copë plastelinë, së cilës mund t'i japësh formën që do, apo i merrni për figura, që mund t'i lyeni sipas qejfit... Gaboheni rëndë, aq më tepër, në se këtë doni ta bëni me vrazhdësi e arrogancë...

- Ju do të përgjigjeni për këto që thoni!

- Ndërsa ju do të bënit mirë të parashikoni, se ku mund të shkojë tani ai fëmijë dhe çfarë mund të bëjë rrugëve, në një kohë që duhej të ishte në klasë me shokët e tij... - tha u largua, pa pritur përgjigjen e Irinit.

Ndërkaq në klasë, me të dalë mësuesja, plasi sherri. Shejla u ngrit në këmbë dhe iu afrua Nîmfës:

- Të të vijë turp, që hesht si frikacake!

- Pse, ç'ke me mua ti?

- Ti duhet të thuash të vërtetën. Eri është i pafajshëm. Apo jo?

- Ku di gjë unë?

- Por e di se për kë ishte kopja?

- Nuk e di, s' mbaj mend!...

- Si nuk mbake mend? - ndërhyri Redi, edhe pse e ndjente se Eri që i pafajshëm, po edhe për t'i dalë në krah Shejlës. - Mos të kanë skaduar neuronet?

- Jo, i kanë zhdukur kartën e memorjes! – foli tërë mllef Arlindi, që rrallë fliste.

U përhap një e qeshur e lehtë dhe Nîmfa gati sa s'ia plasi të qarit.

Shejla iu drejtua Enxhit.

- As ti nuk mban mend gjë?

- Jo, nuk mbaj... Ti mos je gjë hetuese?

- T'ju vijë turp të dyjave!

Mustafa Tukaj

- Turpin mbaje për vete dhe mos më detyro të flas më gjatë!...

- Thuaj ç'ke për të thënë, se mos pëlçasësh!

- Do të vijë dita, këtu do të jemi! - tha Enxhi dhe, meqë pa dashje kishte hyrë në një shteg që s' dinte ku e çonte, doli nga klasa e shkoi në tualet.

Atmosfera e rënduar vazhdoi edhe në orën e gjeografisë, që mezi u shty. Në orën e tretë kishin muzikë dhe fizarmonika e mësuesit sikur i gjallëroi ca dhe u largoi pezmin e mëparshëm.

Në pushimin e madh Shejlën e Redin i thirrën në kabinetin e biologjisë, për të diskutuar për konkursin që po afronte. Kur po ngjisnin shkallët për në katin e tretë, Redi i tha:

- Mbrëmë të kam parë në ëndërr...

- Vërtetë?! Si?!

- Ishim në fshat tek gjyshi im dhe po hanim fiq...

- Hëngrëm?

- Po, u shqepëm.

- Mos!..

- Pse?

- Ndjellin ters...

- Vërtet? Megjithatë pas mësimit, kam një surprizë...

NJË BOMBË NË KLASË

D

riti, domethënë bombonja, siç e thërrisnin të gjithë, nuk doli bashkë me shokët në pushim të madh, por, pa u shuar mirë zhurma e hapave dhe zërave të tyre, uli kryet mbi librin e fizikës dhe filloi të lexonte shumë i përqëndruar mësimin e ditës. Një parandjenjë i thoshte, se sot do të pyetej me siguri... Rrinte në një bankë me Redin. Kishte një fytyrë të rrumbullakët, ku në mënyrë të veçantë spikatnin sytë e tij ngjyrë deti dhe qerpikët e mëdhenj e të zi. E donin të gjithë. Asnjëherë në jetën e tij nuk ishte zënë me dikë, as kishte bërë

Mustafa Tukaj

sherr me dikë. Vinte e ikte qetë e pa u ndjerë dhe vetëm buzëqeshte ndaj ngacmimeve të shokëve. Ky ishte Sidriti, apo shkurt Driti.

Kur u vendos qetësia e plotë në klasë e ai po thoshte me mend teoremën, befas dëgjoji një tik - tak të lehtë, që vinte nga poshtë bankës. Uli kokën dhe e ndjeu se tik - taku vinte nga çanta e Redit. Zgjati dorën, por ajo i mbeti si i ngrirë nga mendimi që i shkrepri në çast, se brenda në çantë fshihej... “Bombë, për kokën e mamit! Redit i kanë vënë një bombë me sahat në çantë!...”

La librin dhe doli përjashta me të shpejtë. Nuk kishte pikë dyshimi që ajo ishte një bombë me sahat... Po kur dhe pse ia kishin vënë në çantë Redit? Nga që ishte i pasur, thua? Ku mund të ishte mësuese Vjollca? Nuk duhej humbur asnjë sekondë... Të lumtë Driti! Shpëtove shokun e bankës e ndoshta të gjithë të tjerët... Po sikur të pëlçiste, kur të gjithë ishin në klasë? E tmerrshme! Koka e gjymtyrë të flakura poshtë e përpjetë!...I erdhi për të vjellë...

- Ç’ke që vrapon? Ç’ka ngjarë dhe pse je zverdhur në fytyrë? - e ndali me tre “të shtëna” mësuese Irini.

Bombonja nuk pati dëshirë që lajmin e parë t’ia jepte nëndrejtoreshës, po koha s’priste.

- Bombë, mësuese, ka një bombë!

- Bombë?! Ku ka bombë?! - zgurdulloi sytë

Irini.

- Në klasë, në një çantë!

- Je në vete? Po kjo e zezë?! Eja më trego!

Driti nuk deshi të kthehej edhe një herë në klasë, po s'i vinte mirë që mësuesja ta mendonte për frikacak... Aq më tepër që tashmë ai e kishte zbuluar i pari bombën dhe, si shpëtimtar i shokëve, ai për herë parë në jetën e tij do të ishte qendër të vemendjes, i rrethuar nga shtypi e kamerat.

Irini i shkante nga pas, duke turfulluar për këtë telash të ri të klasës së tetë B dhe duke menduar njëkohësisht, ç'të bënte, që të mos i "plaste" kjo bombë në dorë...

Driti ndali para bankës së tyre dhe i bëri me gisht. Irini uli kokën dhe vuri veshin.

- Jashtë!- thirri fort dhe u turr në çast drejt derës, si për të mbërritur e para finishin.

Driti u lëshua teposhtë shkallëve, kurse Irini ktheu majtas drejt drejtorisë. Mezi e gjeti vrimën e çelësit me dorën që i dridhej dhe, si e hapi më në fund derën, rrëmbeu telefonin:

- Alo! Alo! Policia?! Në shkollën tonë ka një bombë! Unë jam nëndrejtoresha e shkollës!... Alo, drejtorja arsimore? Jam Irini...

Pastaj mori një numër tjetër. Po këtë radhë nuk u prezantua.

Me të shpejtë mbylli derën dhe u sul drejt dhomës së mësuesve. Pa u dhënë asnjë sqarim u thirri:

Mustafa Tukaj

- Të gjithë jashtë!

Mësuesit, që në këtë pushim të madh, po merreshin kush e kush me punën e tij, ngritën kokat dhe vertet u shqetësuan, kur panë fytyrën e nëndrejtoreshës kaq të alarmuar.

- Ç'ka ngjarë? - pyetën njëzëri disa prej tyre.

- Bombë! Në klasën e tetë B ka një bombë!

Mësuese Vjollca u mat të thoshte diçka, po Irini e ndërpreu:

- Dilni të gjithë jashtë! Kontrolloni klasat e tjera, mos ka nxënës! Të boshatiset shkolla!

- Të lajmërojmë policinë! - se kush tha nga mësuesit.

- Bëni siç u thashë! Policia vjen tani! - tha dhe ngriti vetullën e djathtë, si për t'i thënë: “Pse, kot jam unë këtu?”, i dha trupit drejt dhe doli nga dhoma e mësuesit. Duke zbritur shkallët me të shpejtë, tashmë që fati kishte dashur të mos ndodhte fatkeqësia dhe të gjithë të ishin jashtë rrezikut, asaj po i dukej, se sot do të ishte dita e saj e madhe, madje po mendonte, se si do të fliste para gazetarëve e kamerave. Ajo dhe vetëm ajo, falë aftësive vetiake organizuese kishte bërë të mundur, të shpëtonte fëmijët dhe shkollën nga një katastrofë, pasojat e së cilës, nuk mund të merreshin me mend!

Nga kabineti i biologjisë dolën nxënësit e fundit të shkollës, midis të cilëve, merret me mend, ishin edhe Shejla e Redi. Ata dolën ashtu

vrikthi, rrokopujë e pa ditur asgjë dhe vetëm jashtë, në oborrin që gumëzhinte nga zëra të alarmuar, të frikësuar e kureshtarë, mësuan shkakun. Ata nuk i kishin takuar ende shokët e klasës, me Bombonen në qendër, kur mbërriti policia.

Me të shpejtë i larguan të gjithë nxënësit që ndodheshin pranë portës dhe menjëherë ndeshën në mësuese Irinin, që si u prezantua, u tregoi për gjithçka dhe sidomos për masat e marra për boshatisjen e shkollës.

Çuditërisht, fill pas policisë ia mbërritën gazetarët... Të famshëm janë edhe këta! Po nga e morën vesh? Si e gjuajnë lajmin kaq shpejt, xhanëm? Sigurisht, tashmë që policia i ishte drejtuar klasës së tetë, prirë nga zonja Irini, ata po prisnin përjashta, çastin për të bërë intervistën sensacionale me shpëtimtaren e situatës, e cila, si i kishte çuar specialistët e policisë deri tek klasa në fjalë, nuk vonoi të dilte para kamerave e t'u përgjigjej pyetjeve të shumta... E ç'donte më shumë ajo se kaq? E tërë Shqipëria sytë i kishte drejtuar drejt saj, sepse siç i thanë, emisioni jepej *live*. E zhytur në emocionet e rralla të kësaj dite të rrallë, Irini nuk kishte vënë re, që një fëmijë, i penguar nga policët për t'u afruar, jepte e merrte me duar për t' i thënë diçka... Më në fund e dalloj, po nuk e ndërpreu fjalën. Ishte Redi, që sapo

Mustafa Tukaj

kishte mësuar nga të tjerët shkakun e kësaj katrahure...

Ne portë u shfaq kryeinspektori i policisë, që u afrua i qetë. Gazetarët iu sulën menjëherë. Ai buzëqeshi dhe tha:

- Asgjë për t'u shqetësuar... Një keqkuptim!

Mësuese Irini nuk u besoi veshëve.

Kryeinspektori e mori më vehte Irinin dhe e sqaroi:

- Një orë tavoline shumë e bukur dhe ca çokollata...

Redi përfitoi nga rasti, që policët po largoheshin dhe bëri disa hapa para:

- Mësuese, është ora ime... E kisha tek orëndreqësi...

NJË DITË TERS

S

i doli nga porta e shkollës, Eri ndali për një çast,
nqaqë s'dinte nga t'ia mbante. Të kthehej në

Mustafa Tukaj

shtëpi, në atë atmosferë të rëndë që mbizotëronte aty e t'u tregonte, se e kishin përzënë nga shkolla, do të thoshte të lëndoje edhe më shumë zemrën e së ëmës, t'i jepje asaj një goditje tjetër, kur nuk e priste e prej atij që nuk e priste, që, pale, a do t'i bënte ballë.... Për atë grua të urtë, që veç dinte t' i falte gjithkujt dashuri, ditët e fundit do të mbeteshin në kujtesën e saj, si më rëndat, më të vështirat, më të tmerrshmet... Sigurisht, që jeta ka të papriturat e saj dhe jo gjithçka shkon si në vaj...Megjithatë ajo kthesë kaq e beftë në familje, kur ajo, e kënaqur qoftë edhe me atë jetë të thjeshtë që bënin, veç thurte ëndrrat më të bukura për fëmijët e saj, e kishte dërrmuar të tërën, sa mezi mbahej në këmbë. Një tufë rrudhash të freskëta kishin mbirë parakohe rreth syve të saj të bukur, që thuajse kishin humbur shkëlqimin dhe fjolla thinjash gri qenë shfaqur aty këtu në krifën e flokëve të saj çull të zinj...

Eri ndjeu një trazim në shpirt. Iu bë sikur në atë vorbull ndjenjash të ndryshme, që e rrëmbeu të tërin, vërviteshin dashuria e dhëmshuria, e bukura, dhe e shëmtuara, përbuzja dhe urrejtja... Secila nga këto ndjenja kishte një fytyrë të caktuar e emër konkret, çdonjëra prej tyre strehohej në një skutë të veçantë diku në shpirtin e tij dhe herë ngrinte krye njëra e herë tjetra, duke e turbulluar këtë djalosh, që edhe pse rrekej të sulej

drejt burrisë, ende kishte një këmbë të ngulur fort në fëmijëri...

E solli në vete boria e një makine. Hipi në trotuar dhe mori nga qendra. Nuk dinte si t'i shtynte minutat. Mund të mbyste kohën në *chat* a *facebook* në një sallë interneti, po s'kishte asnjë lek. Të kthente nga salla e shahut, nuk i luhej, aq më tepër që s'dinte ç'ti thoshte xha Metit, trajnerit të të rinjve, i cili e kishte ftuar të maste forcat me antarët e ekipit të tij. Kjo ndodhi një ditë, kur ai e kishte parë Erin tek i tregonte ca lëvizje vërtet interesante njërit prej shahistëve amatorë më të thekur, një ish oficeri në pension, që kishte një zë tmerrësisht të trashë dhe që kumbonte, thua se dilte nga një pus të thellë.

Pa ditur ç'të bëjë, ngriti kokën e filloi të lexojë me rradhë emërtimet e dyqaneve: “Butique Zana”, “Floktore”, “Kafe Internet”, “Restorant Riviera”, pastaj pankartat e reklamave zgjedhore, të shpërndara gjithandej. U ndal t'i vështronte me vemendje të gjithë portretet e kandidatëve për deputetë, duke përcaktuar me mend, ç'njeri fshihej pas atyre syve të vegjël e kafë, të mëdhenj e të zi, të vegjël bojëqielli; cili prej tyre e kishte të sinqertë buzëqeshjen, e cili të shtirë seriozitetin, kujt i therrte vërtetë për vatanin, e cili e gjente mëmëdheun në xhepin e tij... I pëlqeu kjo lojë, se edhe i largoi mendimet e turbullta e të trishta dhe vazhdoi më tutje, kur, papritur, i doli para një

Mustafa Tukaj

fytyrë e njohur, në fakt, në fillim një kokë e njohur e qethur zero...Bim Zalli, biznesmeni i talentuar i qytetit e njëkohësisht babai i Redit... Ia nguli sytë për minuta të tëra pa arritur të depëronte aspak në brendësinë e këtij njeriu të fuqishëm, që të thyente kokën me para... Eh, si është kjo punë!... Bim Zalli të thyen kokën me para, babai i tij, Çim Shkrreli, kishte thyer kokën duke kërkuar para...

I theri në shpirt. Mbrëmë kishte mësuar gjithçka. Në fillim i kishte treguar e ëma, pastaj te e vona, diçka i kishte thënë edhe i ati... Binte era alkol, po nuk qe i dehur... Zëri i dridhej, kur fliste dhe gati sa nuk shkruhej në vaj... Më fal, bir! Jua nxiva jetën, nënës dhe juve... Diçka që ndodh brenda një çasti të vetëm, mund të të ndryshojë gjithë jetën...Isha lodhur nga puna e rëndë që bëja... Shumë punë, pak para... I besova fatit... U rrejta nga një fat i çastit që më dhuroi një grusht parash, që unë mezi i fitoja për një javë...Më joshi, më tundoi...Mendova se më ishte hapur qielli... Provova prap...Prap fitova, si për djall...Duket ishte karremi që më çonte drejt grepit, ku shpejt rashë...Provova, humba, provova, humba, humba, humba...Në kërkim të fatit tim shpëtimtar, veç zhytesha thellë e më thellë, përpëlitesha të shpëtoja, kapesha pas kashtës të shpëtoja, po nuk qe e thënë...Me duart e mia kisha përgatitur greminën time dhe tuajën...

Dhe kishte qarë me Erin në gjoks...As vetë nuk e kishte kuptuar, përse këtë rradhë e kish mëshiruar të atin, nuk e kishte përbuzur, siç kishte ndodhur pak kohë më parë, nuk qe penduar i biri i kujt ishte...Njerëzit gabojnë...I ati kishte vënë në lojë fatin e një familje... Në tombolë, poker, ruletë, baste, lotosport?! Ai e nuk e kishte përmendur arenën e humbjes, po tek e fundit ç'ëndësi kishte?

Bim Zalli i kishte ngulur sytë e tij të vegjël për fytyrën e tij të madhe, sikur e qesëndiste...

Unë nuk të kam zili, pse ke para...I gëzofsh! Edhe yt bir, është çun i mirë, por, i shkreti, lodhet kot me Shejlën...Nganjëherë edhe më dhimset, se, me sa shoh, i ka rënë keq në kokë...Unë e ndjej këtë... Më beso. E ndjej, se i njoh asaj çdo qelizë... Jemi rritur bashkë...Që në kopësht bashkë...E njohim aq mirë njëri - tjetrin dhe ka diçka që na tërheq aq fort, diçka që unë nuk e shpjegoj dot, të them sinqerisht... Po edhe pse luajmë, shajmë e ngacmojmë njëri - tjetrin, e ndjejmë, se nga pas fshihet diçka që as unë as ajo, nuk dimë ç'emër t'i vemë..Është si të them, një drithërimë, një tërheqje e lehtë, e lehtë si një puhizë herë e freskët e herë e ngrohtë, që të flladit e ndez njëkohësisht...

Hodhi sytë nga ora e madhe e qytetit. Po afrohej koha e drekës. Nxitoi hapat.

Me siguri do të kishte mbaruar ora e fundit, se pa turma fëmijësh që vërshuan në rrugë. U ndal

Mustafa Tukaj

te kthesa e semaforit të dytë. Nuk donte t'i afrohej shkollës.

Të parin që dalloj nga klasa e tij ishte Arlindi. Po ecte aq shpejt, sa gati vraponte. Me ta parë Erin, iu afrua.

- Hë, Eri, si ia çove?

- Hiç, varavinga...

- Vërtet nuk do të vish nesër në Sarandë?

- Jo...

- Ke ndonjë hall?

- Jo...

- Po eja, atëherë, se do të kënaqemi...

- Bëfshi qejf! Mua më doli një punë, që nuk mund ta lë...

- E more vesh punën e bombës?

- Jo, ç'bombë?

- Jemi shqyer gazit...Ta tregon Shejla, se unë nxitoj. Jam vonë për kursin e pikturës... - dhe ia krisi vrapit, si për të fituar sekondat e humbura.

Pastaj dalloj Nimfën e Tidën, Bombonen e Visin, po Shejla s'po dukej gjëkund.

Ai nuk e dinte, se ajo pak sekonda më parë, se ai të arrinte, kishte kaluar aty pranë bashkë me Redin në Benzin e Bim Zallit dhe, tani, pasi e kishte falenderuar shoferin për mundimin e Redin për dhuratën, kishte hyrë brenda në shtëpi e po shihte me kureshtje në dhomën e saj, atë orë të çuditshme e tepër të bukur...

Dy biçiketa i ndaluan te këmbët. Ishin Soni e Zari.

- Nuk paske ikur në shtëpi, o qen besnik? - i foli me të tallur Zari që iu afrua edhe më.

Eri e kuptoi që Zari kërkonte sherr dhe deshi t' i shmangej, po Zari vazhdoi:

- Po pret atë bushtrën? Kot lodhesh, o qyqar, se iku pa të marrë leje, me makinën e atij bufit...Ti më mirë shko mëso historinë!...

Eri, që nisi të zjente, prap nuk foli. Po nga e kishte marrë vesh punën e historisë?

- Çfarë ke, t'u lidh goja?! - iu afrua ngjitur dhe e kapi për fyti.

- Më lësho! Më mirë qen besnik, se zagat si ti! - nuk u durua më.

- Si the?!- tha ai dhe u mat ta godiste, po ndërhyri Soni e i mbajti dorën.

Po Zari ishte i fuqishëm dhe, ndërsa Soni pëpiqej ta largonte, ai i rrëshqiti me një të shtyrë dhe e qëlloi Erin poshtë syrit, me aq forcë, sa ai mezi u mbajt në këmbë. U mat edhe ai të sulej, po Zari i dha edhe një goditje të dytë dhe Erit iu morën mentë e ra përdhe.

Disa kalimtarë u mblodhën menjëherë. Një mesoburrë i bëshëm largoi me forcë Zarin duke e sharë, ndërsa një tjetër ngriti në këmbë Erin, që po i kullonte gjak nga hundët.

- Shiko, more djall, ç'i bëre! Turp të të vijë!
- i tha Zarit një grua gati me të qarë, teksa nxori

Mustafa Tukaj

një kartpecetë e filloi t'i fshijë gjakun. Zari e Soni kërcyen mbi biçikleta e u larguan, se filluan të mblidhen shumë njerëz, madje njëri prej tyre përmendi policinë..

Pa ardhur mirë në vete, Eri falenderoi gruan dhe u largua...Zjente i tëri, por as ai nuk donte ta gjente ashtu policia...Nuk kishte nge për pyetje e hetime...Ai do ta gjente një mënyrë për t'ia marrë hakun...Në një vend - larje makinash kërkoi ca ujë dhe lau fytyrën...U tha se ishte rrëzuar, po punëtori aty, i luajti syrin, si për t'i thënë: “Mirë, mirë, lahu tani, po nuk ma hedh dot, se ajo bllamë mavi poshtë syrit, nuk është nga të rrëzuarit. Megjithatë, bravo, se nuk qenke qaraman!”

U nis për në shtëpi.Ç' dorë të rëndë që kishte i mallkuari, xhanëm, si tokmak!Po Shejla vërtet kishte shkuar në shtëpi me makinën e babait të Redit, apo ia këputi kot ai? Kur kaloi pranë shtëpisë së Shejlës, mendoi të kthehej njëherë, po pastaj ndërroi mendje. Jo, jo, jam bërë për dreq!

Ç' ditë ters!

Po ai nuk e dinte, se edhe pasdrekja do të vazhdonte po kështu, madje më keq...Kur të vijnë të këqiat, hapu derën! Po cilën derë të hapte, atë të shtëpisë? Ai nuk do të kishte tash e tutje, nuk dihet edhe përsa kohë një shtëpi...Këtë e mësoi, sapo iu afrua pallatit të tyre dhe pa të motrat që po qanin, pranë një kamioni që ngarkohej me rraqe e orendi. Dy - tre hamenj e ndonjeri prej komshinjve, që

kishin dalë t'i ndihmonin, i mbartnin rrobat dhe i hidhnin në kamion, shpesh pa kujdes. Nuk i bënë këmbët të afrohej. Diku në të djathtë të kamionit rrinte babai, i zverdhur si limoni e i humbur, me një vështrim të tretur në askund, thua, se që andej do të mbrinte litari, që do t'ia hedhnin në fyt, apo, thua, priste pa shpresë një përgjigje nga fati i tij i humbur...

Në të majtë, jo shumë larg tij, kishte ndalur një makinë luksoze, që ai s'e vrau fort mendjen të shihte e ç'marke ishte, ndërsa pranë derës së hapur të makinës rrinin në këmbë dy burra me fytyra të mvrënjtura e të akullta, që ndiqnin ftohtë gjithë procesin, si të ndiqnin një ceremoni mortore...

Pothuaj gjithë pallati gëlonte në dritare e bënte shir kushedi prej sa kohësh, ndërsa ai bridhte poshtë e përpjetë si rrugaç e nuk i qe gjendur pranë së ëmës, që sigurisht, do të qe shembur në ndonjërin prej divanëve...Iu afrua të atit dhe e pa drejtë e në sy. U frikësua, sepse sytë e tij, si të një të vdekuri, nuk thonin asgjë...U ngjit me vrap shkallëve dhe hyri brenda. Për çudinë e tij, shtëpia ishte pothuaj e boshatisur, asnjëri prej divanëve nuk dukej gjëkundi, kurse e ëma në këmbë jepte e merrte me duar, për t'i thënë herë njërit e herë tjetrit, se ç'duhej bërë... Me të parë Erin ashtu u turr dhe vuri duart në kokë:

- Po kush të paska bërë kështu, more bir?!-
tha ajo me një zë të mekët e të stërlodhur, me sa

Mustafa Tukaj

duket nga lotët e shumtë, që kishte derdhur para, se ai të vinte në shtëpi.

- U rrëzova, nënë!... - tha pa e parë në sy, nga frika se ajo do ta kuptonte, që ai po gënjente. Sigurisht që ajo e ndjeu, se i biri nuk thoshte të vërtetën, po tash nuk ishte koha për pyetje të tjera...I mori kokën në gji dhe i lëmoi flokët:

- Bëhu burrë, shpirt! Shtëpia nuk do të jetë më e jona, deri sa ne të paguajmë borxhin...

Ajo nuk tha të kujt. Ajo foli në shumës dhe kjo ishte e qartë, se të gjithë duhej të bënin çmos për këtë...As nuk tha, sa i madh ishte ky borxh dhe si do ta shlyenin...As se ku do të strehoheshin këtej e tutje...

Kur shtëpia u boshatis plotësisht, njëri nga burrat me një fytyrë të akullt, i vuri kyçin, e futi në xhep dhe pa thënë asnjë fjalë zbriti poshtë, hyri në makinën, që Eri prap se vuri re e ç'marke ishte dhe u largua, duke lënë pas një heshtje të nderë dhe një shtëllungë tymi, që u tret pas pak.

Hamenjtë kërcyen në kamion dhe ai u nis. Vetëm atëherë Eri dalloi dajën, që mori për krahu nënën. Ajo e ngrata, thua se kapërdiu një kafshatë turpi, se desh u mbyt, kur përshëndeti me kokë komshinjtë dhe hyri në makinën e dajës...Pastaj hyri Eri. Elma dhe Ola kishin pritur brenda gjatë gjithë kohës.Po babai ku ishte? Në kamion, pasoi përgjigja e nënës, që nuk u ndje më gjatë rrugës. Me siguri, me sa e njihte Eri, ajo nuk po vajtonte

më atë ç'kishte ngjarë...U bë ç'u bë tani... Mendja e saj tashmë rrihte, se qysh do të rriste fëmijët në shtëpinë e botës(kështu e mendonte ajo, edhe shtëpinë e prindërve të saj), me aq pak të ardhura dhe për një kohë, që s'dihej sa do të zgjaste...

Makina e dajës e parakaloi kamionin pak para shtëpisë së Shejlës. Erit i theri në shpirt. Ktheu edhe njëherë kokën pas, si për herë të fundit, a thua se po syrgjynosej në një ishull të largët, për të mos u kthyer më kurrë në këtë rrugicë të dashur, me gjithë ata kujtime fëmijërie, a thua se, nuk do të shihte më atë avlli të mbuluar nga lulevilat dhe atë portë të ngrohtë, ku kishte trokitur kushedi sa herë. Sigurisht që ai s' do të kishte kohë ta priste Shejlën çdo mëngjes e ta bënin rrugën bashkë, se daja e kishte shtëpinë në anën tjetër të qytetit... Për të ndoshta, do të mendonte Redi me makinën e të atit, apo ai Soni me biçikletën e tij. Edhe një herë i sëmboi në shpirt për këtë shtjellë ngjarjesh të shpejta e të befta, që kishin rrjedhur vrullshëm e në drejtim të kundërt me dëshirat e tij...

KTHESA TË PAPRITURA

P

asi shoi kureshtjen me atë orë aq të bukur e të veçantë, që ajo as vetë s'e dinte, si e kishte pranuar ashtu, e vuri mbi komodinën pranë shtratit. Edhe pse ajo nuk ia kishte kërkuar këtë, po Redi vetë ia kishte sjellë, prap se prap ndjehej disi fajtores. Qe treguar budallaçkë, që pa hezituat fare e kishte pranuar pakon e tij, duke mos ditur tamam tamam, se ç'kishte brenda. Për çokollatat hajde, de, po gjithë këtë orë, që çoi peshë policinë e zjarrfikësit, s'duhej ta pranonte, aq më tepër që Redi këtë do ta merrte, si një betejë të fituar dhe një hap drejt triumfit... Dhe kishte të drejtë, ndoshta, të mendonte kështu, kur ajo, si një

kalama që gënjehet me një banane a ca karamеле, s'i kishte bërë syri tërr, po pa ndroje e pa menduar gjatë i qe përgjigjur ftesës së Redit, që ai ta shoqëronte në shtëpine e saj me makinë. Në një rast tjetër këtu nuk do të kishte asgjë të keqe, se tek e fundit, ata ishin shokë klase, po ajo s'duhej t'i kishte dhënë shkas Redit, të ushqente shpresa dhe sigurisht, veprimi i saj kishte çuar ujë në mullirin e tij... Ajo e vlerësonte Redin si një shok të mirë, ndoshta edhe jo fort tipin e saj, po gjithsesi ai ishte çun përsëmbari dhe i pranueshëm në shoqëri, veçse na i kishte rënë aq fort në kokë për të kapërcyer pragun e shoqërisë... Ajo e ndjente këtë me intuitën e moshës dhe me nuhatjen e një vashëze të zgjuar, që di të dallojë, pse tjetrit i merren paksa këmbët, kur bën drejt saj, apo pse kordat zanore çkurdisen disi, kur matet t'i thotë diçka... E nëse për Redin i vinte vërtet keq, pse pa dashur, ndoshta, qe bërë personazhi i ëndrrave të tij, me Sonin ishte krejt ndryshe. Ai mbahej me të madh, edhe pse ishte i pashëm, edhe pse po bëhej i famshëm me talentin e tij të padiskutueshëm, siç thonin të gjithë. Syrit të saj të mprehtë nuk i kishte shpëtuar fakti, se ajo ishte objekt bisede e ngacmimesh, jo vetëm për Sonin e shokun e tij, Zarin, po e krejt grupit të Garipave. Ata, sigurisht, e merrnin në gojë sa herë që ajo u kalonte pranë, po ndoshta, edhe kur nuk u kalonte pranë. Ndaj asaj i pëlqente, në një farë mënyre, ta

mundonte, të tallej ca, për “ t’i ulur hundën” dhe se ç’kishte një dëshirë, të luante me të si macja me miun... Ajo gati sa s’shkrihej gazit, kur e shihte, pas ndonjë batute të saj të largohej si pulë e lagur... Një ndër shkaqet, pse kishte hipur pa u menduar gjatë në makinën e babait të Redit, ishte se pikërisht, kishte dalluar Sonin, me atë gallofin tjetër, që prisnin si dy mullarë sane mu në cep të rrugës. Ajo e dinte, se me t’u ndarë nga Redi, aq më tepër që sot nuk ishte as Eri, Zar gallofi do t’i jepte zemër e Soni do të afrohej me biçikletën për dore dhe pasi të kruante e të trashte edhe ca zërin e tij, do të fillonte të fliste me të madh, gjë që e bënte edhe më shumë qesharak...

Po Eri, pse nuk e kishte pritur tek porta e shkollës? Nga ia kishte mbathur e bredhur e ç’kishte bërë gjithë paradreken? Pse, vërtet nuk do të vinte në Sarandë, apo kjo ishte vetëm një shaka e zakonshme e tij? Ajo besonte, se ai veç kur t’u shfaqej në autobus për t’i befasuar, thua se po bënte një nga truket e tij... A u kishte treguar prindërve për veprimin e nëndrejtoreshës dhe si do të kundërvepronte xhaxhi Çimi? Po ajo Enxhi sa e ligë që ishte! Si mund të pranonte, pa iu skuqur faqja, që të dënohet një i pafajshëm, aq më tepër Eri që e ka pisk me historinë? Hileqare e dreqit!

Më kot priti, se mos Eri e merrte në telefon, siç ndodhte thuasjse përditë, në më të shumtën e

rasteve o për t'i treguar një anekdotë, o për ta ngacmuar për diçka... Ai patjetër duhej t'i telefononte! Në se vërtet nuk ka ndërmend të vijë në ekskursion, siç tha, të paktën t'i uronte rrugë të mbarë...

Doli në verandë. Moti vazhdonte të ishte i ngrohtë. Qielli ishte krejt i pastër, pa as edhe një re të vetme dhe dielli kishte marrë drejt perëndimit duke përskuqur horizontin. Pastaj doli në kopësht dhe këputi një hurm farëzi. Ishte fruti i saj i preferuar. E lau në çezme dhe e kafshoi. Me të në duar shëtiti nëpër kopësht, deri sa dëgjoi telefonin. U turr, sa desh theu qafën, po zilja pushoi pak para se ajo të ngrinte dorezën. E sigurtë, se kishte qenë Eri, formoi menjëherë numrin, po një zë gruaje a vajze nga telekomi, i bëri të ditur, se abonenti i kërkuar ishte përkohësisht i paarritshëm.

Vonë mbylli sy atë natë, ndërsa të nesërmen heret në mëngjes, kur autobusi me të gjithë nxënësit, përveç Erit, u nis nga shkolla, ajo disa herë ktheu kokën prapa, se mos ia rrokte syri gjëkund duke vrapuar për të arritur makinën... Po ajo nisi të rrëshqiste me shpejtësi e të largohej gjithnjë e më shumë në atë agim, që edhe pak e do të flakërohej nga lindja e diellit...

Në fakt, Eri në këtë orë të hershme, nuk flinte e nuk shihte ëndrra... Edhe ai që zgjuar heret, pas vetëm pak çasteve gjumi të trazuar në shtëpinë e gjyshit, nga frika se mos tejflinte.

Mustafa Tukaj

Kishte marrë biçikletën e dajës dhe i kishte grahur me gjithë shpejtësinë, që të mos vonohej dhe tani po priste të atin në agjensinë e autobusëve, nja dy kilometra larg nga shkolla... Sigurisht, ai do të kishte dashur t'i përcillte shokët, por druhej të largohej, se mos i ati vinte e pastaj ikte pa e takuar...

I ati nuk kishte fjetur mbrëmë bashkë me ata. Ndoshta i vinte zor nga prindërit e së shoqes. Ai vetëm i kishte përcjellë me kamion deri te shtëpia, u kishte dhënë diçka hamenjve, (ndoshta edhe ata ishin para borxh), i kishte dhënë dorën së shoqes duke e parë drejt në sy, si për t'i kërkuar falje për herë të fundit, kishte puthur vajzat dhe i kishte thënë Erit:

- Mund edhe të mos vish, por po deshe, nesër në ora gjashtë niset autobusi..

- Për ku, baba?

- Greqi...

- Pse do të ikësh?

- Do të përpiqem të rifitoj dashurinë tuaj...

- Po ne edhe tani të duam...

- Jo, ju hodha në rrugë të madhe... - dhe kish kthyer kokën mënjanë.

- Dhe tani më thuaj, - kishte shtuar befas duke e parë në fytyrë. - Kush të ka rrahur kështu?

- U rrëzova...

- Mos më gënje, kjo bllamë nuk është nga rrëzimi... Më thuaj, se jam ende në gjendje të mbroj fëmijën tim, edhe pse...

- Baba, mos e vraj mendjen, punë fëmijësh!

- i tha ai, si të fliste për të tjerët, e jo për vete.

Çimi nuk kishte folur më dhe qe larguar, pa thënë se ku do të flinte atë natë.

*** *** ***

... E dalloi të atin nga larg nëpër atë mugëtirë, që nuk qe zhdavaritur ende.

I doli para dhe i mori çantën e vjetër të mbushur me plaçka. Çimit i shndritën sytë, kur pa të birin.

- Paske ardhur?

- Ja, nuk ka shumë...

- Mendova se nuk do të vije...

- Si të mos vija?

- Pata përshtypjen, se ti qe zemëruar shumë me mua... Ke të drejtë. Kam gabuar rëndë...Mendo ç'të duash...Tash nuk je më fëmijë...Elma dhe Ola janë të vogla dhe nuk do të kuptojnë shumë. Nëna dhe ti do ta keni të vështirë... Por të lutem, kujdesu për nënën dhe motrat. Po të bije për hise të bëhesh burrë para kohe...Unë do të ngordh në punë, që t'ju dërgoj sa më shpejt para... Po në fillim bëni ca

Mustafa Tukaj

durim. Një shok që më pret, më ka dhënë fjalën të më gjejë punë. S'ka rëndësi se ku...Veç punë... Do zoti, më shkon rruga mbarë...

- Pse thua kështu, babi?

- Prap e gënjeva nënën tënde. I thashë, se kisha vizë... Jo, autobusi më le larg kufirit... Pastaj më pret mali...Ty po ta them, se nuk e di, si do të marrë kjo punë... Nuk më bëhet vonë për vete. Gjithsesi, po të lutem, të mos e lësh shkollën, të shkëlqesh që të jesh dikushi, që t'ia shtosh jetën nënës, sepse unë ia shkurtova... - prap ktheu kokën mënjandë.

- Edhe diçka tjetër, - shtoi pas pak si e mbloodhi veten - Me lekët që, do zoti, do të dërgoj shumë shpejt, blij një celular, meqë unë nuk ta bleva dot... Dua të flas me ju, se do të më marrë malli...

U dëgjua boria. Ata të dy nuk e kishin vënë re, se autobusi që mbushur plot dhe që bërë gati në nisej. Çimi shtrëngoi fort në gjoks të birin...Pastaj u shkëput prej tij dhe hipi në makinë, pa e kthyer kokën prapa...

Një lot i nxehtë i rrëshqiti Erit nepër faqe dhe ra në asfalt.

SONI

J

am vertet ne hall. Vetëm tani po e kuptoj, pse një i panjohur, dikur dhe diku paskësh thënë: “Mirë na ngordhi kali, po kush i duron mizat...”

Kami nisur ta përfytyroj atë varfanjak pa emër e mbiemër, që, ndoshta, në një ditë me shi e në një vend me llucë, jepte e merrte me mish e me shpirt, të ngrinte nga balta kalin e tij plak e kockëdalë e ndoshta përpiqej të mblidhte ç'të mundte: qepë, patate a lakra, të hapërdara poshtë e lart nga karroja e tij e përmbysur. E pikërisht, në këtë hall të madh, për këtë njeri të mjerë, djersa e të cilit rridhte çurk e njomte edhe më shumë baltën, se nga na erdhën tufa - tufa një mori mizash idhnake, që nuk e lanë të gjinin rehat... Po më e bukura në këtë mes është, se mua ende nuk më ka ngordhur kali, domethënë shpresat, ama mizat më janë sulur... Giri, Edri dhe të gjithë të tjerët e Grupit të Garipave, përjashto Zarin, po ma pinë gjakun me thumbat e tyre e s'po më lenë një minutë të qetë. Ata më kujtojnë orë e çast bastin e humbur dhe dështimin tim me Shejlën, sa mezi përmbahem të mos ia përvesh ndonjërit, siç, me siguri, do kishte bërë Zari në vend tim. Po nga ana tjetër ata, tek e fundit, edhe kanë të drejtë, se

unë vetë u mburra e deklarova, se do ta shtija në dorë brenda dy javësh... Kurse tani ka kaluar muaji dhe unë i vardisem si një hije, pa arritur t'i marr qoftë edhe një fjalë të vetme shprese...Ashtu kryelartë, ajo sikur më shpërfill e nuk më bën për asgjë, sikur më nënçmon dhe më përqesh me atë cepin e buzës së saj, ma qep gojën me përgjigjet e gatëshme, si simite furre, përherë në majë të gjuhës, a thua se ajo m'i kupton me kohë mendimet dhe i lë gati përgjigjet e saj dërrmuese... Përditë e më shumë po bindem, se këtë rradhë, me gjithë mend, më ka hasur sharra në gozhdë... Ja, e dëgjuat, prap edhe një proverb tjetër, që, me sa duket, nuk duhet të jetë shumë i lashtë, sa kali me mizat...Sigurisht, këto fjalë do të jenë thënë nga një tjetër hallexhi, pasi qe shpikur sharra dhe gozhdë, domethënë shumë kohë mbas kalit dhe mizave...Po më e keqja është, se kjo gozhdë, që ndoshta edhe e kishte thyer sharrën, më është ngulur fort në tru e s'po më lë fare të qetë... Në fillim s'e ndjeva fare, madje sikur më gudulisi ca, me shpresë se këto ishin nazet e fillimit, pastaj mu ngul më thellë e më shkaktoi një dhimbje të lehtë, kurse tani më sëmbon aq shumë, sa ma ka prishur gjumin, oreksin dhe unë s'di ç'emër t'i vë... Veç një gjë di me siguri, edhe pse nuk ia kam thënë askujt: ajo teka e fillimit atë ditë në oborrin e shkollës, kur edhe vura bastin, ka humbur pa

Mustafa Tukaj

nam e nishan. Ajo nga një tekë çunaku është shndërruar në diçka tjetër, që nuk po më lë rehat...

Vërtet, ç'po ndodh kështu me mua? E kam lëshuar veten, e kam humbur fare si Xhaferi simiten... Hej dreq!Prap një proverb...Po ç'më hyn në sy mua një farë Xhaferi,që njëherë e një kohë, në rrethana të panjohura, na i paska humbur një simite?!...Pastaj, kaq e veçantë na paskësh qenë kjo simite çudibërëse, sa të hyjë në histori e të përmendet brez pa brezi pa arritur të zevendësohej me një tjetër? Të humbi simitja, Xhafer, shëndosh ti, bli një tjetër! Eee, flet kollaj ti, pa për vete je kthyer në një kalama, që po të tërheqin për hunde....Ja, provo e vihu në vendin e Xhaferit... Nuk e kap dot simiten, domethënë... Shejlën? Bëja naftën asaj e mos e humb ashtu, se je bërë gazi i botës, sa edhe një spurdhjak si Giri, s'lë rast pa të thumbuar e shpotitur... Dhe vare mirë në vesh, ç'të tha trajneri sot: mblidh mendjen, djalo, se kështu siç po luan, e sheh kombëtaren me dylbi!

Hej, ç'më gjeti! Hyra si pa dashje në valle, tani ec e dil, po deshe!

GRUAJA ÇUDIBËRËSE

N

dali për një çast. Uli çantën e sportit mbi timonin e biçikletës dhe nxori një pusullë nga xhepi i djathtë. E lexoi dhe pastaj hodhi sytë lart në tabelën e vogël, që shënonte emrin e rrugës. Kjo qenka tamam rrugica! Po shtëpia që kërkonte, ku do të ishte? Me siguri, do të ishte larg prej aty; e vjetër, me mur rrethues, plot përdredhka, ku fshiheshin hardhuca e zhapinj...I kishte ardhur zor të pyeste edhe për shtëpinë... Rastësisht, plot një javë më parë, teksa kthehej me tren nga Durrësi, Sonit i kish kapur veshi, bisedën e dy grave, që rrinin në ndenjësen përballë. Meqë, për fatin e tij, njëra, si të punonte në pulari e të ushqejej vetëm me të kuqa vezësh, fliste me zë të lartë, a thua, se mbante fjalim:

Mustafa Tukaj

- Mua më flet ti për Shegushën? S'e gjen edhe një në këtë rruzull! E njeh Rozmarinë, atë që shet djathë te tregu i bulmetrave? E njeh? E mirë... I iku burri, të gjorës... Nuk vinte në shtëpi, as ditën, as natën... Mor, jep e merr, herë njëri e herë tjetri, meazallah...Dikush e çoi të ngratën te Shegusha. Ajo se ç'i bëri e se ç'i tha, nuk e di, po të nesërmen në darkë, bandilli u kthye në shtëpi si manar... Po Valkën e Gjyrit e njeh? Ja, moj atë të gjorën, që sillej varavinga rrugëve e fliste me vete, sa ta këpuste shpirtin! E mirë...Se kujt i vajti mendja për te Shegushi... Se ç'kishte shkëlur, e gjora, nuk u muarr vesh, po ec e fol tani me të...Pa kur, më thanë, se ka vënë edhe kandidaturën për në parlament!...

Tjetra i kishte kërkuar adresën dhe shoqja e saj, sigurisht me kënaqësi, ia kishte dhënë, madje me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë, a thua se po i bënte reklamën e rradhës.

Soni, që deri atëherë kishte bërë indiferentin, kishte ngulitur në kokë adresën dhe me të gjetur rastin e parë, kur dy gratë, po i tregonin me gisht njëra tjetrës një shtëpi fshati, nxorri një stilolaps dhe shkroi adresën në një kuti shkrepëse, që, me sa duket, një i pakujdesshëm e kishte hedhur përtokë. Dhe kështu, pasi kishte ngurruar plot një javë, sot pasdreke pas stërviçjes, i qe dorëzuar tundimit dhe kish vendosur të mësonte derën, ku do të trokiste, vetëm kur të errej...

Rrugica, ku duhej të ishte shtëpia e saj, të jepte përshtypjen e një rrugice qorre, jo fort të gjatë, mirëpo, tamam kur nuk e prisje, ajo merrte një kthesë djathtas, që ec e deli në fund. Soni ngiste ngadalë bicikletën, në pamje të parë qejfpaprishur, por në fakt me bisht të syrit lexonte numrat e shtëpive në të dy anët. Kurrë s'ia kishte marrë mendja, se në qytetin e tij, jo shumë larg qendrës, do të strukej një rrugicë e tillë, që me sa duket s'ishte bërë edhe fort e gjallë, nga frika se mos binte në sy të arkitektëve e firmave të ndërtimit...

Duke lexuar numrat në portat e shtëpive ai e mori me mend, se edhe pak donte të ndalte para portës me nr. 232. Sa më shumë afrohej, aq më shumë po i dukej, se të gjithë kalimtarët, ia hidhnin sytë me qesëndi, ngaqë e merrnin me mend, se ky bandill me çantë sportive mbi supe, nuk po shkonte kund tjetër, përveç se tek ajo portë aq e përfolur, pak metra më tutje. Me siguri, kur t'i hapnin portën, nga muri rrethues plot përdrethka, do të kërcenin para këmbëve hardhuca e zhapinj, me të cilat ajo bënte magjitë e saj. Kurse ajo, Shegushja, do ta ftonte brenda me një zë të trashë frikëndjellës, kockë e lëkurë, me flokë të palarë e të shpupuritur, me këmbë të holla gjithë plagë nga magjitë, këmbë që binin erë, ndoshta nga që ishin të lidhura vende - vende nga fasho të pista e plot vranga gjaku...

Kishte kohë të kthehej, sa nuk ishte vonë... Zëre, se kishte bërë një shëtitje, për të njohur rrugicat e qytetit të tij...

Po diçka e tërhiqte përpara, siç të grish një fjollë drite brenda një guve, drejt daljes së fshehtë, ku ai, më në fund, do të shpëtonte nga ai makth, që s'po e linte të qetë as ditë as natë, do të gjente, atë që kërkonte (sëndukun me xhevahirë!) dhe...kaq! Ç'të keqe kishte, pse e provonte njëherë?! Askush, s'do ta merrte vesh, pse kishte ardhur, askush nuk e njihte në këtë lagje! Po tek e fundit, a nuk dilnin shpesh në televizor njerëz që pretendonin këtë e atë?! A nuk ishin bërë e bëheshin dhjetra mrekulli me magji e hipnozë? Ai nuk kërkonte kushedi se çfarë: t'ia ulte hundën asaj e ta bënte që t'i shkante pas si manar, qoftë edhe vetëm për pak kohë... Po pastaj?!

Si me komandë frenoi bicikletën para portës me nr 232, e cila, jo vetëm që nuk ishte e vjetër e duke u shembur, po, çuditërisht, e madhe dhe e re, dykapakëshe, prej druri të gdhendur e me një mur rrethues pa përdredhka, ku mund të strehoheshin hardhuca e zhapinj, por përkundrazi, plot lulevile e lulekaça. E pa edhe njëherë, se mos kishte gabuar, por emri i Shegushes në një pllakëz bakri në të djathtë i hoqi çdo dyshim...Desh të kthehej, po magjia, me sa dukej, e kish zënë që te praku i derës, sepse iu bë sikur këmbët i qenë ngjitur për zift e s'mund të largohej... Provoi, se mos i qe

ngrirë koka, po jo...Me sa dukej, magjia fillonte nga këmbët... Koka ishte në rregull... E rrotulloi majtas e djathtas, krejt në rregull...Për shansin e tij, këmbë njeriu aty pari! Pse të mos e provonte tani? Hë, Soni, jepi, nuk ka për të të ngrënë, sado e ligë të jetë...Që të mos tentojë të të kthejë në buf a krriç, thuaji se, afër shtëpisë të presin pesë shokë... Po të duash, që ta frikësosh pak, thuaji, se je i biri i drejtorit të policisë...

Nxori nga xhepi i majtë një patkua të vogël ngjyrë ari, që ia kishte falur Miri, një shok i skuadrës dhe e fërkoi tri herë. I kishin thënë, se patkoi sillte fat, ndaj po bëhej java, që ai e mbante kudo me vete.

E shtriu dorën dhe i ra ziles. Një herë. Pastaj edhe njëherë... Një zë gruaje foli në citofon...Zëri nuk ishte i trashë e frikëndjellës...Përkundrazi, i ëmbël e melodioz...Kërkoj, Shegushën, u përgjegj. Porta u hap në çast e po në çast ai hyri me të shpejtë në oborr, nga frika se mos e shihte kush... Pas portës, oborri ishte çudia e dytë, apo kjo magjistare rrangullat e hedhurinat i kthente në lule, sa herë që i donte qejfi? Me t'u mbyllur dera pas tij, filloi t'i rrahë zemra, aq fort sa thua po i shkulej... Tani s'kishte më kthim prapa, edhe sikur t'i turrej gjithë ai qen, sa një gomar, që zuri të lehë nga e majta e shtëpisë... Askush nuk i doli përpara dhe ai mbeti si guak pas tre hapash që bëri instinktivisht...

Çudia e tretë ishte shtëpia... E re, e bukur, me një arkitekturë të veçantë... Tulla të kuqe e dru në harmoni. Eee, kujt do t'ia hedhësh, ti, moj shtrigë! Unë e di se, po të duash, ti e kthen edhe në pallat, po unë nuk e ha sapunin për djathë... Po dil, dil, të të shoh surratin, se nuk të kam hiç frikë!..

Dhe ajo si t'i kish lexuar mendimet u shfaq në prag të derës e i bëri me shenjë të afrohej, duke e lënë Sonin tonë të shtangur plotësisht... Në vend të asaj plake të përfytyruar si një pemë e djegur, qëndronte një bjonde e kolme, që nuk i kishte mbushur të dyzetat, me flokë të gjata e me balluke, që po e ftonte të afrohej me një buzeqeshje të ëmbël, ku dukshëm spikatnin dhëmbët e bardhë... Soni i dha vetes dhe u afrua... Çuditërisht iu largua ndrojtja, ngjiti pesë këmbë shkallë e u ul në një karrigë xunkthi, pranë një tavoline po xunkthi, plot motive popullore, në të djathtë të verandës, ku i kishte prirë të ulej vetë Shegushja.

- Mos u mërzit një minutë! - i tha ajo dhe hyri në shtëpi, duke i lënë atij kohë të admironte atë oborr të bukur e të meditonte për emrin e saj, që siç shihej edhe nga portreti, kishte lidhje me shegën...

Ajo nuk vonoi të vinte me një tabaka në dorë, ku ai dalloj një gotë me një lëng të kuq e të trashë, që po të mos ishte ndonjë lëng magjik, që mund ta kthente në krriç a derrkuc, me siguri do të

ishte lëng shege... Këtë e përforconte edhe fakti, se pemët që binin më shumë në sy andej nga fundi i oborrit, ishin pikërisht shegat, tre a katër të tilla, me ca fruta kokërrmëdha, që, me sa dukej nga tejpjekja, kishin nisur të çaheshin...

- Pi pak lëng shege! - i tha ajo me buzë në gaz e i zgjati tabakanë - E kam bërë vetë! - shtoi pas pak, si për t'i thënë, se tashmë, që e kishte mësuar edhe këtë detaj, nuk kishte si t'ia kthente dorën.

Ai e mori gotën dhe e ktheu, pa pyetur, se ç'mund të ndodhë. Tashmë e kishte nisur vallen dhe duhej ta çonte deri në fund.

Shegushja u ul përballë tij dhe ia nguli sytë, thua se do ta kapërdinte të tërin. Ai nuk e ngriti kokën po u përqëndrua mbi gotën me lëng të kuq, se i vinte zor, jo vetëm për situatën në të cilën ndodhej dhe motivin për të cilin kishte ardhur, por edhe sepse Shegushja, me sa duket nga vapa, kishte lënë goxha zbuluar gjoksin e saj të bëshëm...

Lëngu i pëlqeu, se e piu deri në fund. Ai sikur i shoi etjen dhe i fashiti emocionet.

- Për të mirë! - tha pas pak dhe e vuri gotën mbi tabaka, këtë rradhë pa ndrojtje e duke e parë në sy.

- Të bëftë mirë! - u gjegj ajo pa ia ndarë shikimin, a thua se kështu rrekej të merrte me

Mustafa Tukaj

mend arsyen, që e kishte shtyrë këtë djalosh të pashëm e shtatëlartë t'i trokiste në portë.

Mori tabakanë e u largua prap. Ndoshta donte t'i jepte kohë atij të përmblihte mendimet. Dhe në fakt, me sa duket nën ndikimin e atij lëngu të kuq, Sonit iu largua krejtësisht ndrojtja dhe tashmë ishte gati t'ia zbraste të tëra. Madje zuri t'i vinte keq e vriste mendjen, përse kjo goxha grua, jetonte vetëm, siç ai kishte dëgjuar e nuk qe martuar...

Shegushja u kthye shpejt. Këtë rradhë nën sqetull mbante një libër të vjetër e shumë të trashë me kapakë gri të errët, një qiri gjysëm të tretur dhe një tas si prej alumuni tërë njolla - njolla. Zuri vend si më parë përballë tij, vuri mbi tavolinë sendet e saj dhe ia nisi:

- Më thuaj vetëm gërmën e parë të emrit tënd!

- S .

Ajo shfletoi pa u ngutur, bile me një farë ritmi të caktuar, si të kryente një rit, fletët e librit të saj dhe u ndalua, aty ku ajo deshi, u përqëndrua e tëra duke mërmëritur shpejt e shpejt ca fjalë, që edhe pse herë herë tingëllonin shqip, ai nuk arriti t'i lidhë e t'u nxjerrë kuptimin.

Pastaj u ndal, e la librin të hapur, ndezi qiriun dhe në tasin prej alumini, hodhi pak nga parafina e shkrirë, e cila me të rënë në kontakt me

ujin a një lëng tjetër në fund, dha një shushurimë të lehtë, që u shua në çast.

- Ç'është kjo femër, që ma ka mërzhitur djaloshin? - pyeti ajo pa ia shqitur sytë. - Mund të jetë mësuese, po edhe ndonjë çupë... Gabohem?

- Jo...

- Cila nga të dyja?

- Vajzë...

- Ç'qenka kjo budallaqe, që m'i bën naze këtij farë djali për ta pirë në kupë? Më thuaj gërmen e parë.

- Sh.

Ajo shfletoi përsëri librin e saj, prap murmuriti fjalët e saj, prap veproi me parafinën si edhe më parë. Pastaj u ngrit në këmbë, iu rrotullua Sonit tre herë nga prapa, pastaj i doli para, e ngriti në këmbë, e uli ndenjurr, i mori dorën, i futi gishtin në tasin prej alumini dhe prap shfletoi librin e saj.

- Është arrë e fortë. E dinë shokët?

- E dinë. Kam vënë bast.

- Asnjëri, asnjë fjalë! Në se flet, për çfarë po bisedojmë, magjia prishet. Gjej një mënyrë për t'u mbyllur gojën shokëve, sa për fillim. Bëj çmos e merri asaj diçka të trupit dhe ma sill mua. Duhet të vish në të errur... Do të bëj të pamundurën! Je goxha djalë! - dhe prap e pa drejt në sy.

Ai u ngrit e futi dorën në xhep.

- Sa ju detyrohem?

Mustafa Tukaj

- Dymijë lekë, po t'i vetëm gjysmën, se je i ri e pa rrogë... Kur ta kryejmë punën, shohim e bëjmë...Eja e më trego për çdo ndryshim... Po vetëm në të ngrysur...Dhe mos fol me asnjëri e për asgjë... Mirë?

Soni i zgjati lekët. Ajo zgjati dorën.

E përcolli deri tek porta e jashtme.

Ai doli përjashta dhe i hipi biçikletës.

SHEJLA

Ç

do gjë që ndodh në këtë botë, sigurisht, që e ka një shkak. Edhe kur bie borë, edhe kur ngrin akulli, edhe kur të shfryhet goma e biçikletës, edhe kur s'të hahet, edhe kur s'të zë gjumi...

Vonë mbylla sy mbrëmë. Pas gjithë asaj rruge të lodhshme, kisha shumë nevojë të flija, se isha e kapitur. Edhe një natë më parë, kishim ndenjtur deri vonë në breg të detit, në diskon e hotelit, ku na kishin rënë brinjët së kërcyeri. Më pas, si për të harxhuar kaloritë e mbetura, u mblodhëm në dhomën time, ku bëmë lloj lloj lodrash, derisa mesuese Vjollca na detyroi të shpërndahehim, secili në dhomën e tij, ngaqë edhe hotelieri ishte ankuar, se po shqetësonim të tjerët...

Ndonjëri, si Bombonja a Tida, e bënë një sy gjumë në autobus në të kthyer. Edhe Redi që më kishte ruajtur ndenjësen pranë tij, u kot nja dy herë, kurse unë hiç që hiç. Gjatë gjithë kohës, që ishim në ekskursion, Redi nuk më la një çast vetëm, duke u përpjekur që kudo e për gjithçka të ishte i vlefshëm. Nuk është se më bezdiste prania e tij, përkundrazi, ai është një shok shumë i mirë, por unë kam hall, se mos afria e tepërt e bën të shohë ëndrra me sy hapur... Dy tri herë u përpoqa

Mustafa Tukaj

t'ia hedh larg e larg, se sa i vlerësoja shokët e vërtetë, se me një shok besnik si ai, do të kisha besim të shkoja, si me vëllain tim, edhe në mes të pyllit, po kam frikë, se atij ia përktente ndryshe truri i tij, se, herë herë më shihte drejt në sy, sa edhe më dhimsej, edhe më vinte për të qeshur...

Nuk them se e kaluam keq, por po të kishte qenë edhe Eri dhe po të mos kisha bërë fjalë me Enxhin, po për Erin, do të kishte qenë një ekskursion i paharruar. Nuk do të zgjatem hollësisht, pse u grinda me Enxhin. Në fakt, ajo nuk tha ndonjë kushedi se çfarë, vetëm sa e përmendi nja dy herë Erin, si me gjysëmshakaje... Në rrethana të tjera, nuk do të më kishin bërë përshtypje fjalët që tha, por ia kisha inatin dhe më dukej sikur ajo me veprimin e saj ishte bërë shkaktare, që Eri të mos vinte me klasën në Sarandë. Nuk u përmbajta dhe e quajta hileqare e gënjeshtare dhe desh u zumë keqas, po të mos shihnim të afrohej mesuese Vjollca. Që nga ai çast e deri në fund, ne nuk folëm me gojë me njëra tjetrën, edhe pse shokët u përpoqën dy tri herë të na pajtonin...

Në shtëpi prindërit po më prisnin, se kisha folur në celular me babin. Ishin të veshur shik dhe ishin bërë gati të shkonin në koncertin e një pianisti të shquar, kushëri i joni, që jetonte në Paris. Kishin blerë edhe një biletë për mua, por unë isha e lodhur dhe u thashë, se do të flija heret.

Me të dalë ata, para se të hyja në vaskë, ku zakonisht rrija gati tridhjetë minuta, i telefonova një herë Erit, që ta shaja, po telefoni ishte përsëri jashtë shërbimit...

Desh dola siç isha nga vaska, kur ra një herë telefoni, por ai pushoi para se unë të arrija të fshihesha dhe desh theva qafën, se nga shkuma me rrëshqiti këmba në dysheme. U gajasa së qeshuri, si e çmendur, po edhe e shava prap atë, që nuk e di pse ma kishte trazuar shpirtin ashtu. Prap e mora, kur dola nga banja, prap i njëjti zë gruaje, që lajmëronte, se telefoni ishte përkohësisht jashtë shërbimit.

Hëngra vetëm dy çapa nga lakrori fantastik që bënte ime më me pazia e majdanoz, që unë e pëlqeja shumë dhe nuk e shtyva dot më, as me lëng portokalli a pjeshke.

Mendova, se, me të vënë kokën në jastëk, do të më zinte gjumi, po hiç. Për të ndjellur gjumin mora librin “Konti e Monte Kristos”, që ma kishte dhënë Eri para një jave. E kisha marrë me vete edhe në ekskursion, po atje s’pata kohë as ta hapja. Edhe pse më pëlqejnë më shumë librat dhe filmat me temën e ditës, historia e Edmond Dantesit, personazhit kryesor të romanit, po më intrigonte shumë e herë herë më mbante të mbërthyer për orë të tëra. Po leximi nuk po ecte. Nuk përqëndrohesha dot...Ndoshta nga lodhja...

Mustafa Tukaj

E lashë librin mbi komodinë, mbylla sytë e fillova të numëroj dele...Ora aty pranë, dhuratë e Redit, e mbushte dhomën me cicërima zogjsh të magjishëm.

Prindërit u kthyen nga koncerti, kurse unë herë me sy mbyllur e herë me sy hapur dac, kthehesha majtas e djathtas e shfryja, sikur dikush sapo më kishte lëshuar fytin pas shtërgimit.

Nuk e di tamam, kur më rrejti gjumi.

Të nesërmen gati dola me vrap nga shtëpia.

Eri nuk ishte as te kthesa, ku zakonisht takoheshim, as në shkollë nuk erdhi. Mësuese Vjollca u shqetësua shumë, kur nuk e pa dhe se ç'i tha tërë mllëf nëndrejtoreshës... Edhe ajo ia ktheu, ndërsa pastaj hynë në drejtori që të dyja, ku i ngritën tonet.

Mezi u zvarrit mësimi deri në fund. Enxhi s'bënte veri me gojë. I ndjente majtas e djathtas shigjetat e vështrimeve, që e akuzonin në heshtje dhe, megjithëse ajo në tërësi është një vajzë moskokëçarëse e indiferente ndaj problemeve të tjerëve, ndoshta kishte filluar të brehej, edhe nga që pothuaj të gjithë e kishin kuptuar, se ajo ishte fajtorja, kështu që kurrsesi s'donte të armiqësohej me të gjithë...

Kur pas mësimit ai nuk u bë i gjallë askund, as tek porta e shkollës, as te kthesa jonë, më tha mendja, se mos ishte sëmurë dhe nxitova hapat të largohesha, me të rënë zilja e fundit. Redi më

thirri ta prisja, se do të më çonte me makinë, po unë vetëm sa i bëra me dorë, duke e lënë disi të hutuar dhe vrapova teposhtë shkallëve... Me të kaluar portën e shkollës, pata ndjesinë se po më ndiqnin me biçikletë, po nuk e ktheva kokën. Sigurisht, që do të ishte Soni, po aq më bëri... Unë e ndjej, se ai nuk është më ai kaposhi i fillimit, se, kur më hedh tani ndonjë fjalë ngacmuese, nuk e ka më atë sigurinë në vetvete, që kishte më parë... Nganjëherë edhe më vjen keq për të, se me ç'kam kuptuar, edhe shokët e tij nuk e lënë rehat... Po, tek e fundit, mirë t'i bëhet, se e mori pak si me të madh në fillim... Të mos kujtojë, se meqë është i pashëm e sportist i talentuar, siç thonë, mund të bëjë tak- fak për vete çfarë të dojë e kë të dojë... Sa për atë shokun e tij Zarin, nuk e shoh dot me sy dhe, vërtetë nuk e kuptoj, se ç'i ka pëlqyer Enxhi atij... I kam parë dy tre herë bashkë pasdrekeve... Enxhi nuk e fsheh këtë, bile e thotë me mburrje, se ka një djalë... Asaj gjithmonë i ka pëlqyer të japë më e madhe, se ç'është në të vërtetë, edhe në sjellje, edhe në veshje... Po kështu nuk ka të sharë... Hiqi ca puçrra moshe herë herë, (lavdi zotit qe deri tani kam shpëtuar prej tyre!) alamet goce është!

Nuk e ktheva kokën asnjëherë prapa, as kur nja dy herë i ranë borisë... Mbase e kisha gabim, kur thashë, se Soni po më ndiqte, se ai nuk u duk gjëkundi... Ndofta, ngaqë jam mësuar, që gjithnjë

Mustafa Tukaj

të shoqërohem nga dikush, qoftë nga afër, qoftë nga larg...

Nuk u ktheva fare në shtëpi, po drejt e te pallati i Erit. Shkallët i ngjita me një frymë, po askush nuk u përgjigj, kur i rashë ziles... Dy tri herë... Dukej, që s'kishte njeri në shtëpi...

Pasi provova edhe dy tri herë të tjera të telefonoja e s'mora përgjigje, andej nga pasdrekja i shkova edhe një herë në shtëpi...Pas ziles, më në fund dëgjova hapat që afroreshin dhe pas pak dera u hap.

- Me se mund ta ndihmoj këtë bukuroshe? - më pyeti në vend të përshëndetjes, një burrë i thyer në moshë, që në vend të gojës kishte një si zgavër pa as edhe një dhëmb të vetëm...Nga stërmundimi për të më falur një buzëqeshje, për pak më stërpiku me ca si jargë...

- Më falni, desha Erin... - thashë dhe për pak sa nuk ia shkrepë gazet, kur pashë se si m'i nguli sytë.

- Erin? Kush është Eri?! - pyeti ai i hutuar.

- Eri Shkreli... Është shoku im...

- Aaa, Shkreli, po po...Jo, nuk banon këtu...

- Si nuk banon...Kjo është shtëpia e tij...

- Ishte, bukuroshe, tani nuk është... Po ti futu brenda, ta shpjegoj më mirë.. - dhe më nguli sytë e tij si dy sfera të kaltërta, thua se, përpiquej të më hipnotizonte...

- *Nuk kam kohë, po me gjithë qejf.. .- i thashë, ndërsa pastaj shtova:*

- *Me siguri një herë tjetër.. . - dhe u lëshova teposhtë shkallëve, edhe nga frika se mos ai vërtet ishte hipnotizues dhe mund të më zhvishte krejt me ata sytë e tij sferikë, që m'i kishte ngjitur pas si zamkë, apo do të më kollufiste të tërën e do të më mllaçiste nepër atë gojë pa dhëmbë, si të ishte goja e një kërmilli të stërmadh...*

Gjithsesi prap më priste një natë e trazuar...

LAJME TË ÇUDITSHME

P

ortjeri mbylli portën fiks në shtatë e tridhjetë. Përfashta mbetën pesëdhjetë e shtatë nxënës, nga të cilët pesëdhjetë e një të panjohur... Një rromujë për ta patur zili, me fëmijë që klithnin, se kishin ardhur në kohë, po ora e shkollës ishte keq; me të tjerë që përpiqeshin të shfajësoheshin; klithma, pse duke dashur t'i afrohen derës, dikujt i kishin shkelur këmbën apo një tjetri i kishin ngulur një gjilpërë në prapanicë... Të qeshura. Në mes tyre edhe të njohurit tanë Bombonja, i bërë lulkuq nga të vrapuarit; Nimfa, që atë ditë ndoshta ish vonuar, pse kishte ndrruar *look*-un e flokëve dhe gati si e mekur zgjatej t'i thoshte diçka Sonit; Enxhi në mëdyshje nga propozimi i Zarit për të ikur fare

dhe që pastaj bashkë me të ia plasën gazit, kushedi pse, pa e vrarë mendjen, se pak më tutje vetë mësuese Irini, po merrte shënim emrat e atyre, që hynin brenda. I fundit nga miqtë tanë ishte Redi, që sapo zbriti nga makina, i tha shoferit të largohej e u bashkua me turmën pa nxituar. Kishte veshur një këmishë të shtrenjtë me kuadrate vishnje dhe një palë xhinse të ngushtë kafë të mbylltë, që i shkonin për bukuri dhe e nxirrnin disi më të hollë. Në fakt, kohët e fundit, me sa duket nga stërvitja e ndoshta frenimi që i bënte oreksit të tij shembullor, sikur kishte rënë ca në peshë e kishte lëshuar shtat, aq sa bashkë me Sonin e Zarin si tre qiellgërvishtës dilnin mbi kokat e të tjerëve...

Lajmet e klasës. Flash.

Eri mungoi prap në shkollë.

Mësuese Vjollca u bë spec nga inati, por u përmbajt. I tha Shejlës ta takonte pas mësimit.

Shejla vari hundët dhe nuk harroi ta thumbojë Enxhin.

Test i papritur në fizikë.

Nimfa u shqetësua, se nuk mbante mirë mend me ç'këmbë kishte hyrë në klasë. Në raste të tilla hynte me këmbën e majtë...

Tida pati të marra mendsh dhe thirrën menjëherë mjekun. Asgjë me rëndësi, tha ai, probleme moshe.

Mustafa Tukaj

Redin e Shejlën i lajmëruan të vinin pasdreke në shkollë për t'u dhënë këshillat e fundit për konkursin e biologjisë.

Në orën e gjeografisë, teksa nxënësit bënë punë të pavarur me hartat memece, Arlindi vizatoi profilin e Nimfës. Ia dhuroi në fund të mësimit.

Në pushimin e madh dikush tha, se kishte parë Erin me një burrë të hynte në drejtori.

Burri ishte paraqitur si daja i madh i të akuzuarit për thyerje disipline dhe se kishte ardhur të sqaronte problemin e të nipit. Askush nuk di më gjatë.

Sipas një burimi të pidentifikuar, palët qëndruan në pozicionet e tyre. Daja ishte brisk nga goja, i njihte mirë rregulloret dhe i kishte kërkuar llogari, se me ç'të drejtë ajo e kishte nxjerrë jashtë nga shkolla të nipin, aq më tepër, kur nuk ishte provuar fajësia e tij. Madje ai i kishte kujtuar, se një gjë të tillë kishte ndërmend t'ia thoshte edhe zv/ministrit të arsimit, z. Gazmir, në takimin e tij më të parë me të...

Irinit, e cila këto ditë kishte hapur fjalë, se priste ngritjen e saj në detyrë, i kishin rënë ca puplat dhe më në fund kishte deklaruar, se Eri mund të vinte në mësim, por, po të mos studionte më shumë, rrezikonte të mbetej në klasë...

Eri iku me dajën dhe nuk pati kohë të takojë shokët...

Shejlës i humbi shamia. E kërkoi gjithandej, po nuk e gjeti. Ajo bënte be e rrufe, se pak më parë e kishte patur...

Shokët bënë shaka dhe i kujtuan Desdemonën...

*** *** ***

...Se ç'pati një parandjenjë, se Eri po e priste tek porta e shkollës dhe nxitoi. Redi bëri ta ndiqte, po ajo i kujtoi të mos harronte për pasdrecken dhe fluturoi shkallëve.

U zhgënjye kur nuk e pa. E rrejti mendja, se ai do të qe fshehur diku mbas ndonjë dyqani dhe veç kur t'i shfaqej... Por ajo bëri gjysmën e rrugës dhe ai nuk dukej gjëkund. As te semafori. As kur mori kthesën për në shtëpinë e saj...

Para portës ndali për një çast e ktheu kokën, se mos e dallonte në largësi, por asgjë... Qeni zuri të lehë. Me sa duket, i ndjeu erën. Ajo priti edhe ca, pastaj si me përtesë hapi derën. Qeni iu hodh në qafë. Ajo e ledhatoi poshtë gushës, siç bënte zakonisht, po kafsha, si të kuptonte diçka instinktivisht, u fërkua nja dy herë pas këmbëve të saj dhe u largua ngadalë nga prapa shtëpisë. Shejla nuk i thirri... E përhumur ngjiti shkallët. E çuditshme! Pesë ditë pa u parë e ai të mos vinte ta takonte? Kurrë nuk e kishte menduar, se do ta ndjente kaq shumë mungesën e tij... Po pse? Po ai,

Mustafa Tukaj

dreq, ku kishte humbur? Vërtetë kishte qenë sot në shkollë, apo ia këputën kot? Se, nuk ka mundësi.... Ajo i njihte dhëmbë e dhëmballë... E ku mund të duronte ai, pa e futur kokën në klasë, qoftë edhe për njëzet sekonda, sa për të lëshuar ndonjë nga broçkullat e tij. Mos u mban mëri shokëve? Apo i ka mbetur hatri nga ajo? Po për çfarë? Veç në mos i dilte para, se do ta grinte!...

Ra zilja. U turr si e çmendur drejt portës dhe e hapi pa pyetur, kush është.

Posta. Faturat e dritave dhe ujit.

Desh e shau postierin e gjorë, që rrudhi supet, pa e kuptuar, se ç'pati ashtu vajza e doktorit, që ia tërhoqi ato nga dora dhe pa e përshëndetur, i mbylli derën në turinj, gjë që s'kishte ndodhur kurrë ndonjëherë...

Bëri një dush dhe u ul të hajë... Pikë oreksi! Kishte vapë. Ashtu pa u mbuluar u shtri në divan. E rrejt i gjumi. Mbrëmë kishte fjetur keq...

Ra zilja e telefonit. U ngrit trembshëm dhe kapi dorezën. Ishte i ati. I tha se do të vonoheshin ca në darkë, se kishin një rast me mamanë dhe ajo, po të donte, të mos i priste, se do të ktheheshin vonë... Po të ishte kush tjetër, kushedi, ç'do ti kishte sharë, që i prishën gjumin...

Donte edhe një orë e njëzet minuta, që të shkonte në shkollë. Vendosi të hapë kompjuterin, për të vrarë kohën. E ndezi. Përsëri ra telefoni. Një kushëri i tyre i largët, që pyeti për të atin.

Nuk e shau, se nuk i prishi ndonjë punë. Telefoni ra edhe dy herë të tjera. Hera e fundit i ngriti nervat. Dikush ishte pas telefonit e merrte frymë, po nuk fliste. Pastaj u dëgjua një e qeshur e stisur femre, por ajo mendoj, se ishte një imitim mashkulli... E la ashtu të hapur telefonin dhe shkoi përsëri tek kompjuteri... Kishte tri ftesa të reja në *facebook*. Nuk i njihte. E mbylli kompjuterin dhe shkoi në dhomën e saj. Mori librin. Ngjarjet e vrullëshme të Montekristos, do t'ia largonin, mbase, atë pshtjellim mendimesh, që e kishin pushtuar të tërën. Po edhe pse subjekti, tani pas njëqind e pesëdhjetë faqesh që bërë vërtet interesant e intrigues, nuk po përqëndrohej... Me libër në dorë doli në verandë dhe u ul në kanape... Mbase aty përjashta mund të ishte më mirë...

Dikush ishte në portë. Nuk desh të ngrihej. Po zilja vazhdonte të binte. Do të jetë ndonjë i njohur, që i bie kaq herë... Një pak i njohur, ose aspak i njohur i bie veç një herë. E shumta dy. Pastaj pret. Mirë, mirë, prit, se po ta hap!

Me përtesë e pa u ngutur shkoi tek porta. E hapi. Ishte Eri me një biçikletë për dore.

- Ti?!

- Po, siç e sheh, me gjithë rreca...

- Kujtova, se mos e kishe harruar portën dhe numrin e telefonit...

- Të kam marrë dje pasdreke. Askush nuk u përgjigj...

Mustafa Tukaj

- Hyr!

- Nuk do të rri shumë, se nuk kam kohë...

Të dy hynë brenda. Biçikletën e mbështeti për mur.

- As sot nuk pate kohë në shkollë, të paktën sa për të na përshëndetur...

- Nuk kishte kohë Miloja...

- Kush është Miloja?

- Ai që pranoi të vinte në shkollë me mua, pra.

- Po dajën nuk ta quajnë Milo...

- Kush tha, se ishte daja? Ai ashtu iu paraqit nëndrejtoreshës. Në fakt, është një ishoficer, me të cilin ngandonjëherë luaj shah. Iu luta të vinte...Ai pranoi.U tregua i madh!..Ta shihje Irinin. Një fytyrë i vinte e një i ikte, kur Miloja, me atë zë të trashë që ka, nisi t'i kërkojë llogari...Ikëm shpejt të dy, se mos na krijohej ndonjë situatë...

- Po pas mësimit?

- Nuk kisha kohë...

- Je bërë enigmatik.. Pesë ditë...

- E di, jo prej qejfit..Pa hë, si ja kaluat në Sarandë? U kënaqët?

- Jo keq...Po ti ç'paske poshtë syrit?

- Hiç, u rrëzova... Një ditë para Sarandës...

- Do një limonadë?

- Më mirë një kaki...Po e këpus vetë...Janë fantastikë!

U zgjat pak dhe e këputi një kokërr. E fshiu me pëllëmbë dhe e kafshoi.

Pa librin mbi kanape dhe e mori në dorë.

- Po të pëlqen?

- Po. Është bërë interesant...

- Prit edhe ca. Do të shohësh, se si hakmerret Edmond Dantesi me ata të tre: DANGLAR, FERNAND, VILFOR...Shpejt do ta kenë rradhën ata të mitë...

- Për kë e ke fjalën?

- Duro pak, çupë, se ti do ta marrësh vesh e para, sigurisht... Durimi është ilaç i mirë për të gjithë...Tani më shumë se kurrë, po ia njoh vlerat... Jo vetëm unë, por të gjithë...

- Ti se ç'ke. Sikur ke ndryshuar kaq shpejt...

- Sigurisht që kam ndryshuar... Lagje, shtëpi, njerëz, banjo, kohë zgjimi... Nuk është pak apo jo?

- Të kërkoja në shtëpi. Më doli një burrë tjetër...

- Po, pra, ashtu vendosëm, që të ndërrojmë ajër...Tani jemi në anën tjetër të qytetit...

- Po pse, nuk ishit mirë këtu?

- Ishim ca ngushtë tani jemi më gjërë...Dy familje në dy dhoma...Nuk e ke idenë, sa qejf është të presësh rradhën në mëngjes për të hyrë në banjë!

- Të lutem, mos u tall! Më thuaj të vërtetën!

- Problemin me banjon unë e kam në darkë, se në mëngjes e zë i pari...

Mustafa Tukaj

Shejla po e ndjente se prapa shakasë së tij të hidhur fshihej diçka aspak e këndshme, po ai hidhej degë më degë e po e bënte lëmsh...

- Ore, ti, do të më thuash si e ke hallin, apo si?

- Krejt e thjeshtë, është vetëm një banjë, që pret të vizitohet nga dy familje, e jona dhe e dajës, ku kemi shkuar përkohësisht, sa të gjejmë një shtëpi tjetër...Të gjithëve po u kalitet durimi...Ata pesë, ne katër...

- Pse katër?

- I pesti, babai, ka ikur në Greqi...

- Pse?

- Të fitojë para, pra. Na duhen për shtëpinë e re...

- Kur iku?

- Atë ditë, që ju u nisët për Sarandë. Dhe jam në merak...Asnjë lajm...

- Me avion shkoi?

- Me autobus deri në kufi...Pastaj malit në këmbë...

- E tmerrshme! Xhaxhi Çimi të rrezikojë kaq shumë? Nuk mund të priste? - tha gati me lot në sy, duke kujtuar çfarë kishte dëgjuar më parë nga raste të tilla e sidomos nga një emision televiziv për njerëzit e humbur.

- Jo...

- Nuk ma kishte marrë kurrë mendja...

- Ika tani, se u bëra vonë...

- Prit edhe pak, se do të shkoj në shkollë...
Pasnesër kemi konkursin e biologjisë...

- Më vjen keq, po nuk mundem...Kam marrë borxh(o zot sa fjalë e tmerrshme!) biçikletën...Më duhet t'ia çoj një shoku të punës...

- Çfarë? - klithi, si të kish dëgjuar një lajm të kobshëm.

- Mbaje veten, çupë!Nuk jemi më kalamaj!A nuk të thashë, se problemin e banjos në mëngjes e kam të zgjidhur? Nuk e di pse? Ta them unë. Sepse, kur unë zgjohem për të shkuar në punë në katër të mëngjesit, banjoja është e lirë, ngaqë flenë gjithë...

- Kur ngrihesh?

- Në katër të mëngjesit.

- Pse, ku punon?

- Në një furrë buke. Më ka marrë në punë një shok i dajës. I ndihmoj për brumin, për pjekjen. Është kënaqësi e madhe...Pastaj në pesë e gjysëm shpërndaj bukën nepër disa restorante...Më parë këtë e bënte një tjetër me makinë, tani e bëj unë me biçiletë...Restorantet nuk janë shumë larg furrës...E kam edhe si fiskulturë mëngjesi...Në shtatë jam i lirë...Tani më duhet të zvendësoj Baçin në furrë, se shes bukë. Nuk e ke idenë ç'aromë të mirë që ka! Në shtëpi është rrëmujë, aty jam vetëm e mund të marr edhe librat... I gjithë problemi është, mos më spiunon dikush dhe e marr në qafë xha Baçin, se për çështje punë neve

Mustafa Tukaj

na quajnë të mitur... A, prit, shënoje këtë numër telefoni, është i furrës...Më merr ndonjëherë, po qe urgjent...

Shejla kish mbetur e shtangur dhe i qe lidhur goja.Vdekjen edhe mund ta kishte menduar, por këtë që po i dëgjonin veshët, kurrën e kurrës!

- Kushedi sa qejf do të jetë, kur të marr rrogën!..Sigurisht, ty do to qeras të parën. Ika tani. Shihemi nesër në shkollë... Gjithçka që dëgjove, harroje, sa të mbyllësh derën! Mirë? - dhe i ra lehtë supit e doli përjashta.

Edhe pasi ai qe larguar, Shejla mbeti për disa çaste pas portës, si e ngrirë, si ta kishin prekur shtrigat e përrallave me me shkopin e tyre magjik, me të cilin i kthenin njerëzit në gurë...

...E meqë përmendëm shtrigat, disa orë më vonë, në të ngrysur, kur muzgu po gllabëronte gjithçka, porta me numër 232 u hap dhe brenda hyri, siç edhe mund ta merrni me mend, Soni ynë. Shegushja, sigurisht, nuk kishte asgjë të përbashkët me shtrigat e përrallave... Ajo, madje, qeshte bukur dhe dinte edhe të të përqafonte, jo për gjë, po sa për të të hequr ndrojtjen... Asaj i vinte keq për këtë goxha çun, që po mundohej aq shumë nga një çupërlinë, por ajo do të bënte ç' ishte e mundur, për t'i larguar asaj perden, që i

kishte veshur sytë e nuk shihte, se ç' djalosh kishte përpara...

Nejse, ai paska sjellë një shami të vajzës! Kaq mjafton, besoj! Gjithsesi, biseda të tilla nuk bëheshin në këmbë...Le të ulëshin për pak kohë, ja aty në verandë, me nga një lëng shege përpara...

ENXHI KËRKON FALJE

L

ajmin se e kishin grumbulluar me ekipin përfaqësues të U- 17 dhe se pas një jave do të bënin një ndeshje miqësore në Maltë, ia tha vetë trajneri në telefon. Atë natë zor se mbylli sy deri në agim. Dhe meqenëse, siç thonë, lajmi ka krahë, të nesërmen oborri shkollës gumëzhiu si koshere bletësh në pushim të madh dhe shikime kënaqësie, kërsërie apo zilie i hidheshin nga të gjitha anët...Ai bënte sikur nuk i vinte e re dhe bisedonte, në dukje i qetë, me “dorën e tij” të Grupit të Garipave, ku sigurisht, Zari, si shoku më i ngushtë krekozej, a thua se fjala ishte për të e jo për Sonin. Ky i fundit gati sa s’fluturonte nga shendi, se, me sa dukej, po fillonte mbarësia dhe se “lëngu i shegës” kishte filluar të bënte efektin e duhur. Të lumtë Shegushe! Meriton edhe një dhuratë nga Malta! Veç mos harro shaminë!...

Ky lajm ndërroi shumë plane: Enxhi u detyrua ta shtyjë mbrëmjen, deri sa Soni të kthehej nga Malta; Zarit do t’i rritej padurimi, për të vizituar shtëpinë e saj dhe se do t’i duhej të priste edhe disa ditë, para se të realizonte dëshirën e tij të kaheërshme për t’u gjendur vetëm për vetëm me Enxhin...Kjo do të ndodhte, pasi të kishin ardhur

në qejf me pije ekzotike dhe miqtë e tjerë të ishin larguar...Një gjë të tillë ia kishte premtuar vetë Enxhi, sepse, siç ishte parashikuar, xhaxhai i saj i pasur, me të cilin ajo jetonte, do të nisej po atë ditë me të shoqen diku jashtë qyteti, për t'u kthyer të nesërmen.

Në fillim ajo kishte menduar të mbante atë natë edhe Nimfën për t'i bërë shoqëri e, sigurisht, Sonin... Po Zari këmbënguli, që ajo të pajtohej me Shejlën e t'i mbushte mendjen asaj, që t'i bënte shoqëri atë natë...

Afrimi me Shejlën nisi të nesërmen. Enxhi nuk ishte budallaqe, sa të mos kuptonte, se rruga për te Shejla kalonte nga Eri. Në fillim Eri e pastaj Shejla.

Ishte ora e gjeografisë. Eri kishte humbur në të tijat. Po bëheshin shumë ditë dhe prap asnjë lajm nga i ati. Daja po bënte ç'ishte e mundur të lidhej me miqtë e tij për të mësuar diçka... Ai po mendonte dhe as që e kishte mendjen fare te shpjegimi i Lolloosë. Kështu ia kishin vënë nofkën mësueses së gjeografisë, që fliste më një ton të njëtrajtshëm e të mërzitshëm, pa përdorur qoftë edhe një shenjë të vetme pikësimi... Kohët e fundit s'kishte muzikë në botë më të përshtatëshme se zëri i saj, për t'i ndjellur gjumë. Nisi të kotej dhe koka iu var. Nimfa e pa dhe filloi të qeshë nën zë. Ktheu kokën prapa dhe i bëri me shenjë Visarit. Edhe ai qeshi... E qeshura, thonë, është si

Mustafa Tukaj

sëmundje ngjitëse, sepse pothuajse të gjithë, përjashto Shejlën që u bë spec i kuq nga inati, filluan të qeshin. Vetëm ajo e dinte shkakun e gjumit të tij. Madje edhe pse nga këmbët e tij të zgjatura dallohej njëri çorap i veshur mbrapsht...

Llolloja ndërpreu mësimin dhe ngriti tonin.

- Ç'ka këtu për të qeshur?!

Eri u tremb pak nga zëri i saj dhe ngriti kokën me të shpejtë, pa qenë në gjëndje të kuptojë, ç'patën ashtu nxënësit e tjerë, që ia krisën gazit.

- Do të flisni, apo si e keni hallin?

- Qeshin me mua, mesuese... - ndërhyri, kur askush nuk e priste, Enxhi.

- Më rrejti gjumi, se kisha mbrëmë xhaxhain sëmurë dhe nuk kam fjetur tërë natën...

Ndërhyrja e saj qe kaq e beftë, sa shoi si me dorë atë gaz, që kishte pushtuar klasën. E kush, pa, Enxhi, që e njihnin të gjithë dhe e dinin, sa e ftohtë ishte ndaj halleve të të tjerëve. Po çudinë më të madhe e pati Shejla. Dhe si për ta çuar deri në fund veprimin e saj të habitshëm, në pushimin në mes orëve Enxhi iu afrua Erit dhe i tha që ta dëgjonin edhe të tjerët:

- Të kërkoj falje...U tregova frikacake me mesuese Irinin... Ti je shok i mirë...

- Nuk vlen tani mbas kosit!.. Duhej, para se nëndrejtoresha ta detyronte të sillte prindin. -

ndërhyri Arlindi, që ishte tepër i pastër në shpirt dhe donte t'i vinte gjërat në vend.

- Mirë do të ishte, po nuk ma mbajti...Unë po i kërkoj falje...

- Enxhi, e di ç'ke ti? Më jep një krëhër, se i kam flokët për dreq! - tha Eri, duke i bërë të gjithë të qeshnin edhe një herë...

NËNDREJTORESHA

Q

ë nga ajo ditë e deri sa të ftuarit u mblodhën në shtëpinë e xhaxhait të Enxhit për atë *party* të shumëpritur kaloi java e fundit e tetorit dhe hyri nëntori bashkë me retë e para në horizont. Gjatë kësaj kohe pati këto ngjarje, që edhe pse të rëndësishme në vetvete, nuk ndikuan edhe aq në shtjellën kryesore të tregimit tonë:

Babai i Erit, më në fund, u bë i gjallë duke lajmëruar, se kishte zënë vend në një fshat të Selanikut dhe mbliidhte ullinj e agrume. Siç bënte me dije, ai punonte trembëdhjetë orë në ditë...

Zgjedhjet parlamentare përfunduan e bashkë me ta edhe shamata politike kudo.

Babai i Redit u zgjodh deputet.

Eri mori rrogën e parë dhe qerasi Shejlën e Redin me trileçen e tyre të preferuar. Gjithashtu ai vazhdimisht lexonte lajmërimet në gazeta në ndryshme dhe ia kishte vënë syrin një garsionierje jo shumë larg qendrës për ta marrë më qera, meqë edhe e ëma kish nisur punë në një fabrikë këpucësh me pronar të huaj.

Soni u kthye nga Malta me një gol të shënuar e me lëvdata të shumta në shtyp për të...E gjitha kjo, sipas tij, kishte lidhje vetëm me Shegushën, së cilës i solli një shall najloni...

Enxhi e theu akullin me Shejlën dhe i mbushi mendjen me përgjërime të mos mungonte në *party-n* e saj. Mund të vinte e shoqëruar nga Redi, meqë Eri i kishte thënë, se nuk shkëputej dot në atë orë, kur kishte pikun e punës... Shejla kishte kundërshtuar, po Eri meqë nuk e dinte, se edhe kush tjetër do të ishte e si do të rridhnin ngjarjet, i kishte mbushur mendjen të shkonte, sepse nuk kishte gjë të keqe, të mblidheshin me shokët e klasës. Madje i kishte kujtuar, se pas ca ditësh ishte rradha e tij dhe vetëm katër ditë më pas ishte ditëlindja e saj...

Kur Soni mësoi lajmin se Shejla kishte pranuar, ngriti kokën lart e falenderoi zotin, që e kishte çuar në atë tren e në atë vagon, ku kishte mësuar për atë grua çudibërëre, që edhe në fytyrë ishte e kuqe si lëng shege...

Mustafa Tukaj

Zari numëronte ditët deri në mbrëmjen finale dhe filloi të marrë masat për të siguruar gjërat më të nevojshme, që do t'i rrisnin vlerat mbrëmjes dhe do të shënonin hapa të mëdhenj zhvillimi...

Nuk u zu më me Erin, veç e shihte vëngër, kur ndesheshin rrugës apo në oborrin e shkollës, si për t'i kujtuar se po të dridhte bishtin prap, do t'ia bënte edhe më zi...

Vraga poshtë syrit që shëruar fare, por jo plaga në shpirt. Aty strukej një inat i heshtur, si një gjarpër i fjetur poshtë një rrase dhe veç priste rastin të pickonte. Tre ishin ata, mbi të cilët mund të binte hakmarrja e Erit dhe ai u kishte vënë po ata emra si edhe ata të tre te Konti i Montekristos: DANGLAR, FERNAND, VILFOR...

*** *** ***

...Atë pasdreke qielli ish nxirë sterrë nga një re e stërmadhe, që kish gllabëruar të gjithë qytetin dhe nga çasti në çast pritej të fillonte rrebeshi. Nëndrejtoreshë Irini, së cilës i shndriste fytyra, po merrte masat e fundit për të pritur mikeshën e saj të respektuar, që ishte njëkohësisht edhe motra e madhe e Sokolit, kryeinspektorit të drejtorisë arsimore, me të cilën ajo e kishte trashur shumë miqësinë kohët e fundit. Ishte pikërisht ajo, që i kishte premtuar vendin aq shumë të lakmuar të drejtorit të shkollës, kuptohet, kundrejt një

shpërblimi material, për të cilin do të binin dakord sot, se, siç edhe kishte dëgjuar rëndom, rrota e qerres kërcet, po të mos vajiset...

Ishin njohur rastësisht në rrethana plazhi tre muaj më parë, të dyja në rroba banje, shtrirë sa gjërë gjatë si dy foka, veçse jo në akullin polar, por mbi rërën e nxehtë, që po u “shkrinte” kockat. Biseda u kishte ngjitur si mastiç dhe ja, pikërisht sot, kokë më kokë e pa dëshmitarë do të vinin pikat mbi “ i ”. I shoqi duhet “ të strehohej ” në kuzhinë e të mos dukej deri në fund të bisedës...

Donte edhe një orë pak a shumë, deri sa të vinte ajo, kështu që Irini, mendoj të bënte një shplarje të shpejtë dhe të priste mikeshën e saj në dhomën e pritjes. Me këto mendime krejtësisht të bukura ajo hyri në banjë, u zhvesh, por, teksa kontrollonte me dorë ujin e dushit, në holl u dëgjua tringëllima e ziles së telefonit. Sigurisht, ajo nuk i vuri vesh, se i shoqi do t’ i kthente gjegje, po i trokitën në portën e banjos dhe ajo, ashtu siç ishte u mbështoll me peshqir dhe nxori kokën:

- Ç’është?
- Të kërkojnë urgjentisht në shkollë...
- Pse, ç’ka ndodhur?
- Diçka e rëndë, po nuk më thanë se çfarë...
- Kush ishte? Nuk pyete?
- Mësuesi i fizkulturës, më tha...

Doli me të shpejtë, u vesh po me të shpejtë, i hodhi një sy orës në korridor dhe u mat të dilte.

- Prit ku shkon?

- Në shkollë, ku tjetër?

- Nuk e sheh, se është bërë gati të shkrehet shtërngata?

- Nuk është larg... Do edhe tre çerekë ore që të vijë Fini... Mbase shkoj e vi në kohë e pa shtërngatë... - tha ajo, që filloi të mbathë këpucët.

- Pse s'merr njëherë në telefon?

- Telefoni është në drejtori, ata do të kenë lajmëruar me celular...Duhet të shkoj patjetër. Ma kanë lënë dopio gjashtën mua...Nuk mund të mos shkoj...Ika! Po erdhi Fini, fute brenda dhe mos e lër të mërzhitet!... Tregoi se ku jam. Ika! - dhe u sul përjashta, pa pyetur, se tamam atë çast u shkreh një rrebesh, a thua se ishin çarë krej qiejt, që shkrepëtinin me vetëtima rrëqethëse e gjëmonin frikëshëm me bubullima.

Çadra e saj vetëm sa i mbronte kokën, se trupi e sidomos këmbët shpejt u bënë qull, edhe nga pellgjet e ujit që shpejt u krijuan aty këtu.

Një herë u mat të futej në ndonjë strehë, po as në shkollë e as në shtëpi koha nuk priste, kështu që ajo, pa pyetur se qe bërë për t'u shtrydhur, i dha vetes përpara, sikur donte të hynte në librin e rekordeve... Me siguri Irini ishte i vetmi këmbësor, që çante në ato çaste përmes një rrebeshi të tillë. Shkolla ishte vetëm dhjetë minuta

larg, por asaj iu bë se kishte ecur plot një orë, deri sa mbërriti në shkollë. Porta e jashtme ishte e mbyllur dhe deri sa roja ia hapi, iu duk një shekull në atë qamet, që si për inat, jo vetëm nuk qe fashitur ndonjë grimë, po përkundrazi e kish shtuar forcën e dëndësinë...

- Ç'ka ndodhur? - pyeti me të shpejtë rojen e hutuar, nga kjo ardhje e papritur e Irinit përmes këtij qameti.

- Ku? - pyeti ai pa e kuptuar.

- Këtu, or tutkun, ku tjetër?

Nuk i pëlqeu aspak epiteti që i vuri nëndrejtoresha, po mbase, e shkreta, nuk do të qe në rregull, me siguri, kështu që iu përgjigj:

- Asgjë s'ka ndodhur...Ç'do të ngjiste?

- Ku është Niku?

E kishte fjalën për mësuesin e fizkulturës.

- Nuk ka ardhur sot pasdreke. Nuk e shikon, nëndrejtoreshë, ç'tmerr është?!

Për pak desh i shpëtoi: "Pse, budalla është ai"

Ajo nuk e zgjati më, po i zvarriti këmbët deri brenda në shkollë.

Gjithçka qetësi. Herë herë dëgjoreshin zërat e mësueseve të fillores, që shpjegonin mësimin me zë të lartë.

U ngjiti në kat të dytë dhe hyri në drejtori. Kapi dorezën e telefonit dhe formoi një numër.

Mustafa Tukaj

- Alo, jam Irini! A erdhi Fini? Jo? Mirë, mirë... Dëgjo çfarë të them: merr urgjent Telekomin dhe pyet ç'numër na telefonoi qëparë. Këtu nuk ka ndodhur asgjë dhe nuk ka asnjë mësues fizkulture. Ja, tani vij... Nuk kam ç'të ruhem më... Jam bërë, sikur kam rënë në lumë... Degjove? - dhe si uli dorezën, mbylli derën e drejtorisë dhe u ul pa u ngutur shkallëve, për të përshkruar edhe një herë në kthim atë distancë përmes atij shiu, që binte si litar.

Roja ia hapi edhe njëherë derën, i tha “natën e mirë” dhe tundi supet e rrudhi buzët, pa qenë në gjendje të kuptojë asgjë, se ç'e kishte trazuar e detyruar nëndrejtoreshën të merrte mundimin përmes një tmerri të tillë...

- Hë, kush ishte? - pyeti ajo me të futur këmbën e parë në shtëpi.

- Nuk është familjar. Kanë marrë nga një telefon rruge...

Të nesërmen Irini nuk erdhi në shkollë. Kishte marrë një të ftohur të lehtë dhe shkoi tek doktori.

Të interesuarit dhe kureshtarët e kuptuan shkakun nga roja i shkollës.

Ndërsa pasdreke në furrën e bukës, kur mbeti vetëm, Eri shkroi në një copë letër: “DANGLAR”, pastaj në çast i ra kryq emrit dhe,

si e mblodhi letrën shuk, e hodhi në koshin e plehrave...

REDI

A

s unë nuk e di, pse shoh kaq shumë ëndrra. Dhe ç'është më e çuditshmja, të gjitha gati njësoj...Vendet, ku gjendem dhe kohët janë të ndryshme, po, herë në një mënyrë e herë në një tjetër, Shejla do të më shfaqet këtu apo atje. Në ëndrra bëhem trim, e zë për dore, e përqafoj, shëtisim në pyje e lëndina, shtrihemi në bar a diku në një plazh të vetmuar, përqafohemi, ngjeshemi pas ndonjë shkëmbi a vrapojmë mbi kuaj të bardhë... Pse të gënjej, kur zgjohem, zhgënjehem që isha në ëndërr dhe ndjehem keq, kur shikoj çarçafët e zhubravitur...

Në të vërtetë jemi bërë shumë shokë. Që pas Sarandës e kemi trashur miqësinë, se na qëlloi të rrinim gjatë bashkë. Megjithatë, kam filluar ta ndjej, se miqësia jonë po merr tjetër rrugë... Me sa duket, me gjithë këto tule që kam e këtë fytyrë të gjërë, nuk mund të jem tipi i saj...Krejt kot i hakërrehem pasqyrës! Po ndoshta kështu më duket mua dhe nuk duhet të heq dorë, po të pres me durim, se është ende herët.

Dje më puthi në faqe. Po e bënim rrugën në këmbë. E nisa Gimin, shoferin. I thashë, se do të diskutoja diçka me shoqen time... Ai ka filluar të

më ngacmojë shpesh, se çoç ka nuhatur... Pas mësimit, si për ditë kohët e fundit, Eri vrapoi për diku. Ai ka ndryshuar shumë. Në mësimet vjen për të ardhur, po ka rënë pothuaj në të gjitha lëndët... Mësuese Vjollca i foli një ditë, ashtu butë, si me pambuk, siç di ajo... Ai vetëm sa buzëqeshi dhe i dha fjalën, se shpejt do të përmirësohej... As shaka nuk bën më, si dikur... Para ka më shumë në duar dhe shokët kanë filluar të flasin... Ndonjëri edhe ka hedhur ndonjë dyshim. Po ajo që të bie në sy është, se shpesh kotet në orë të mësimit...

Këto po i thoja Shejlës, pasi bëmë hapat e para. Ajo kish ulur kokën e nuk më kthente përgjigje. E dija, se asaj nuk i vinte mirë për këtë.. Edhe bufi e di, se Eri për Shejlën është i veçantë... Po mbase e do si vëlla, ngaqë edhe janë rritur bashkë... Sa për atë Sonin, që mbahet me të madh, mua më duket se Edri, ia këputi kot, kur më tha, se i ka rregulluar pipat dhe se së shpejti gjithçka do të marrë fund... Ju e dini që Edrin e kam kushëri të largët dhe është një ndër ata të Garipave... Ai bënte be e rrufe, se i kishte parë një ditë bashkë në lulishte... Ec, e merri vesh këto punë!

Nejse, se u shpërndava kot. Pasi më dëgjoi e më dëgjoi, më tha:

- Redi, a di të mbash fjalën?

Se si më erdhi! Ku donte të dilte?

- Shpirtin të më marrin, nuk nxjerr gjë!

Mustafa Tukaj

- *Shiko, për kokën e babit, nuk të flas me gojë për tërë jetën, po doli gjë prej teje...*

- *Ti Shejla, nuk më paske njohur mirë, që flet kështu...*

- *E mirë pra... - Dhe më tregoi fill e për pe për Erin. Më erdhi vërtetë keq për të dhe u ndjeva disi fajtor, të paktën, pse nga fjalët e ndonjërit, kisha filluar të mendoja ndryshe...*

- *A të flas një herë me babin? - e pyeta dhe në çast e ndjeva, se kisha goditur në shenjë. Pata përshtypjen, se veç i kisha dhënë zë mendimit të saj të heshtur, kur pashë, se si i shndriti fytyra.*

Ajo tundi kokën dhe më puthi në faqe. Sigurisht që mu drodh trupi, se më erdhi papritur, po unë do të kisha dashur, që kjo të vinte për të tjera motive dhe të ishte ndryshe... Gjithsesi jo këdo mund të puthte Shejla!

Mbrëmë nuk i thashë gjë babait për të. Ai hyri në dhomën time, se erdhi ca më herët. Thashë të gjeja një çast tjetër më të mirë, se kishim ca netë që i rrinim ftohtë njeri tjetrit... Shkaku ishin ca fjalë të mia me mamanë, pse u ankova, se ata të dy, domethënë ajo dhe babai, ende më mendonin për kalama dhe më trajtonin si të tillë... Në këto fjalë e sipër na gjeti babai, i cili, edhe pse çmendej pas meje e s'ma prishte në asgjë, se ç'kishte një lloj frike të më jepte edhe ca pavarësi më shumë... Atij nuk i erdhi mirë, që unë edhe atë e kundërshtova, gjë që s'kishte ndodhur ndonjëherë

më parë...Mbase, ai kishte ardhur i nevrikosur në shtëpi, kushedi pse, por, me sa duket i erdhi e papritur dhe u ndez i tëri...E dija, se ishte ca gjaknxehtë, po jo aq sa të më gjuante me një breshëri fjalësh si: “djalë i keq”, “e kam fajin unë që të kam llastuar” “mosmirënjohës”, “e kam “shiko ç’parajsë të kam krijuar, ku nuk të mungon asgjë”, etj,etj...

Çdo natë e ndjeja, kur vinte, po bëja sikur flija... Në mëngjes, sigurisht që i përgjigjesha pyetjeve të tij, po disi ftohtë. Megjithatë kjo revoltë e imja, sikur i dha rezultatet e para, se dje, kur i thashë shoferit, se doja të shkoja në këmbë, nuk më kundërshtoi si herë të tjera...

Paqa u vendos në mes nesh, kështu shpejt do të flas me të...

SONI MERR NJË E_MAIL TË ÇUDITSHËM...

S

oni ndezi kompjuterin. Pothuajse çdo ditë në të njëjtën orë të mbrëmjes, si me ritual, pasi kryente mësimet, zhytej në kompjuter, kontrollonte postën elektronike, herë kërkonte diçka në internet, po më të shumtën e rasteve hynte në *facebook*, a në *chat* dhe lidhej me miqtë e tij të njohur a të panjohur, ku shumica ishin simpatizantë të tij, kryesisht vajza...

Edhe këtë herë ia nisi sipas rradhës, hapi adresën e tij dhe filloi të lexojë Email-et. Katër. Tre ishin të njohur. Sigurisht njëra prej tyre duhej të ishte Vali, një vajzë nga Rrogozhina, që i shkruante gati për ditë...I kishte rënë keq në kokë së shkretës dhe madje i shkruante edhe ca poezi melankolike, që të kujtonin keqeshkronjën e

Zhuljetës... Po bëhej java, që ai nuk i kthente përgjigje, por ajo me durim e pa u lëkundur bënte të sajën... E katërta ishte një adresë e panjohur Iz_angel@hotmail.com. Nisi ta lexojë për kureshtje.

Soni,

Nuk dua të veprosh menjëherë, me të lexuar këto rrjeshta, përkundrazi, të mendohesh mirë, para se të hedhësh këtë hap. Unë nuk kam ngut.

Deri tani kam qenë e vendosur të mos i përgjigjem kërkesave të tua të shpeshta, edhe për një arsye të thjeshtë, se kurrë nuk kam besuar në sinqeritetin e tyre... Kështu që kam vendosur t'i vë në provë. Një herë dhe vetëm një herë! Nuk ka provë të dytë. Dhe mos kujto, se mund të quhet një provë e rëndë... Gjithësesi, ajo do të më lëkundë ca në mendimet e mia për ty dhe mund të shërbejë si bazë e re për marrëdhënet tona. Në se nuk e realizon, nuk shembet Roma, po thjesht do të më bindë, se nuk paskam qenë e gabuar në vlerësimin tim për ty.

Që të mos e zgjas, ajo që kërkoj unë prej teje është: **të qethësh kokën zero!** Të vjen për të qeshur me kërkesën time? Hiç mos qesh! Të thashë, se nuk është ndonjë provë e rëndë, se njerëzit i qethin për qejf, apo, siç thonë, për tu dukur më seksi. Por në se bëhet tani, për mua

Mustafa Tukaj

është diçka domethënëse dhe do ta quaj një sakrificë nga ana jote, meqenëse e di, sa merak i ke flokët dhe sa kujdes tregon për ta...

Qaq kërkoj prej teje. Pas kësaj do të vijë takimi ynë i parë dhe vendin do ta caktoj unë... Deri në takimin tonë do të komunikohet vetëm me E_mail.

Afati i fundit për kryerjen e kurbanit, do të jetë një *party* në shtëpinë e një shoqeje të përbashkët.

Asnjë tentativë për të më ndaluar rrugës!

Asnjë pyetje a kërkesë për sqarim!

Asnjë ngacmim nga Grupi i Garipave!

Adresa me të cilën shkrova këto rrjeshta, kuptohet, është e sajuar. Nuk është adresa ime e përherëshme dhe këtë e di vetëm ti.

Bëfsh atë, që ti mendon, se është më e mira!

Ajo.

Për një farë kohe i mbeti si e ngrirë në buzë një buzëqeshje e lehtë, po pastaj iu kujtua, se para pak ditësh, ai po i priste të dilnin nga ëmbëltoja afër kthesës së semaforit të parë, kur i kapi veshi, që ajo iu tha dy shoqëruesve të saj, Erit e Redit, se i pëlqenin shumë tullacët... Të ishte rastësi, apo thjeshtë një parapërgatitje për atë që do të shkruante në këtë e-mail? Ai nuk e dinte, se si ishte zhvilluar më parë biseda aty brenda në

ëmbëltore, ashtu siç nuk e dinte, se kishte qenë pikërisht Eri, ai që e kishte hapur këtë bisedë në dalje e sipër. Ai kishte përmendur të atin e Redit, që i kishte flokët e qethur zero dhe Shejla rastësisht apo kastile, apo e shtyrë nga një e shkelur e syrit e Erit, kishte thënë atë fjalë.

Sonit iu bë sikur po i kruhej koka. U ngrit dhe shkoi te pasqyra. Flokët e tij kafe të çelur, të qethur *alla Berkham*, lyer me llaqet më të mira, për të marrë formën e duhur, po i dukeshin edhe më të bukur sonte dhe shumë më të dashur. U futi gishtat dhe u ra me dorë lehtë, si për t'i ledhatuar dhe për një çast nisi të përfytyrojë, se si mund të dukej me kokë të qethur e si do ta prisnin këtë të njohurit e tij të shumtë...Jo, nuk ishte gjë që bëhej!

Të nesërmen doli më heret se zakonisht nga shtëpia dhe zuri pritë. Donte të maste pulsën e Shejlës, megjithëse ajo e paralajmëronte për të mos e ndaluar më në rrugë. E priti në cep dhe nuk i tha asnjë fjalë, kur i kaloi pranë, ndërsa ajo i dha edhe ca trupit të saj të zhdërvjelltë duke shkundur flokët e derdhur si krifë kali dhe bëri sikur nuk e pa. Ai e shoqëroi nga larg, duke vrarë mendjen, se çdo të bënte ajo me flokët e saj, po të ishte në pozitën e tij. Pastaj e dalloi, që ajo u bashkua me shokët e saj të klasës në oborr, në mes të të cilëve edhe dy rojet e saj personalë... Njërit ia kishin ndrequr samarin paq, që të mos kruhej më me ta, sa për atë tjetrin, bufin, Zari i kishte thënë, se edhe

Mustafa Tukaj

atij do t'ia zbuste shpinën ndonjë ditë, se sikur qe bërë shumë i zellshëm kohët e fundit...Soni nuk e kishte lënë, se nuk donte sherr. Jo, se i ati ish bërë deputet, për këtë as që pyeste, po thjesht, se tashmë ish lidhur me Shegushën, tek e cila, as vetë nuk e dinte, pse kishte aq shumë besim... Po sikur ta pyeste njëherë, për punën e e-mailit? Jo, jo, nuk kishte pse... Le t'i bëhej dhëmbi sa i elefantit, nuk do t'ia plotësonte atë tekë... Na vërka edhe afat, pale!...

- Hë, Soni, ç'paske humbur kështu? - e ngacmoi Giri, që edhe pse më i vogli ndër shokë, ishte më i idhti në fjalë.

- Mos harro, se po presim atë qerasjen e famshme te "Katër Stinët"...

- Ç'më çan kokën!

- E kam me gjithë mend, se kështu e patëm fjalën! Ti the dy javë, ne të pritëm dy muaj!

- Do para borxh? Sa të duhen, që t'a vemë kapakun kësaj meseleje me "kullën binjake"- u fut në lojë Edri.

- Kur u bëre edhe ti!- u përmbajt Soni, që s'diti ç'të thoshte.

IRINI PRET MIQTË..

N

ë këtë çaste, jo shumë larg prej tyre, “kulla binjake”, domethënë Shejla, po i thoshte Erit:

- Më vjen keq, po s’erdhe në mbrëmjen e Enxhit!

- Edhe po të vij, nuk kam partnere...

- Thuaji Nimfës..

Mustafa Tukaj

- Nimfa do të vijë me futbollistin...

- Pyete Tidën, se mos është e lirë...

- Tida ia ka dhënë fjalën Arlindit..

- Po Besa?

- Bombones...

- Po gjeje një...

- Edhe mund ta gjej, po kam frikë, se ju sfidon ju të gjithave...

- E kush na qenka kjo?

- Mësuese Irini...

Të gjithë ia plasën gazit.

- Ik, shko ndërro çorapët, budalla, se i ke veshur mbrapsht! - i tha Shejla lehtë në vesh.

Te banka e tyre afrua Enxhi.

- Pse qeshët?

- Se kjo Shejla, është budallaqe fare... I është fiksuar për tullacë!

- Vërtet, Shejla?

- Po, vërtet! - u fut edhe ajo në lojë.

Kushedi sa do të kishte vluar debati, sikur të mos hynte në klasë mësuesja e anglishtes, që i përshëndeti me një “good morning!” dhe u ul në tavolinë. Të gjithë shikuan njëri - tjetrin, deri sa Visari tha:

- Mësuese, nuk kemi anglisht tani...Kemi histori.

- E di, po mësuese Irini ishte e zënë.

Pse ç’kishte nëndrejtoresha? Ajo dukej shend e verë në mëngjes. E para erdhi në shkollë,

si për ditë në krye të situatës u mor me rreshtimin e nxënësve dhe shpërndarjen e tyre nëpër klasa, pastaj me një ton autoritar lëvizi nëpër korridore, sa të vendosej qetësia e mësimit të vazhdonte normalisht. Pastaj u ndrye në drejtori dhe hapi mbi tavolinë mëngjesin e saj të bollshëm e zuri të mllaçitet për shtatë palë qejfe. Pastaj fshiu buzët me pecetë të lagësht, nxori nga çanta e saj një flakon me spruc dhe shfryu dy herë në gojën e saj të madhe për t'i dhënë aromë të mirë, si të lyente me pompë një guvë, u dha një të lyer buzëve, shkyçi derën e thirri Niqin, pastruesen, t'i bënte kafënë...Kishte ditë që ajo pikë pikë, si të zbatonte një plan strategjik, vepronte kështu. Kohët e fundit, sikur kishte marrë një hije edhe më të rëndë, sepse dikush, për të mos thënë ajo, kishte mbushur dhenë me fjalët, se emërimi i saj si drejtoreshë e shkollës, ishte çështje ditësh... Madje Niqi kështu kishte nisur ta thërriste...

Niqi i solli kafënë dhe doli, por, sapo Irini kishte surbuar hurdhin e parë të kafesë, kur dera trokiti shpejt dhe Niqi, pa pritur t'i thonin hyr, hapi derën e futi kokën:

- Më fal, drejtoreshë, ka ardhur ai...
- Kush, moj Niqi, se më trembe?
- Ai i arsimit...
- Kush, moj, Sokoli, kryeinspektori?
- Po, ai, dora vetë...Bashkë me një tjetër...

Mustafa Tukaj

Irinit i kërceu zemra në kraharor dhe një i kuq ngjyrë alli i veshi fytyrën, kurse sytë i shëndritën prush.

- Ulu shpejt poshtë dhe silli në drejtori! - tha ajo dhe ktheu njëherësh kafënë, sa desh u mbyt...

Filxhanin e futi në sirtar. Kafeja të forcon...Pas kaq kohësh pritje, nuk do ta kishte lehtë të përballonte emocionet e sihariqit.

U përpoq të ruante qetësinë dhe vuri mbi tavolinë një fletë të bardhë si çarçaf me emra e shifra dhe pozoi mbi tabelën përmbledhëse të mungesave, thua se studionte planin e sulmit të nesërmen në agim...

Trokitën në derë.

- Hyr! - tha ajo me një zë të qetë po autoritar, që e kishte parapërgatitur për një çast të tillë.

Në drejtori hyri kryeinspektor Sokoli dhe një një burrë tjetër që nuk i kishte të dyzetat, shtatlartë e flokë gështenjë të çelur.

Irini u ngrit, u doli para dhe u priu në këndin me kolltuqe te drejtorisë, që ishte në të djathtë. Zunë vend. Ajo shkoi tek një minibar në cep dhe nxorri që andej dy gota..

- Konjak “Skenderbeg”? Nuk besoj, se do të na quhet shkelje...

- Po ti ç’do të pish, Irini? - e pyeti Sokoli.

- Ja, po ju shoqëroj me një gotë “ Fanta ”.

- E, po mirë...Ta ngremë tani, apo të themi arsyen, pse kemi ardhur?...

- Ju, si të doni, qoftë për të mirë, pa...

- Ne për mirë kemi menduar. Atëherë, nuk po zgjatemi, se edhe pak do të jetë pushimi i madh dhe duhet të mbledhim mësuesit. Me ju po e konsumojmë tani...

Zemra e Iritit i ndezi të katër motorrët.

- Po bëhen dy muaj që ju keni drejtuar këtë shkollë. Ne ju falenderojmë për këtë!

- Kam bërë vetëm detyrën, zoti Sokol!

- Ju ka takuar të lodheni ca, se kjo është një shkollë e madhe e me mjaft probleme... Po tani e tutje do ta keni më të lehtë, se kemi emëruar zotin Basri, si drejtor të shkollës...

Ai vuri buzën në gaz dhe i tundi kokën, po ajo, se ku kishte humbur, se as tha asnjë fjalë, as i ktheu buzëqeshjen, veç u ndez e u bë flakë si eshkë, gjë që i habiti të dy, madje Basriu u ngrit të kërkonte pak ujë, se fytyra e saj përnjëherësh ndrroi ngjyrë, duke të kujtuar një limon të papjekur mirë...

Lajme të shkurtra:

Khaxhai i Enxhit i dha asaj përfundimisht leje, që të bënte në hollin e shtëpisë mbrëmjen e saj. I dha këshillat e duhura.

Mustafa Tukaj

Megjithëse marrëdhëniet janë përmirësuar ndjeshëm, Enxhi nuk e bindi dot Shejlën të flinte atë natë në shtëpinë e saj.

Kandidate e mundshme Nimfa.

Kjo e fundit e priti me shumë qejf propozimin e Enxhit, po duhej t'i mbushte mendjen mamasë, që ta lejonte, sigurisht, pasi të dëgjonte prej saj një qerre me këshilla.

Zari ndjehet në qiell të shtatë, se ka siguruar gjithçka që duhet...

Enxhi, që ka porosi të veçantë nga Zari ta informojë për çdo gjë, që ndodh a bisedohet në klasë, i tregoi edhe për fiksimin e Shejlës për tullacët... Ai nuk e vlerësoi këtë të dhënë, po kur ia tha Sonit, këtij të fundit iu ngritën qimet përpjetë...

Eri i solli Shejlës dy simite me ullinj nga të furrës.

I hëngri si e babëzitur, kaq shumë i pëlqyen.

Arlindi bëri gati punimet për ekspozitën e tij në fund të muajit.

Enxhit i gjetën një krem të posaçëm për puçrrat e saj. Pritet efekt i menjëhershëm.

Babai i Erit, që fliste shumë rrallë në telefon, ruhej nga policia e atjeshme...

Ai ishte pa dokumente të rregullta, ndërsa andej kishte nisur një “ gjuajtje ” emigrantësh, që quhej “ Fshesa ”.

Redi e gjeti rastin të fliste me të atin për Erin.

Rivalët

I ati nuk dha ndonjë shpresë, po as kundërshtoi. Veç kruajti kokën.

MBRËMJA E SHUMËPRITUR

E

shtuna e shumëpritur më në fund erdhi. Një nga një e dy nga dy ata u mblodhën në shtëpinë e Enxhit, apo më saktë, në shtëpinë e xhaxhait të Enxhit, jo shumë larg qendrës, në një vilë jo fort të madhe dykatëshe, por me një arkitekturë të bukur e me një oborr plot palma e kaktuse, që, po të mos e dije se ku ndodheshe, menjëherë mund të të shkonte mendja në ndonjë vend ekzotik të ndonjë ishulli të largët...

I pari që mbërriti ishte Zari. Kishte lyer flokët me llak e brilantinë dhe që spërkatur me parfum të bollshëm, sa njerëzit rrugës kthenin kokën e vrisnin mendjen, se mos ai sapo kishte dalë nga ndonjë kazan i stërmadh levandoje dhe ashtu i lagur siç ishte, edhe mund të ftohej, i gjori, nga ajo ere e freskët nëntori... I furnizuar me të gjitha sendet e duhura për ta t'ia pirë lëngun mirë kësaj mbrëmjeje, pasi kishte pritur plot një çerek ore te kryqëzimi për Sonin, nuk i qe duruar më dhe ishte nisur i vetëm drejt shtëpisë... Atje e priste e dashura e tij, me të cilën do të kishte edhe një pasmbrëmje të paharrueshme...Kishte pritur

shumë për një ditë tillë...Në fakt, edhe pse u ishte mburrur shokëve aq shumë për bëmat e tij me vajza të ndryshme, sot do të shënohej në kalendarin e jetës së tij si hera e parë drejt burrërisë...

Derën ia hapi Nimfa, që kishte mbërritur ca më heret për t'i ndihmuar Enxhit, për të shtruar *coctail-n* në hollin e madh. Zari, si të ishte i shtëpisë, vetëm sa e përshëndeti Nimfën dhe hyri drejt e në holl, ku, si e puthi Enxhin në faqe, i vari në qafë një varëse, ku kishte germën E, u ndihu për vendosjen e tavolinave, që shpejt u mbushën plot e përplot me të gjitha të mirat: Biskota, kekë të vegjël, amareta, bombona, trigonë pastra, banane, mollë, rrush, arrë kokosi, lloj lloj pijesh të buta, e ç'të të donte zemra tjetër, që ajo i kishte porositur me kohë...

Në cep të hollit të binte në sy një kompakt disk i stërmadh dhe dy autoparlante, që vetëm prisnin çastin të buçisnin e të përhapnin rreth e përçark muzikën e tyre të preferuar, të rëndë, ritmike, eksituese.

Enxhi shndriste e tëra. Kishte veshur një minifund jeans shumë të shtrenjtë D & G, një palë streçe të zeza, që i nxirrnin në pah këmbët e saj të drejta, edhe pse pak të shëndosha, të cilat, kushedi si kishin arritur të futeshin në një palë çizme të ngushta, plot rrudha e shkëlqim, të gjata deri në gju. Sipër të binte në sy një xhaketë e zezë prej

Mustafa Tukaj

lëkure të hollë dhe veçanërisht një bluzë e hapur e bardhë, që goxha bukur nxirrte në pah gjoksin e saj vashëror... Nga veshët vareshin një palë të vathë të gjatë platini e me gurë të çmuar. Kaq ishin të dukshmet. Të padukshmet, apo siç thuhet rëndom, të brëndëshmet, ishin po të shtrenjta, nga të firmës Calvin...

Të ftuarit erdhën njeri pas tjetrit. Sejcili i dha dhuratën e përgatitur më parë. Dikush i kishte sjellë një album, një tjetër çantë lëkure, vathë, MP4, byzylyk, parfum etj.

Tida dhe Arlindi. Tida kishte veshur një fustan të shkurtër ngjyrë rozë, të hapur mbrapa, një bluzë të bardhë shumë të shkurtër, shtrenguar pas trupit, geta ngjyrë mishi dhe këpucë të zeza e me takë të lartë...Arlindi mbante në dorë një një peizazh, të pikturuar enkas për Enxhin.

Besa dhe Bombonja, ende i skuqur nga halli, se për herë të parë në jetën e tij, kishte bërë fjalë me të atin. E gjitha kjo, pse ai sot kishte kërkuar më shumë para xhepi...

Shejla dhe Redi. Shejla kishte bërë një tualet të lehtë, që mezi dallohej dhe kishte veshur një palë pantallona të ngushta e xhakëtë jeans dhe një bluzë të hollë rozë të çelët, ndërsa Redi pantallona të zeza, këmishë me kuadrate të vogla dhe triko ngjyrë të gjelbërt të ndezur, të gjitha kombinim Armani, blerë enkas për këtë mbremje në një dyqan të shtrenjtë pranë teatrit dramatik të qytetit.

Kjo ishte një pasdreke e rrallë për të.. I kishte thënë shoferit ta linte pranë semaforit, para rrugicës që të çonte tek Shejla dhe, si i kishte rënë ziles së portës së jashtme, kishte pritur Shejlën të dalë pa u ngutur dhe vetëm për vetëm me të kishte përshkuar gjithë atë rrugë deri te shtëpia e xhaxhait të Enxhit... Hijerëndë, e gjasme i shkujdesur, u përpoq të hapte tema nga më të ndryshmet, duke hedhur me kujdes majtas e djathtas shikimet e tij të shpejta. Kishte shpresë, se në mes të kalimtarëve të shumtë do të shihte të njohur, të cilët, sigurisht, edhe do t'i përshëndeste dhe ata pa dyshim, që do të mendonin a thonin njëri tjetrit “ Ore, ju rrit djali Bim Zallit! Shikoni, shikoni kë paska në krah! ”

Ishin mbledhur pothuajse të gjithë. Të gjithëve u kishte rënë një nur i veçantë... Dukeshim më të rritur..

Mungonte një që pritej e një që s'pritej. I pari ishte Eri, i dyti Soni.

U dëgjua muzika dhe mbrëmja filloi...

Zari po habitej, pse nuk kishte ardhur Soni. Ai i kishte thënë dje, se do t'i kërkonte leje trajnerit e do të vinte patjetër... Ky ishte një rast, që s'të jepej shpesh... Punë për të! Unë e kam në rregull sonte...Shiko si më është bërë Enxhi, si kukull!

Nëntëmbëdhjetë të ftuarit në fillim futën nga një diçka në gojë dhe nuk vonoi shumë e mbrëmja

Mustafa Tukaj

u ndez. Filluan të kërcenin, të hanin, të pinin. Shtëpia gjëmoi nga ritmi i muzikës dhe zërat gazmorë të tyre.

*** **

Para një farmacie, diku në një cep të qytetit, nga një biçikletë e vjetër zbriti Eri. La biçikletën përjashta dhe se ç' bisedoi me farmacisten, një mesogrua e thatë si eshkë. Ai i paraqiti asaj recetën, për të cilën kishte dy ditë që kujdesej ta siguronte, pagoi dhe mori ilaçin. Kur po dilte, u ndal edhe një herë dhe e pyeti:

- Më falni, që po ju pyes edhe një herë, a vepron shpejt ilaçi, se gjyshi është shumë keq?!

- Rri pa merak, djalosh, vepron shumë shpejt dhe shumë shpesh...

- Të faleminderit! - tha ai serioz dhe, si i hipi biçikletës, i grahu drejt daljes së qytetit.

Dhjetë minuta larg nga stacioni i fundit i autobusit, që edhe shënonte fillimin e rrethinave të qytetit, u shfaqen varrezat e vjetra, ku s'kishte mbetur as edhe një pëllëmbë tokë për varre të reja. Kishte nisur të errësohej dhe në varrezë mbretëronte një heshtje varri...Nuk u fut nga hyrja ballore, po mori majtas dhe, si la biçikletën të mbështetur për një mur ende jo të shembur plotësisht, eci ngadalë e duke u fshehur pas

varreve të ndryshme, në më të shumtën të mbuluara nga bari, deri sa e dalloi mirë që larg atë që kërkonte, një siluetë që priste në këmbë pranë selvisë së tretë nga e majta... U afrua ngadalë e pa rënë në sy, që të sigurohej dhe, si u bind se gjithçka shkonte sipas planit të tij, u kthye mbrapsht... Aty ku ishte mbeti silueta e atij njeriu, që meqë kishte filluar të ndjente ftohtë, kishte vënë në kokë një kapuç, gjë që e bënte edhe më frikshëm e mund ta merrje për një fantazmë, po të mos e dije, se kush ishte...

Eri dha me të shpejtë këmbëve dhe biçikleta, edhe pse e vjetër, fluturoi...

*** **

...Në shtëpinë e Hagit rrëshqitën pa u ndjerë plot tridhjetë minuta, nën zërat gazmorë, tek - tuk edhe nën ndikimin e ndonjë pije të fshehtë, që nisi të dalë nga nëntavolina...

Ra zilja. Soni, mendoi Nimfa që vrapoi të hapte derën.

Ishte Eri.

- Ka mbetur ndonjë “ damë” e lirë për mua?
Ti, Nimfa e lirë je?

- Jo..po..si të them.. - u ngatërrua Nimfa pa ditur ç’ të thotë..

- Mos u mundo shumë, po eja të vallzojmë! - dhe pa pritur që ajo të pranonte a të kundërshtonte,

Mustafa Tukaj

e kapi për dore e bashkë me të u fut në grumbullin e të tjerëve, që hidheshin e përdridheshin nën ritmin e muzikës.

Shejlës i shndriti fytyra, kur e pa. Eri i shkeli syrin dhe vuri buzën në gaz, si për t'i kujtuar, se proçkat e tij ende s'kishin mbaruar. Pastaj u afrua pranë tavolinës, piu një gllënjë Cola dhe futi në gojë një amaretë të shijshme... Pastaj u kthye të përshëndesë Enxhin dhe ndeshi gotën me të...

Zari, i ndezur i tëri, i hodhi një herë sytë vëngër nga cepi ku rrinte dhe ktheu gotën e tij të mbushur me *Tekila*. Pastaj pa ndroje nga të tjerët nisi të dridhte me gishtërinj një si cigare, që nuk mundi të mos tërhiqte vëmendjen e të tjerëve...

Enxhi u afrua si rastësisht dhe i pëshpëriti:

- Duro pak, ka kohë për atë!...

- Po e lë gati! - tha ai dhe e uli pranë gotës së tij mbushur me *tekila*. Pastaj u bashkua me të tjerët dhe nisi të hidhte këmbët sipas ritmit, por jo një herë ata nuk iu bindën krejtësisht, nën ndikimin e alkoolit, që kish nisur të vepronte në organizmin e tij...

*** **

...Ndërkaq në varrezat e vjetra të qytetit kishte rënë plotësisht errësira... Një dritë e varur në një shtyllë gati në rënje tundej nga një erë e lehtë po e freskët dhe hijet e pemëve krijonin

figura shpesh herë të frikshme... Megjithatë silueta vazhdonte të qëndronte pa lëvizur i përqëndruar i tëri pas çdo zhurme qoftë edhe të lehtë, që edhe mund të shkaktohej rastësisht nga një hardhucë a një tjetër zvarranik, apo nga ndonjë copë teneqe, që tërhiqej zvarrë a përplasej pas ndonjë rrase varri...Pas çdo lëvizje, që shpesh i drithëronte trupin, ai fshihte shpresën, se ja, më në fund, erdhi ajo që priste prej më se dy orësh...

Ishte Soni.

Po ç'kërkonte i ngrati, në një vend të tillë, aspak romantik e në një orë të tillë aspak të përshtatshme, kur shokët e tij hargaliseshin e djersinin nga hareja, vallet e këngët e panumurta?

Priste Shejlën.

Mbrëmë në darkë kishte marrë një tjetër E-mail nga Iz_angel@hotmail.com ku thuhej:

Soni,

Meqenëse nesër mbaron afati për të plotësuar kushtin tim, po të them që në se dëshiron të më takosh, eja nesër në të ngrysur tek varrezat e vjetra të qytetit dhe më prit tek selvia e tretë majtas... Mos më pyet, pse pikërisht zgjodha këtë vend e jo një tjetër.. Sigurisht që e kam një arsye... Më prit edhe po u vonova ca, se nuk e kam krejtësisht veten në dorë...Mos harro kushtin!

Ajo

Mustafa Tukaj

U afrua pak pranë dritës që tundej në shtyllë dhe pa orën... Po bëheshin plot dy orë që ai rrinte aty si hu gardhi... Vërtet të qe tallur kaq shumë?

*** **

...Mbrëmja po arrinte kulmin. Këndonin, kërcenin, thërrisnin nën ritmin e muzikës *rock, rap a house*, aq sa po u çirreshin zërat...Vërtet ishte një mbrëmje e rrallë!Të lumtë Enxhi, se na kënaqe!

Ndërsa Zari përjargej me Enxhin pranë e vriste mendje edhe sa kishte mbetur nga çasti i shumëpritur, Eri rrëshqiti si rastësisht tek vendi i Zarit dhe, si nxorri me kujdes flakonin që kishte blerë në farmaci për “gjyshin”, e zbrazti pa iu dridhur dora në gotën e Zarit gjysëm të mbushur me *tekila*. Pastaj u bashkua me të tjerët dhe nisi edhe ai të bërtasë e të çirret si të gjithë ata...

Muzika pushoi dhe ata u shpërndanë në vendet e tyre. Eri po i thoshte diçka pa rëndësi Ermalit, po mendjen në të vërtetë e kishte në cepin tjetër, ku Zari mori gotën dhe e ngriti si të pinte një gotë ujë...

- Hë, të bëftë mirë!- uroi me gjithë shpirt Eri dhe iu afrua Shejlës për ta ngacmuar për diçka...

Ra zilja. Enxhi shkoi ta hapë.

- Ua!- thirri ajo duke tërhequr vëmendjen e të gjithëve - Po, ti ç'ke bërë kështu?!

Ishte Soni i skuqur i tëri deri në veshë nga inati, që, si hoqi nga koka kapuçin, e flaku lart në tavan...

Një kokë e qethur zero u shfaq nën shkëlqimin e llampadarëve të kushtueshëm...Me të parë Shejlën, që ia krisi gazit, ai u mat t'i sulej, po shpejt u përmbajt, veç u afrua ngadalë pa ia ndarë sytë, që ende i xixëllinin nga tërbimi, a thua se do ta përpinte të tërën.

Instinktivisht pranë saj u afrua Eri dhe Redi. Zari, edhe ai i habitur për shokun e tij e pa kuptuar asgjë, e thirri në këndin e tij, i mbushi një gotë me tekila dhe i ra lehtë në sup, si për t'i kujtuar, se edhe pak i ndante nga pasmbremja e shumëpritur...

Filloi muzika. Pa bërë të gjatë Soni nxitoi drejt Shejlës dhe e ftoi në vallëzim. Ajo iu afrua duke mos ia ndarë sytë kokës së tij si saç televizori...

Soni, në inatin ende të pashuar mirë, i tha me një ton disi jo fort të këndshëm:

- Unë i plotësova të dy kushtet! Mos ke ndonjë tjetër tani?

- Kushtet? Cilat kushte? Më shkrive fare!

- Çfarë duhet tjetër, për të mos u tallur më? Mos duhet një Email i tretë?

- E_mail?! Qenke i lezetshëm ti!

- Po Iz_angel...

- Ke ngatërruar adresë, djalo...Kërce tani, se për këtë kemi ardhur! - tha ajo dhe nisi të kërcejë,

Mustafa Tukaj

ndërsa në buzë i mbeti gjurma e një buzëqeshje të lehtë, që nuk iu shua deri në fund të kërcimit. Ndërsa Soni vriste mendjen, a kishte humbur a fituar me këtë veprim të tij, për të cilin gjithmonë kishte dyshuar, por që nga ana tjetër, s'kishte mundur t'i bënte ballë tundimit, për të mos e plotësuar...

Deri në fund të mbrëmjes, edhe pse u mundua ta harronte pozitën në të cilën e kishin vënë, mendja i mbeti po në një vend: në mos Shejla, dikush tjetër ishte tallur paq me të...Po kush?

Jo shumë metra larg tij Eri nxori një letër format, shkroi në të fjalën “ FERNAND ”, i ra kryq, siç kishte bërë ditë më parë me emrin “DANGLAR”, pastaj e bëri copë e grimë dhe, si mori frymë thellë e hodhi në koshin e plehrave dhe u kthye në sallë...

...Nën zhurmën e muzikës, aty këtu në holl filluan të ndjeheshin zile celulari... Ndonjë prind i merakosur pyeste edhe sa do të vazhdonte mbrëmja... Ata, sigurisht, do të donin të zgjatej pambarimisht kjo mbrëmje e rrallë, po ora e madhe në mur ra plot dhjetë herë, si për t'u kujtuar të shfrytëzonin çdo sekondë që kishte mbetur, para se të shpërndareshin nepër shtëpi...

Zari po vallëzonte me Enxhin dhe hidhte herë pas here sytë nepër shkallët që të ngrinin në

katin e dytë, ku edhe pritej nga çasti në çast, si të largoheshin të tjerët, të vazhdonte pjesa tjetër e natës, me gjithçka të parashikuar në të... Ai nuk po e kuptonte, pse Soni kishte vonuar aq shumë në mbrëmje, pse rrinte turivrenjtur, si t'i kishin humbur dhitë në pyll dhe pse, tek e fundit i kishte qethur flokët ashtu alla top llastiku... Dy tri herë i kishte përmendur katin e dytë me dhomat e mobiluara luks, po ai i kishte thënë, se nuk kishte ndërmend të rrinte, sepse e prisnin ca miq në shtëpi... I hidhte këmbët pa e vrarë shumë mendjen për ritmin e muzikës dhe mendonte se, meqë Soni do të ikte, si do ta mënjanonte edhe Nimfën, kur...

Ndjeu një prerje të lehtë në bark dhe zorrët që gurgullitën fort, sa e bëri Arlindin që kërcente pranë të kthente kokën... E parandjeu se ç'mund të ndodhte dhe duke u shtërnguar që të mos koritej në mes të të gjithëve, e pyeti Hagin me të shpejtë:

- Ku është banjoja?

Ajo i bëri me kokë. Ai u mat të sulej andej, po e ndali turrin, shtrembëroi trupin e mblodhi muskujt e duke ecur me kujdes, mezi arriti të hapë derën e banjos... Bëri të zbërthehej, po nuk arriti... Për pak, për një a dy hapa!... I skuqur i tëri i flaku të mbathurat e u përpoq të pastrohej si të mundte... Dhe kur mendoi se, pantallonat i kishin shpëtuar për një qime, u mat të dilte nga banjoja, sikur s'kishte ndodhur asgjë dhe t'i afrohej qoshes së tij,

nën vështrimet tallëse të disave që e kishin kuptuar, pse Zari qe larguar ashtu nga vallzimi. Ai u përpoq të dukej indiferent, madje bëri t'u hidhte atyre rreth e rrotull një vështrim krenar, kur zorrët, për tmerrin e tij krakëllitën përsëri dhe ai u sul drejt banjos pa pyetur për gazin, që shpërtheu tek të pranishmit. Nuk doli gjatë nga banja... Me sa duket, ilaçi për “gjyshin” kishte qenë shumë cilësor dhe po vepronte shpesh... Nuk i tha askujt asgjë, veç u mënjanua majtas, i bëri me shenjë Sonit ta ndiqte dhe, kur dolën jashtë i tha:

- Më jep biçikletën, se jam keq... Do të shkoj të ndërrohem!...

Soni nuk i tha atë që mendoj në çast, se do t'ia bënte pis biçikletën, po i zgjati çelësin. Zari kërceu mbi biçikletë dhe u sul, duke lënë pas një erë të keqe...

Brenda kishin plasur qyfyret...Enxhit një fytyrë i vinte e një fytyrë i shkonte... As ajo nuk do të donte pas asaj që ndodhi, që Zari të kthehej. Megjithatë, kur Nimfën e rrejti gjumi, ajo e priti zgjuar, po ai nuk u bë i gjallë...

Shakatë e romuzet vazhduan edhe në rrugë... Zari dhe zorrët e tij, ishin në qendër të qeshurave për një kohë të gjatë, duke marrë edhe vlerësimin si kulmi i mbrëmjes...Qeshnin me të gjithë bulçinj të dhe lot u delnin nga sytë, kur ndonjeri imitonte Zarin tek sulej drejt banjos... Dikush i vuri edhe një epitet, sigurisht që kishte

lidhje me atë ç'kishte ndodhur dhe që e pëlqyen të gjithë, i cili vazhdon ta ndjekë pas edhe tani...

Përrjashta priste makina e babait të Redit. Në të hypën Shejla, Tida, Redi dhe Eri. I përcollën vajzat në shtëpi, ndërsa, kur i qenë afruar furrës, Eri zbriti, pa u thënë gjë, pse kishte ndalur pikërisht aty... Sigurisht Redi diçka dinte, po nuk i tha gjë...

Me të shkuar në qoshkun e tij në furrë, Eri nxorri një fletë format të bardhë dhe me gërma të mëdha shkroi: "VILFOR". Pastaj i vuri një kryq, e bëri shuk dhe e hodhi në koshin e mbeturinave...

Doli përrjashta, shikoi qiellin plot yje e mori frymë thellë...

Mustafa Tukaj

ATA QË NUK HARROJNË...

M

enjëherë pas shiut u shtuan njerëzit në sportel për të blerë bukë. Kishte qenë një rrebesh i shpejtë që nuk zgjati shumë, sa për të qulluar ata që u gjendën në rrugë e sa për pastruar qiellin nga ca re të zeza...

Edhe pak e do të vinte buzëmbërëja. Nëntori ishte gati në mesin e vet dhe, me sa dukej, koha do të ftohej, se temperaturat kishin rënë ndjeshëm. Eri po shiste bukë, ndërsa usta Baçi bënte llogaritë e numëronte lekët në qoshen e tij. Pak më parë të dy bashkë kishin sistemuar ngarkesën e miellit në magazinë dhe kishin ndarë mënjanë sasinë e nevojshme për furrën e parë nesër në agim. Tashti Eri e bënte këtë punë pa përtesë dhe sikur qe mësuar, po në fillim i dhimbnin aq shumë muskujt, sa mezi e zinte gjumi në shtratin e tij në të djathtë të furrës, që xha Baçi e kishte sjellë enkas për të... Madje ai i kishte gjetur edhe një televizor të vogël, që në fakt shumë rrallë shihte në të, mbasi në kohën e lirë, ai nxirrte librat e mësonte deri sa i rëndoheshin qepallat dhe e këpuste gjumi...

Ra zilja e telefonit. Xha Baçi ngriti kokën nga tavolina plot fatura dhe mori telefonin:

Mustafa Tukaj

- Alo! Po, po, furra jemi...Ja, prisni pak! - dhe i zgjati telefonin Erit.

- Është për ty! - tha ai dhe i luajti syrin.

- Alo! - nisi të flasë. - Eri,Eri jam! Hë,Shejla, ç'kemi? Jo, jo, tani nuk mundem, se jam shumë i zënë, nesër shihemi...

Xha Baçi u kollit. Eri ktheu kokën.

- Shko, bir shko, se rri unë! - i tha ai lehtë dhe vuri buzën në gaz.

- Alo, Shejla, mirë, mirë, më prit gati, se tani vij! - dhe i zgjati telefonin usta Baçit, disi i skuqur në fytyrë...

- Punët i ke kryer! Sa bëj llogaritë, shes edhe ndonjë bukë...Po ti mos u vono shumë, se ke për të mësuar!...

Eri fluturoi në kthinën majtas të hiqte rrobat e punës. Doli menjëherë prej andej dhe u mat të ikte...

- Prit, ku shkon! Nuk je kalama, tani! Na merri këto t'i kesh, se s'bën të koritesh! - dhe i zgjati ca para.

Eri ngurroi për një çast, po xha Baçi shtoi:

- Rrogën për t'ia çuar nënës, ta jap nesër. Këto i ke plus, si shpërblim, se jemi mirë këtë muaj... Dhe mos dil ashtu, po shkunde miellin nga flokët!...

Eri u ra dy tri herë me dorë flokëve, hodhi një sy në pasqyrë dhe u bë erë..

Xha Baçi tundi lehtë kokën e vuri buzën në gaz.

*** *** ***

Sapo ai i ra ziles, Shejla që e priste gati pas dere, e hapi menjëherë.

- Ika, mami, se erdhi Eri! - thirri ajo dhe dolën në rrugë.

Eri ndjeu mall për rrugicën e vjetër dhe një lëmsh iu mblodh në grykë, sepse ashtu vrullthi i erdhën në mendje shumë gjëra njëherësh... Femijëria, shtëpia, ku kishte lindur, shokët e lagjes, prindërit e Shejlës, që dikur i takonte gati për ditë, nëna dhe motrat, që mezi prisnin të jetonin më vete si më parë, babai... Ai fliste rrallë, po edhe kur fliste ngashërehej nga malli e kurrë s'arrinte të përmbyllte frazën e fundit...Një shpresë të madhe i kishte dhënë Redi para dy dy ditësh.. Eri nuk e kishte ditur më parë se ç'zemër flori kishte ky djalë... Sigurisht sedra nuk ia donte, që një i huaj, siç ishte babai i Redit, të ofronte para për të larë borxhin e shtëpisë, ku familja të mblidhej edhe një herë së bashku...Sigurisht, kishte thënë Bim Zalli, ata do t'ia lanin borxhin pak nga pak, se askush nuk i gjen në rrugë paratë, apo jo... Ai do t'i mbante të atit një shumë të përherëshme nga rroga e tij, që të mos e ndiente dhe aq, se, Bim Zalli, sigurisht me këmbënguljen e

Mustafa Tukaj

Redit, e kishte ndarë mendjen t'i gjente edhe një punë të përhershme Çim Shkrelit si elektrikist i fabrikës së re të çokollatave, që ai po ndërtonte... Edhe Eri një herë për një herë nuk do ta linte furrën...

- Ç'ke humbur kështu? - e pyeti Shejla dhe e kapi për krahu... - Po vret mendjen, se ku do të më qerasësh?

- Ku të duash ti dhe çfarë të duash!

- Paske marrë rrogën?!

- E, po, nuk jemi njëlloj...

- Sigurisht, ti sot je katërmbëdhjetë! Unë dua edhe katër ditë!

Erit iu bë qejfi...Ai kishte harruar fare...Askush në klasë sot nuk qe kujtuar...Ata kujtoheshin për festat e njëri tjetrit, vetëm kur organizonin diçka...Kurse ai as që i kishte rënë atij krahu...Vetëm Shejla nuk kishte harruar! A,aaa! Tani po i kujtohej, pse e ëma i kishte thënë të kthente patjetër sonte andej nga gjyshi... Ndoshta kishin përgatitur ndonjë darkë...

- Të faleminderit shumë, Shejla!

- U bëfsh njëqind vjeç! - tha ajo dhe i zgjati një pako të vogël! - Hape, është diçka për ty!

Ai e hapi.

- Celular!

- E gëzofsh!Ke edhe numrin brenda!

Mbeti si i shushatur, pa ditur ç'të thotë.

- Ç'u mpive kështu? Hajde afrohu, të të puth në faqe!

Ata u ndalën dhe iu hodhën në qafë njëri tjetrit... Ashtu pa lëvizur qëndruan disa çaste dhe pastaj, pa ia lëshuar dorën njëri tjetrit, vazhduan rrugën nën qiellin e pastër e plot yje...

Fund